

BIBLIOTEKA

E

85H-32

S 19

SHITIT

GJIROKASTËR

ZIHNI SAKO

**BUKA JONË  
E PËRBASHKËT**

ZIHNI SAKO

BUKA JONË  
E PËRBASHKËT

— NOVELË —

2264 ~~36779~~

LIBRARI E SHTËPIA  
BOTOJËSE «NAIM FRASHËRI»

SHTËPIA BOTOJËSE «NAIM FRASHËRI»

## KREU I PARË

### 1.

Këmbëza, ndërtuar mbi tri bregore, duket se ka qënë edhe në kohëra më të vjetra; po ahëre ka qënë vetëm mbi një kokojkë, në lindje të fshatit, ku edhe sot shihen mure të vjetra me gurë të mëdhenj, dy pash për së gjati e gjer në gju të lartë. Fshatarët thonë, si kanë dëgjuar nga pleqtë, se atje paska qënë kala. Në një qoshe, mbuluar nga ferrat e sarmaçet, duken disa kube e një portë me qemer bidevi, të cilat fshatarët e Këmbëzës i mbajnë për vënde të mira. Nga emri i kokojkës, që e quajnë «Kodra e Shën Gjergjit», në atë vënd duhet të ketë qënë ndonjë kishë, e cila është çkatërruar bashkë me kalanë.

Në kokojkë, veshur me një pyll të dëndur, fshatarët as dru nuk presin, as bagëti nuk kullosin, se thonë ka hie. Vetëm nuseve, kur u dhëmbin gjitë, pas lindjes, plakat ua lyejnë me baltë «nga ai vënd i mirë».

Në të tri bregoret e Këmbëzës, më të parat shtëpi kanë qënë Bardhajt, Bonjakajt, Gjovalfajt, Gjikalajt e Kokëzinjtë, se vetëm këta e heqin veten vëndës, kurse të tjerët mbahen si të ardhur nga vise të ndryshme, qysh pas prishjes që pësuan nga manofët turq, në kohën e tanzit-

matit. Ovoroi i shtëpisë së Kokëzinjve, tregon se kështu do të ketë qënë. Port' e madhe e shtëpisë, vrimat e kataraut te muret pas saj dhe një verigë hekuri, gjënden akoma.

Këmbëzën e prishën Grekërit më 1914. Populli, për të shpëtuar, ish arratisur në Ullinj të Vlorës. Më pas, si u qetësuan punët, u rikthyen dhe ndreqën shtëpitë e vjetra, po pa ndërtuar, si përpara, portëra me qemere e sufallëke të gurtë.

Banorët, në luftën e parë botërore u skamën krejt. Arat dhe bagëtinë i shitën për bukën e gojës dhe nuk e ngritën më kokën. Vetëm Kokëzinjtë u bënë të parët e fshatit. Me miqësitë e tyre në qeveri, shtinë në dorë tokat më të mira të fshatit.

\* \* \*

Razim Gjika, kur e pa Larushen, të mbesën e Malo Bonjakut, n'oborr, tek po lante këmishët, iu duk aq e bukur atë mëngjes, sa ai u çudit se qysh gjer atëhere, nuk e paskësh vënë re. Larushja ishte mbushur në llërë e në pulpa. Në faqet buçka, hunda i binte tatëpjetë, me një bukur të veçantë, mbi buzët pak të enjtura. Gjoksi, nga jeleku i çkopsitur, i bardhë si cipa e vesë, iu ngulit aq fort në mëndje, sa që nga ky vështrim, ajo ia rrëmbeu zemrën. Po gjatë gjithë asaj dite, atij i venin e i vinin mendimet. Larushja që bërë me të vërtetë një vajzë e bukur, po me që ishte e bija e Xhezair Kokëziut, përpiqej ta shtëmëngte fytyrën e saj nga sytë, ku i rrinte si një fotografi e gjallë. Malo Bonjaku, kish kohë që donte ta bënte dhëndër Razimin. Po asnjë-

herë nuk i pat hedhur ndonjë fjalë. Ai kishte frikë se mos e prishte me 'të, sidomos tani që ishte zgjedhur kryetar i Këshillit. Një darkë ai ja kishte nxjerrë Larushen për t'u shtruar rakinë. Sadoqë në fillim Razimi ndenji pak i ftohët, prapë, duke parë disa herë Larushen, nisi t'i vijë mëndja rrotull. Malo Bonjaku, që i vështronte me bisht të syrit të gjitha lëvizjet, ja bleu mëndjen.

— Ti e di, more Razim, punën e saj, s'mund ta lija. E kam mbesë. Pastaj, ç'faj ka kjo e shkretë. Më mirë që e mora unë, apo ta braktisja e ta merrnin nëpër këmbë?

Razimi nuk ja ktheu.

— Unë e kuptoj se ty kështu ta do puna, si njeri i zgjedhur i pushtetit, po edhe unë, në e mora, nuk e mora me kokën time. Kur u thashë atyreve të Komitetit, që kështu e kështu mendoj të bëj, posi, më thanë—kush mund ta edukojë më mirë se ti? Bile ma kanë kërkuar në nja dy vënde, po të drejtën nuk kam dashur. — Këto fjalët e fundit ja tha si nëpër dhëmbë, duke kthyer edhe një herë gotën e rakisë me fund.

Larushja erdhi përsëri e u shtroi bukën. Razimit, në një legen llamarine, i hodhi për të larë duart, pastaj i vuri përpara gjunjve një pecetë. E shoqja e Malo Bonjakut e urdhëronte Larushen si vajzën e saj.

— Merrja pallton e shtroi atë shiltenë. Hë, të mos të të vijë turp, Razimin mezi e kemi...

Larushja duke u sjellë gjellët, u bënte shërbim, si nuse, në këmbë.

Pas buke, Razimi ndenji edhe pak. Kur iku, Larushes ja ndjeu pëllëmbën e dorës së butë gjithë natën.

Shtëpia njëkatëshe e Malo Bonjakut, pak në të dalë të fshatit, humbiste në një baçe të madhe me pemë. E gjithë familja e Bonjakajve përbëhej nga tre vëllezër, ndër të cilët vetëm Malua ishte i martuar. I mesmi, Çunia, një trupmadh e i shëndoshë, ishte njeri i mbyllur, që s'dinte gjë tjetër veç punës dhe që s'e hapte kurrë gojën. Për sytë e fshatarëve, ai që i trashë, që nuk merrte vesh fare se ç'bëhej në botë, kaq sa, edhe në kohën e luftës nacional-çlirimtare, vinin partizanët, vinin ballistët, vriteshin njerëzit në luftë, digjeshin shtëpitë, atij aq i bënte. Përpara të vëllait ulej në gjunjë dhe shkante tespiet me ca kokrra ngjyrë nikotini.

Fshatarët thoshin për të se gjoja, kur që më i ri, atij se ç'i kishte shkuar në kokë e i kishte marrë mëndjen, prandaj edhe s'i jepte njeri nuse.

Vëllai i vogël, Dinua, ishte ushtar.

Malo Bonjakun, fshatarët e mbanin për njeri të zotin e të fjalës, të aftë për të hedhur çdo hendek, që dinte të zinte miq. Pasi nipi i tij, i biri i Xhezair Kokëziut, u bë milic e pas ardhjes së Gjermanëve shkoi me ballin, Malua nga frika se mos rëndohej për vehte, mbante lidhje edhe me partizanët. Me këtë mënyrë, kur partizanët i konfiskuan të kumatit gjithë gjënë e gjallë, hodhi në dorë dhe mori pesëdhjetë krerë dhën pelleja, gjoja sikur i pat bashkuar me 'të.

— Unë nuk ia fsheh dot ushtërisë sonë — i kishte thënë komandantit të batalionit partizan. — Mua më di i gjithë fshati se e kam ndihmuar luftën — dhe i tregoi dy deftesa të ekonomatës së batalionit «Baba Abaz», ku vërtetohej se kishte dhënë pesë kuintalë drithëra misër, grurë e

tërshërë. — Ç'e di unë Xhezair Kokëzinë, nuk e di njeri tjetër. Njëqind krerë ka pasur. Ja, ky vëllai im dhe kjo kocja e xhezairit delnin me 'to.

Disa fshatarë të tjerë, që u ndodhën atje, nuk folën.

Pasi i ndau dhëntë, zgjodhi nga tufa e tij dy dele shterpa të majme, përgatiti edhe një barrë me portokalle, e ja dha ekonomit të batalionit për partizanët e plagosur e të sëmurë, që ishin në spitalin e Kuçit.

Dy tri vitet e para pas çlirimit, Malo Bonjaku, me vëllanë e mesmë e të voglin e të shoqen, kishte ngritur një ekonomi të mirë. Vëllanë e mesëm e kishte lënë me bagëti, të cilat nuk i shtoi më mbi 75 krerë. Për vete merrej me pemët e baçes, me një copë bostan dhe tridhjetë dynym ara.

Si familje me tri kurorë, reforma agrare nuk e preku as në ara, as në baçe e as në bagëti.

Sa herë Këshilli i fshatit i dërgonte për të bujtë agjitorë, instruktorë e të tjerë punonjës të qytetit, që vinin me punë në Këmbëzë, ai nuk i kishte kthyer asnjëherë.

Kur u shtri për të fjetur, kënduan këndezat e dytë. Nga dritarja po hynte në dhomë një rreze hëne, e cila dukej se po ecëte pak e nga pak. E shoqja, një dëndoshore, që i zvarriste tumanet nëpër këmbë, si mbuloi zjarrin në vatrë, me që vuri re se të shoqin s'po e zinte akoma gjumi, i tha:

— Nuk i hodhe një fjalë Razimit për Larushen.

— S'pyetet nga ti ajo punë!

— S'pyetet, s'pyetet, po hekuri sa është në zjarr rrihet. Po kanë edhe të tjerë vajza.

— Flij tani, flij...

Ajo s'bëri më fjalë. Pas pak në odë u dëgjua një e gërhitur e rëndë. Rrezja e hënës qe larguar dhe odën e mbuloi errësira e plotë e natës.

2.

Shtatori në Këmbëzë, shpesh herë, bën kohë e mirë. Natyra gjelbërohet si në pranverë, po takon që bën edhe vapë si në Korrik.

Përpara portës së saj, plak' e xha Sopit, pojakut të Këmbëzës, po tirrte ca lesh të përzier laraman, siç ja kishin falur fqinjët për t'i bërë edhe ajo të shoqit një triko, ashtu si kanë nisur e mbajnë tani edhe fshatarët, në vënd të xhamadanit.

E shoqja e Lames, bucjelën me ujë ngarkuar, e një gjym në dorë, po ngjitej për në shtëpi. Me që ishte e lodhur nga e përpjeta, kur pa Sopjen u ul edhe ajo të pushonte pak. Flokët qull nga djersa, i rrinin pllakë pas kokës.

— Na hangri ky ujë, — i tha Sopjes dhe mori frymë thellë.

— E, moj të keqen. Po dal të mbush një mastrapan, se edhe ai plakoshi im humbi sot tërë ditën, në gjumë dhe unë s'gjeta kohë të shkoja për ujë.

Si mbushi mastrapanë, mendoi t'i hedhë edhe nja dy grushte fytyrës.

— Uh, moj nuse e Lames, të lumshin këmbët, sikur të të keshë porositur të shkoje këndeje.

Xha Sopi, duke dëgjuar këtë bisedë, u ngrit edhe ai e doli te dera e shtëpisë.



— Ç'bëre, moj nuse e Lames? Si je, moj vajzë?

I mori gjymin me ujë të ftohët dhe e ktheu gllënq e gllënq.

— Paç uratën... — dhe u ra buzëve me mëngën e këmishës.

— S'na erdhe, Xha Sopi, për të na uruar.

— Përse, moj nuse e Lames?

— Ua! si përse? Lamia na hyri në punë.

— Në ç'punë, moj? (

— Në punë të qeverisë, me njëzet e tetë napolona në muaj.

— Moj, po ju qenkeni për gosti. Po si ngjau? Pa më thuaj, si ngjau?

— Po ja, xha Sop: atë e dërguan në Tiranë dhe mësoi një zanat, që nuk do të na lerë pa bukë tërë jetën.

— Tani, me që do të ikni edhe nga fshati, po të doni të ma lini mua shtëpinë, se ti e di dhe e shikon se në ç'hall jam.

— Nuk do të largohemi, xha Sop, se burri punën do të ma ketë këtu në fshat.

— Demek ju do të mirreni edhe me bujqësi, do të kini edhe njëzet e tetë napolona në muaj, edhe triskat, ë? Po ç'punë kaq e mirë është kjo?

— Do të matë shirat?...

— Do të matë shirat?... Pa ulu, moj bijë, se ky qenka zanat për t'u çuditur. Domethënë Lamja do të matë shirat!... Po me se, moj bijë? Me metro e me pëllëmbë, a me okare, apo do të nëmërojë se sa pika bien?... Si është? pa ma çkoqit mirë!

— Ka ca vegla, që i mësoi atje në Tiranë.

— Domethënë Lamja qenka bërë njeri i ditur. Po kush e caktoi?

— Këta të këshillit...

— Edhe ne fshati s'ditkemi gjë! Si është ky fshati i ynë!... Po ç'i duam fjalët. Pa vështro e thuaj edhe ti, mos më gjën edhe mua ndonjë vënd.

— Ku di unë ç'të të them?

— Hë, hë... Pa ka në dorë ai, ka.

— Sikur të thashë... Domosdo që ka në dorë.

E, po të ketë, pse t'ja japë njeriut tjetër...

— Po kur s'bie shi, çfarë do të bëjë?

— Me ç'më duket mua, — ai s'më ka thënë gjë, se ka rënë përmbys mbi libra, — punë duhet të ketë vetëm kur bie shi.

— Ashtu ta merr mëndja. Po pa shiko e pyete se mos ketë gjë nevojë për të matur edhe diellin. Dhe po qe gjë, të mos të të bëj be, mos e bën fjalë, se kjo do të jetë tamam punë për mua. Gjithë beharin roje, marr edhe unë nja njëzet e tetë, fundi e marr edhe më lirë, se të të them moj çupë, me shumë zor e kthejmë shtëpinë.

— Ua! ja them unë, posi!?

— Veç të mos e marrë vesh njeri, se e di si ta rrëmbejnë? Si një e një... U ç'më gëzove, moj bijë! Se jo vetëm do të merrni ato njëzet e tetë napolonat në muaj, po qënka edhe punë pa mundim. Mbase do të hapë edhe zyrë, do të mbajë edhe çantë, ë?

— Çantë po se po, po zyrë jo, se kjo punë bëhet me këmbë dhe tri herë ditën, sa të shohë ato veglat, që kanë vënë atje, në anën e sheshit të Këshillit.

— Po për kooperativë si do të bëni?

— Tani për tani, s'hyjmë dot, xha Sop. Se edhe shtëpia do punë, edhe burri do shërbim. Pastaj atë mund ta thërresin edhe në mbledhje...

Si e sheh është punë me përgjegjësi... Përveç kësaj edhe duart i janë holluar, ka kaq kohë që merret me mësim. Ai tani ka harruar nga zihet parmënda.

— Ashtu është. Të matësh basma ke metron, po të matësh shinë s'është e lehtë, një qime të bësh gabim... Ku mund ta dish se sa okë shi ra sot... Një çudi është... Po të të them, që kur ishte i vogël, yt shoq e kishte synë të bëhej njeri i ditur... E kam dashur shumë... i kam hequr një herë veshët... Shiko, mos ja ze në gojë këto budallallëke.

— Ç'është ajo? — nusja e Lames zgjati buzët me kamari — dhe në e ke rrahur ndonjëherë, mirë ja ke bërë, zotrote për të mirë të tij ke menduar.

— Ajo s'do mënd... po vështro, se ti mbase nuk e di mirë, po të ketë zyrë, të më marrë mua... se edhe çantën edhe fëmijët ua mbaj unë..

Nusja e Lames, si mori gjymin me ujë, u nis përpjetë sokakut, duke u tundur, megjithëse bucjela i shuante kurrizin.

Xha Sopi, megjithëkëto, prapë se prapë s'po merrte vesh se çfarë pune qënkësh kjo, pa zyrë, vetëm me një çantë, punë që bëhet në këmbë, tri herë ditën...

— Po shkoj nga Këshilli, moj grua... a po të vete drejt e te Lamja e ta uroj e t'i them se kush e di, mos duhet edhe ndonjë njeri tjetër? Si më thua? Veç në ma fshehtë, se kur s'bie shi, ç'do të bëjë?... Po fundi po ma fshehu, e kërkoj më lart. E marr edhe më lirë... Ika unë... Eja edhe ti më pas.

Që kur Vilëza, fshati matanë lumit, u bë kooperativë, edhe në Këmbëzë fshatarët filluan të bëjnë fjalë poshtë e përpjetë, sekush pas mëndjes së tij.

— Kooperativa nuk është e keqe. Po halli është si ta fillojmë. Edhe ne s'duam të mbetemi prapa nga bota.

— Mirë thua, o Malo, — ja preu fjalën xha Sopi, i cili sapo arriti, pas atij uji të ftohtë që piu nga gjymi i nuses së Lames, — po duhet edhe shumë tokë. Pastaj edhe ky fshati ynë është i varfër, sa më s'bëhet. Ja, me se të hyj unë në kooperativë? Këtu një takëm nga ne jemi me gisht në gojë. Unë them ta filloni ju, që kini një çikë prokopi, pastaj edhe neve me vete na kini.

— Ah! Qelepirxhiu i dreqit — iu drejtua Malo Bonjaku. — Kooperativa do punë, more vesh? Do edhe kamje, ajo s'do mënd.

— Po edhe atje në Vilëze me shumë gërnjë e ngritën. Dhe thonë që s'venë mirë.

— Kush ta tha tyj? — e pyeti Razimi.

— Mua?.. S'më bie në mënd... Po për ta dëgjuar, e kam dëgjuar.

— Hë, qërohu, reaksionar... — iu akërrua Razimi. — Kooperativa do të bëhet edhe tek ne. Kur do të bëhet? Kur t'i vijë koha. Pse po ju flasim për natë? Që t'u mbushet qypi. Po domosdo të zgjedhurit do të hyjnë më përpara. Kooperativa do dhjamë, s'do kokalla dhe dembelë. Lanet! Se sa herë që mblidhemi na bën të nevrikosemi. Në mos daç ti, kurrë mos hyfsh.

— E, mo Razim, ç'ja zgjat Sopit! — i foli

Malo Bonjaku. — Sikur s'e di Sopin e takëmin e Sopit. Ule gjakun.

— Po ta bije në majë të hundës dhe...

— Si janë këta të rinjtë? — psherëtiu xha Sopi me pikëllim të madh.

— Mos ja vur re edhe ti Sop. Pleqtë duhet t'ua falin të rinjve axhamillëqet.

— Po ç'i thashë unë i varfëri, që u bë si piperkë? Edhe unë e di që është djalë, po ama s'jam edhe ndonjë plak i shkarë. Unë them ato që janë e që thotë fshati.

— More gjyslykë të këndosh statutin? Atë thuaj — edhe Malo Boshnjaku qeshi me një zë si dauille e prishur. — Apo vete ti të të dërgojmë të deleguar në Vilëzë e të na biesh eksperiencë.

— Oh! Edhe ti Malo, lei shakatë tani, po merr me të mirë Razimin, se ato fjalë që tha më dogdisën shumë e më leqendisën, aq sa s'di si do ta gdhij natën.

— Ashtu e ka Razimi, pa s'është i keq. Edhe atij ja do puna që flet në atë mënyrë... E prishim edhe ne, Sop?

— Po, e prishim!

— Foli një çikë kaziut të Canes se e shqeu atë gardh,

— Është një djall kaziu i Canes, që s'lë gardh. Apo s'të ka një bark si të lugatit. Me ca qe si Kaziu, në kooperativë, njerëzia duhet të punojnë vetëm për ta. Oa! — ja bëri Sopi e i futi një shkop në vithe, sa ai, duke u larguar me vrap, tërhoqi me brirë një copë gardh.

— Ike, Malo?

— Ika, ika, Sop. Natën e Mirë!

— Pritu mirë...

— Të thirrën te Razimi! — i tha e shoqja Malos.

## *Jetën Shkarrë*

— Të thanë gjë kush u ka ardhur?

— Jo... por ndonjë i deleguar;

— Mirë, — dhe u fut në odën e mirë e po kërkonte në dollap. — Ç'u bë ajo dorja me uzo?

— Aty në dollap e ke... Ja...

— E gjeta, e gjeta... ik, mos na merr këmbët... Ec zër atë këndezin e bardhë e na e kuq... se edhe Razimit s'ka kush t'i bëjë një darkë për të qenë, një nënë ka e ç'të bëjë më parë. Kuqe mirë... more vesh? Hidhi këmbët... shpejt.

— E po sa të bëhet. Do therur, do rjepur; sa të piqet...

— Zog është, zog... bëhet ai menjëherë. Foli edhe Larushes të të ndihmojë.

Razimi me të plotfuqishmin e grumbullimit akoma po rrinin në oborr, ulur mbi një krah dru.

Malo Bonjaku i gjeti tek po flisnin për disa çështje të grumbullimit, Me që ishte akoma ditë, i plotfuqishmi i grumbullimit po i tregonte si duhej të mbusheshin shtyllat e një formulari të madh, të cilin e kishte shtruar mbi gjunjë.

— Si je, o i plotfuqishëm? — iu drejtua Malua. — Na mbive në derë, në këtë fshatin tonë, vetëm për këto grumbullimet. S'na erdhe ndonjëherë, ashtu për muhabet e për qejf... si u ngryse, ti Razim?

— Po ç'të bësh, o Malo. Këmbëza e juaj ka të prapambetura.

— Po s'kanë edhe ç'të japin... Pastaj disa thonë, kush e di, mund të bëjë edhe ndonjë falje qeveria.

— Falje ka vetëm për ata që hyjnë në kooperativë... Po ju për kooperativë as që e keni vënë ujët në zjarr.

— S'jemi dhe ashtu fare prapa si na pandehin — Malo Bonjaku u ul te praku i derës dhe vuri në mes të këmbëve dorjen me raki.

— Do të flasim edhe për këtë. — Si tha këto fjalë, i plotfuqishmi mbështolli formularin dhe e futi në çantë.

— Hajde të vemi brënda... Hyr, o Malo!

E ëma e Razimit, me një llambë në dorë, shkoi e para në dhomë dhe e vendosi llambën mbi oxhak. Një zjarr me dru të thata në vatër, lëshonte një flakë, që humbiste në buhar.

Dhoma e madhe e çveshur, me një faqe muri të pasuvatuar, dukej si një karakatinë, që dru të me barrë t'i vije në zjarr, s'të hynte të ngrohët.

— Mor derëzi, ç'e ke lënë gjithë këtë dhomë kështu? — e pyeti i plotfuqishmi. — Ndaje dhe bëne dy dhoma që të kënaqesh.

— S'ja kam kohën, pa edhe unë e kam menduar.

— Apo e ruan për dasëm? Ke gjë në vijë? Ç'thua, nën' e Razimit?

— Ç'të them unë, jeto? Kohën ka edhe për martesë, po s'jemi ujditur e s'na ka konditur gjëkundë syri.

— Martoje, martoje, se kështu do të kujtohet të ndreqë edhe shtëpinë. Apo s'ka Këmbëza vajza?

— Ka Këmbëza vajza — u hodh Malo Bonjaku, — që t'i pish në kupë... po edhe këtë do ta martojmë, si ne të gjithë.

— Gjej një, gjej një ti Malo...

— Unë gati ja kam, po të hapë gojën ky, që nesër.

— Se vjen edhe dimër, Razim... e në këtë

odë që lot kali vrap... vetëm s'g'dhihe i gjallë në dyshek.

I plotfuqishmi ishte edhe shakatar, e sa u përgatiti e ëma e Razimit rakitë dhe mezetë, të tre burrat s'e kuptuan fare se si u shkoi koha.

— Hajde gëzuar e mirë se na urdhërove!

— Gëzuar e në dasëm!

— Gaz paç jeto — e uroi edhe e ëma e Razimit. — Po zotrote je i martuar?

— Unë?... Kam edhe dy djem.

— Të të rrojnë.

— S'na thatë gjë për kooperativë, si i kini punët? — i pyeti i plotfuqishmi.

— Dhe ne në ato ujra jemi — iu përgjegj Razimi e Malua, të dy në një gojë.

— Po kemi ca pengesa, — vazhdoi Malo Bonjaku — si fjala vjen të na jepet Bedeni neve; e do populli për kullotë.

I plotfuqishmi në një bllok mbajti një shënim.

— Ka vdekur ajo punë. Po u them edhe unë atyre të ndër marrjes së kullotave.

— Atëhere po qe puna kështu, të betohem, kooperativa në këmbë është, për këtë bukë e këtë raki, që pimë. Gëzuar! — Të tre i përpoqën gotat. — Hiqe, hiqe... me fund... Uzo është.

— Është e mirë e shkreta. Pihet. Të them të drejtën, uzua më pëlqen, se hem të zë shpejt, hem të del shpejt. — I plotfuqishmi ktheu edhe një gotë. Malu Bonjaku ja mbushi përsëri.

— Razim të kam gjetur. Shëndeti i mikut tonë...

— Ama, me dolli, zure? — iu drejtua i plotfuqishmi.

— Jo, a derëzi, sa për të hapur muhabet.



N'atë çast e ëma e Razimit, solli në një pjatë këndezin e skuqur, të cilin Razimi, si e shqepi, e ndau dhe mysafirit i vuri përpara një kofshë dhe gjoksin.

I plotfuqishmi, megjithëse i qante syri për ato kërcëna të skuqura, të cilat feksnin nga vaji dhe nxirrnin një avull, që ja çpoi hundët, e i hapi oreksin për të pirë, në të parë i shtyu.

— Merri, merri — i tha Razimi. — Këtë e kemi nga Malua.

— Kur qënka nga Malua, po i marr... se, nuk e di ti, Razim, ka qënë kryeplak ky Malua dhe kishte të bënte me xhandarët... e është mësuar me pula të pjekura.

— Po kam mbajtur qëndrim të mirë me popullin... sa herë ua kam hedhur un' atyreve...

— Ore, se mos na e hedhësh edhe neve me këtë punën e kooperativës, me këtë këndezin që na solle, se s'jemi xhandarë ne... — i tha duke mbllaçitur një copë gjoks të këndezit dhe qeshi mbyturazi.

Pasi mbaruan shishen e Razimit, iu kthyen dorjes së Malos. Tani i plotfuqishmi ishte bërë më qejf: — Për Bedenin, në qafë time, 'besoj t'ju a japin.

Pastaj filluan të bëjnë një listë me emrat e atyre që do të hynin të parët në kooperativë.

— Po, pakë a shumë, për kryetar kë mendojnë?

— Kryetarin e kemi gati... Ja... Malua. — Razimi i ra me dorë në sup Malos... — Ngaje një çikë.

— Ti vetëm na ndihmo për Bedenin.

— Ajo?... Ka marrë fund. Ze sikur e ke në xhëp. Nga gjuha e trashur, fjalët mezi i dëgjo-

heshin... Ti Razim, nesër plotësoje atë formula-  
rin dhe ma dërgo, se unë do të shkoj në Vilëzë.

— Pse? Nuk do të na rrish edhe nesër? Mirë  
qe t'ja thoshje fshatit këtë punën e Bedenit, me  
gojën tënde, si i deleguar që je... — Malua i  
shkeli synë Razimit. Ai e dinte fare mirë se Be-  
denin s'ishte e mundur t'ua jepnin, mbasi ishte  
kullotë shtetore.

— Thojuani ju... nga unë. Ka mbaruar.

Atje, në qoshe e mbuluan të plotfuqishmin  
me një jorgan të hollë.

### 3.

Disa fshatarë ishin ulur mbi një lëndinë të  
vogël, përpara shkollës. Mësuesja, Hëna, si mbyl-  
lli derën, edhe ajo qëndroi me ta. Cane Vojka i  
qe lutur t'ua lexonte edhe një herë statutin e  
kooperativës. Sa nisi ta lexonte, Veli Çuka ja  
preu fjalën:

— Mo, mirë, ti po na e këndon statunë, por  
unë dëgjova se parëmbremë paskësh ardhur te  
Razimi një miku i tij e i kishte thënë që si shu-  
më po e zvarrisni punën e kooperativës. Do ta  
ngrini, apo ç'kini në mëndje të bëni?... Ke marrë  
gjë vesh ti, o Dalip?

— E kush më ka në hesap mua e të më thotë  
ndonjë fjalë, — u përgjegj Dalip Zeshkani.

— Jo, po thashë, se mos të ka folur gjë Ma-  
lua — vazhdoi Veli Çuka.

Lamja i Veli Çukës dhe Kame Gjovarfa, s'po  
bënin zë fare. Edhe xha Sopi, që ishte si më i  
interesuar për këtë çështje, sidomos pas asaj që  
i ngjau me Razimin, s'po dëgjohej. Lamja, që

kur kish zënë punën në stacionin metereologjik, as që merrej më me fshatin.

— Pa të shohim ç'do të thotë Malua, që vjen nga pazari, — tha Veli Çuka.

Malua, me që pa se atje në lëndinë ishin mbledhur fshatarë e po bisedonin, i zbriti mushkës dhe u ul, duke u mbështetur pas trungut të një ulliri. Mushka u nis vetëm për në shtëpi.

— Hë, o Malo, pa na thuaj, ke marrë gjë vesh ti qysh i kish thënë Razimit ai mysafiri, që i erdhi parëmbremë, për kooperativë? Se thonë sikur ja kishte prerë: do ta bëni vetë, apo të vijmë ne? E zunë gjë në gojë atje në rreth këtë punë? Ke ndonjë fjalë?

— Dhe mua ma zuri veshi një fjalë të tillë, po Razimin s'e kam parë që ta pyesja.

— Se thanë që ai mori përsipër të na rregullojë edhe çështjen e Bedenit — vazhdoi Veli Çuka — e e kishte bërë si punë të mbaruar, se pa Bedenin vanë bagëtia.

Xha Sopi, si u lodh një copë herë me masat, më në fund e ndezi. — Era e eshkës kundërmoi në kokën e çibukut.

Grumbulli i fshatarëve u shtua edhe nga të rinjtë e fshatit, që pas mbledhjes së rinisë, erdhën e ndenjën aty, mënjanë. Cane Vojka, që, asikohe, ishte përgjegjësi i Rinisë, sa dëgjoi që flisnin për Bedenin, pyeti Malon:

— Ç'thoni për Bedenin?

— Ja, thonë se pa Beden s'ka kooperativë.

— Po ne kooperativën nuk do ta ngremë për hatër të Bedenit.

— Po me se do ta ngremë? Me zallin e lumit, apo me arat e Sopit?

— Thatë gjë për mua? — u hodh xha Sopi, sikur u zgjua nga gjumi.

— Jo me zallin e lumit, po me arat tona, Malo.

— Pasi t'i bëjmë një gardh me mërquinja, lumit, ë?

— Jo me mërquinja, po ta kthejmë te mënga, pak më poshtë, e të zgjatim vijën e Prushit.

— Na jep gjë para qeveria t'i vëmë ustallarët?

— Ustallarë jemi vetë ne. E marrim përsipër ne të rinisë ta bëjmë këtë punë! — ja priti djali i Veli Çukës.

— Rri, o Vesho, për kokën tënde, mos na hap barkun. Do të lozësh gjë me top? atë bën ti.

— More, ja u hap, s'ja u hap barkun, unë them që kështu pesë e pesë ne s'vendosim kurrë. Pa të mblidhet fshati e t'i dëgjojmë të gjithë.

— Po ja, mbledhur është fshati.

— Pse, kaq njerëz ka fshati ynë?

— Këta janë ata kryesorët, apo do të mblehim edhe plakurinat e djemt e shkollës.

— Ç'u flet, o Cane, këta nuk e kanë të qartë, e na pengojnë neve të varfërve — i tha me rrëmbim Bilush Rrumbullaku.

— Mos more, pa na cjaro ti një çikë, kur qenke kaq i cquaruar, se ne jemi si teveqelë.

— Ju s'jini teveqelë — e ndërpreu Hëna — po ja bëni fshatit mëndjen dhallë. Ja, atje në Vilëzë e ngritën dhe shkojnë shumë mirë. Ata i mbaruan punimet e vjeshtës, kurse ju këtu, as gjysmat e arave nuk kini mbjellë.

— Po Vilëza ka shumë krah pune, moj mësuere, — iu drejtua Veli Çuka.

— Edhe ju nuk jini pak: burra e gra mund të bëheni dy brigada të mira.

— Dhe një ta bëjmë me pleqt e plakat, bëhen tri brigada...

— Po fol de, të shkretën, o Sopi, se sonte e ke humbur fare pusullën — dhe Malo Bonjaku, qeshi e qeshi, sa e zu një kollë e iu bë halë.

— Pa na thuaj, moj mësuese, se ti di edhe nga fshati yt, Vilëza, ç'të keqe ka të punojë sikush në mall të tij? E ndalon gjë qeveria këtë punë? Në e ndalon, të na thonë; se ne s'kemi dëgjuar gjë — e pyeti Veli Çuka.

— Urdhëro e dëgjo, xha Veli — prona e vogël fshatare nuk e nxjerr dot fshatarin nga varfëria dhe prapambetja. Po të mbetet kështu siç është sot Këmbëza, shumica e fshatarëve dhe, sidomos, të varfërit do të jenë gjene të shtypur, nga ajo pakicë, që ka trashëguar një ekonomi familjare.

— Po le të punojnë edhe ata e të pasurohen — ja preu Malua rrëmbyer mësueses.

— Edhe ata punojnë, po kur të bashkohen me fshatarët e mesëm, jo vetëm do të forcohet ekonomia e tyre personale, po do të forcohet e gjithë ekonomia e fshatit, do të përparojë i gjithë fshati.

— Kur qenka kështu, atyreve që s'kanë, le t'u japë qeveria, qe, lopë, kafshë, bagëti dhe të bëhen nikoqirë — kërceu në fjalë përsëri i ndërkyer Malua.

— Lëre, Malo, të flasë, në s'ke qejf të dëgjosh, zër veshët, tuaf njeri dhe ti... He, moj vajzë, pa folna, — i tha Veli Çuka.

— Këto i thua nga koka, apo t'i ka thënë

njeri — e pyeti Malua me zëmërim, pa e lënë të fliste.

— Këto nuk i them unë nga koka ime, po i thotë Partia. I kanë thënë Lenini dhe Stalini në librat e tyre.

— Ama s'ke dëgjuar gjë me veshët e tu, goja gojës me ta?... Ç'thonë librat!.. Sot del një libër, nesër del një tjetër... se ç'na merrni edhe si fare të paditur... Edhe ne dimë disa gjëra, nuk hamë bar... Ti i di nga librat, po unë i kam dëgjuar me këta veshë. Edhe Enver Hoxha ka thënë për kooperativat, por ka thënë të bëhen me vullnet.

Nga këto fjalë edhe mësuesja mori zjarr.

— Edhe unë s'ta them me zor. Po këtu tek ju ka që duan ta ngrënë kooperativën, me vullnet.

— Po le ta ngrënë. Kush i mba?

— Do ta ngremë; edhe ne do ta ngremë. — Cane Vojka i nxehur nga zemërimi që ndjente për Malo Bonjakun, këto fjalë i foli me zë të lartë.

— Po Bedenin? — pyeti edhe një herë Veli Çuka, — Se Bedeni i takon fshatit tonë, prandaj lëftuam e u vumë drunë agallarëve dhe ua muarrëm.

— Po ama, e mori qeveria për vete dhe na la si peshkun pa ujë, ja dha ndërmarrjes së blegtorisë, — kërcëu Malo Bonjaku.

— Ne, xha Veli, — nisi prapë mësuesja — nuk lëftuam vetëm për Bedenin. Lëftuam për të çliruar gjithë Shqipërinë dhe ngritëm pushtetin tonë popullor. Ajo që është e qeverisë, është e jona, ajo që është e jona, është e qeverisë. Ne sot nuk duhet të themi më, kjo është e imja dhe

kjo është e jotja. Punëtorët thonë për fabrikën: fabrika e jonë. Dhe ndërmarrja është ndërmarrja e jonë.

— Po ndaj na i shlyen grumbullimet. S'them për vehte, po them për ata të varfërit që s'kanë — ja preu me qesëndi Malo Bonjaku.

— Po traktorët kush t'i bije, zotërisë sate? — iu përgjegj edhe ajo me qesëndi. — Ja, ku e kini Vilëzën, e dëgjoni si buçet traktori?

Këto bisedime, me të prera të vazhdueshme, zgjatën edhe ca. Pastaj u bë një heshtje dhe fshatarët u dukën sikur ranë në mendime. Pas pak një e një u ngritën e shkuan.

— Baba, — i tha Veshua me zë të ulët t'et — ta marrim sonte për darkë mësuesen?

— Po, merre, o bir!..

Te Veli Çuka atë natë qëndruan shumë vonë, duke biseduar me mësuesen. Nga dritarja dukej drita e llambës që llamburite. Nëpër qiellin e kaltërt tymi i odës ngjitej përpjetë, si një re e hollë dhe shpërndahej djathtas e majtas. Ret' e parëmbremëshme përmbi Bedenin ishin shumuar. Disa vetëtima të largëta tregonin se asaj nate mund të binte shi. Në një mot të tillë, aty nga fillimi i vjeshtës, nata me miq kalohet bukur dhe mërzia nuk ndjehet fare.

#### 4.

Dinua, vëllai i vogël i Malo Bonjakut, ato të dy vjetët në ushtri kishte ndryshuar mjaft. Nuk qe më ai i pari që çdo fjalë të Malos e amin. Interesimi i Dinos për punën e fshatit, agjitacioni që bënte për kooperativë, Malos ja vrisnin veshët, çdo fjalë u a zinte në grykë.

Shpesh herë e shoqja e këshillonte Malon ta përmbante vehten.

— Do të bjerë, — i thoshte ajo — sa t'i shohë mirë se si janë punët në fshat. Pastaj do t'i zemë nuse, do ta martojmë. Fëmijët do t'i zënë këmbët e do ta mbulojnë hallet, aq sa s'do të ketë më kohë jo për mbledhje, po për asnjë fjalë.

— Po nuk e di ti se ç'kokë e pagdhundur është ai?.. Nuk' e shikon si më hidhet për çdo gjë që i them?.. Unë u them që të bëjmë ndarje... ai më thotë që unë këtë e bëkam për dallavere që të shpëtoj baçen... Nuk e kupton se po të jemi këshu, një familje do të na lenë tre dynymë për të gjithë... dhe po të jemi të ndarë, do të na japin tre dynymë për shoq. Në e kam se dua të shpëtoj baçen, mos i paça të gjithë. Unë e kam për të mirë të vëllezërisë... Po edhe ato hundë e buzë të Dinos nuk durohen...

— Mirë thua, more burrë, po ti, si më i madh që je, mos i shtyj urët. Ai është axhami, si dëgjon nga bota, ashtu flet. Po thuaji që të mos u vëri veshin fjalëve se ka njerës të mirë, që na duan, po ka edhe të liq që s'na shohën dot me sy, që duan të na prishin e do të shikosh që edhe ai do t'i vërë gjishtin kokës. Ndaje nga Cane Vojka. Preja të hyrat e të dalat tek ajo berdu e Kame Gjovarfës... merre me të mirë...

— Nga Cane Vojka nuk e ndaj dot, se edhe Dinua ka hyrë në Parti.

— Aq më mirë, mund të të thotë dhe ndonjë fjalë se ç'mendojnë e çfarë thonë për ty.

Këto fjalët e fundit i erdhën mirë Malo Bonjakut, e uli inatin dhe një e qeshur në buzët e tij të holla, i shprehu qartë kënaqësitë që ndjeu.



— Mirë e ke... s'do zënë luftë me të gjithë  
— dhe u qas ta puthte të shoqen, po ajo e shtyu,  
se kushedi, mos hynte papandehur në odë Larushja... — Kokë o kokë! — tha me vete dhe u shtriq i tëri nga gëzimi.

Larushja me llërë përveshur, ngritur pëqin e dimiteve, rendi nëpër oborr dhe hyri me nxitim në odën e zjarrit.

— Pse nxiton? — e pyeti e shoqja e Malos.

— Po vjen Razimi dhe më erdhi turp të më shikonte kështu...

Kur u çua Malo Bonjaku ta priste, Razimi hyri te dera. Qeni i Malos, një murro, me qafë të rjepur, që e ndoqi, duke lehur, gjer në krye të oborrit, u kthye përsëri në stel të vetë dhe, si futi kryet midis këmbëve të prasje u qetsua.

Sa u ul Razimi afër vatrës, e shoqja e Malos i vuri një jastëk për t'u mbështetur. Një zjarr i vogël në vatër, lëshonte një flakë të zbehtë.

Duke ndezur cigaren, Razimi shfryu me zemërim:

— Më lajmëruan të bëjmë një mbledhje të fshatit.

— Për kooperativë...

— S'do mend...

— Po e ngrëmë dhe neve... Kur të mbli-dhemi e shikojmë...

— Më thanë se i deleguar do të vijë Bej-kushi.

— Mirë se të urdhërojë... Njerëzit që tho-të ai për të futur në kooperativë, i ka: Bilushin, Nuredin Bardhin, Dalipin, Teto Qerimenë... Ai le ta bëjë kooperativën e tij, ne bëjmë tonën. Që të pliksemi me kë mundim, e të na bëhen or-takë në mallin tonë... këtë nuk e bëjmë dot...

— Na, moj — i bëri zë së shoqes — thuaji Larushes të na pregatitë një meze. — Pastaj, nga dollapi në krah të vatrës, mori dorjen dhe mbushi dy pagurka e i vuri në parvazin e vatrës: — Merre, pa më e mira do të bëhet.

Larushja, duke vënë në shesh një tepsi të bakërtë dhe tri pjata të vogla me bukë, djathë dhe me thelpinj hudhrash, kur Razimi e pyeti si ishte, u bë prush e me gjysëm zëri tha:

— Faleminderit, mirë — dhe u largua sikur po e ndiqte njeri prapa.

Tumanet e tregonin më të plotë. Gërshetat, deri sipër vitheve, i kishte citisur prapa në fund të jelekut, i cili ja shtërngonte shumë mirë shpatullat e saj të gjera. Nga dera e çelur hynte një erë vaji i djegur dhe dëgjohej tigani, që cicërrinte në odën e zjarrit.

Në oborr një lopë pëlliste dhe murrua, që u zgjua, nisi të lehë. Pak e nga pak, errësira mbuloi fshatin. Vëllai i mesëm i Malos, Çunia, si rregulloi dhëntë në vathë, lau duart e hyri në odë, duke u fshirë me një peshqir, të cilin, pastaj, e hodhi kokorreth në zverk e në qafë. Ai, sipas zakonit, ulur në gjunjë, sa u pyet me Razimin, e kyçi gojën dhe rrinte si i perënduar.

— Po Dinua? — pyeti Razimi.

— S'ka ardhur akoma... Ka qenë në mal për një barrë dru — iu përgjegj Malua.

— Tani më duket po vjen — ja preu e shoqja, e cila u solli në një pjatë, vezë të tiganisura me djathë.

Në krye të rrugës u dëgjua zilja e mushkës dhe kanata e portës, që po e hapte Larushja, kërciti. Dinua çkarkoi mushkën në mes të oborrit

dhe pastaj e futi në haur e i tha Larushes t'i hidhte për të ngrënë.

— Kush është brenda?

— Razimi ka ardhur.

— O, mirëmbërëma, Razim — dhe i dha dorën.

Pantallonat ushtarake i mbaheshin mirë. Në gjunjë, dy anëre të mëdha po ja mbronin edhe ca kohë.

— Jepi edhe Dinos një raki! — i tha Razimi Malos.

— Unë i jap, po Dinua s'do.

— S'e pi ai, pa kush ja mba dorën — u hodh e kunata, e cila qe ulur dhe po rrinte të çlodhej pak.

— Ç'kemi gjë të re o Razim?

— S'ka gjë, o Dino... Kërkova e kërkova mos gjeja Canen t'i thoshij për një mbledhje, që më lajmëruan sot në rreth, me që u ndodha atje për statistikat e grumbullimit, po nuk e gjeta.

— Po për punë të kooperativës nuk do të vijnë gjë?

— Për kooperativë do të vijnë, kështu më tha Bejkushi. E unë i thashë mirë... jemi ca, i thashë.

— E me cilin do ta bëni kooperativën, more të zes? me Bilushin e me Dalipin? apo do të merrni edhe xha Sopin? — u tall e shoqja e Malos.

— Vërtetë, ca si Bilushi janë të varfër, po ata janë baza e kooperativës! — ja priti Dinua.

— Le të mblidhemi një herë, fjalën e ka vetë fshati, — ndërhyu Malua. — Ngreu, Razim — dhe përpoqi pagurkën. Një sy që i hodhi Razimit, ky e kuptoi. Ngriti pagurkën, e ktheu atë që kishte mbetur dhe e vuri në kamare.

— Qysh? Me kaq? — e pyeti Malua.

— S'dua më, se piva në drekë nja dy shishe birrë.

Pas buke, atë natë, Malo Bonjaku nuk mbylli sy fare.

### 5.

Xha Sopi, tërë kohën e shkonte në tendën afër rrapit, nga ku ndërsente konen e tij, që nxirrte disa klithma të çjerra, pa qejf fare. Gomarri i penguar hidhej hop e hop; duke kthyer kokën, sikur donte të vështronte Sopin në sy, nga matej të pëlliste, hapte gojën dhe gogësihte.

Atë mbasdreke xha Sopi po gdhendte një copë piks për ta bërë çibuk. Sa pa Bejkush Konin, që po vinte nga fusha, e la piksin mënjanë, fshiu djersën me mëngën e këmishës e u bëgati të çohëj.

— Mos u ngre, xha Sop.

— Qysh të mos ngrihem? Ti na vjen në fshatin tonë rrallë. Dhe thashë, pastaj, se mbase, për ndonjë hair na ke ardhur: — Duke parë Bejkushin, që mori një plis dhe po e thërrmonte me gur, — vazhdoi:

— Erdhi rrotull për shi, po prapë iku i uruari. Edhe ai Lamja s'na nxorri gjë me tërë ato vegla. Gjithënjë na gënjen. Dhe jemi keq me ujë sivjet. Ata pak ujë të lumit, as për të larë nuk arrin, jo për të vaditur të gjithë fushën.

— Po ja, të punojmë, xha Sopi, të zgjatim vijën e Prushit.

— Sa herë e kam thënë edhe unë këtë gjë. Po kush të dëgjon? Ti s'i di mirë këta fshatarët tanë, se ke kohë që ke munguar, s'bëhen dy

bashkë. Pastaj njerëz fukarenj jemi, duhet të na ndihmojë edhe me ca para qeveria.

— Këtu s'duhet ndonjë para, xha Sopi. Këtu duhen krahët, kazmat e lopatat, që kemi secili dhe punë të mbarë.

— Ja, ti e di edhe vetë, kështu mbeten punët, si ajo punë e kooperativës që mbeti — vazhdoi xha Sopi.

— Po si thua ti? Pse ka mbetur?

— Unë? — Duke marrë edhe një cigare nga paqeta e Bejkushit, zuri të përtypej.

— Po ç'flasin, o Sop?

— E po ka që flasin mirë, ka që flasin edhe keq.

— Kush flet keq?

— Unë s'kam dëgjuar, po si thonë bota.

— Po cilët thonë?

— Joo — dhe përsëri zuri të mblaçitej... — se mos rri unë në fshat... pastaj unë, për vehtë, jam njeri që as ndez as shuaj. Thonë kështu, peqe; thonë ashtu, peqe...

— Ti s'do të më thuash, pa i di të tëra.

— Unë? Po t'i dija, pse të mos të t'i thoshja... po s'di gjë.

— Po ti the se ka njerëz që flasin edhe keq...

— Si thonë bota...

— Ahere cilët janë bota, cilët janë ata që thonë se ka njerëz, që flasin keq...

Xha Sopi e pa që ra ngushtë dhe mallkonte vehten që u hodh e foli për kesi gjërash. Një djersë e madhe i mbuloi ballin. Ai kishte ngecur si ajo miza në lëng, që jep e merr e nuk del dot. Pastaj me këta njerëz, që janë të mësuar nëpër punëra të mëdha, është bela. Duke thithur

cingaren mendonte që ç'ju desh ta lërë tendën përgjysëm? Për një cingar të kutisë. Bejkushi e vuri re se Sopi rrinte si në gjëmba. Ai e dinte mirë se xha Sopi, veshë shpuar, si ai, di plot gjëra; po, për të mos e egërsuar plakun, qeshi. Dhëmbët e vegjël e të puthitur mirë i ndritën si rruaza të bardha. Konia e Xha Sopit po zihej me një mizë, që s'i çqitej fare nga maja e hundës, mër-mëliste me vehte dhe herë pas here kafshonte me zemërim këmbën. Xha Sopi u qas më afër Bejkushit. Nga frika se mos e dëgjonte njeri zuri t'i fliste me ngadalë:

— Për atë punën e kooperativës, ai Malo Bonjaku çoç dërdëlis, po ama, mos më ze në gojë mua, se s'kam ku futem nga ajo shtriga ime, që gjithnjë më thotë: «ç'të duhet tyj...» veç do të të bëja një lutje tyj, Bejkush, të ma falin grumbullimin që kam për të paguar, se edhe për plakën, është si është, më vjen likësht, robëron e shkreta e ti na di, s'kemi as djalë as vajzë, se ajo e uruar, megjithëse është nga soji që pjell vit për vit, u ndodh shterpë.

Bejkushit i vinte keq për këtë plak llafazan e plot qyfyre, të cilin koha e parë e kish-te mësuar që me këto gjëra të jetonte të nxirrite ndonjë darkë të mirë e të pinte ndonjë gotë qelepër. Plakën e xha Sopit, që rrinte jo me dimite, po me fustan, e njëhte ç'grua derrjare ishte dhe sa përpiquej për shtëpi, po nga ta zinte. Hallet e jetës e kishin bërë që shëndet t'i thoshje, plaç i dukej. Po tani mbas çlirimit, që, me reformën agrare, i dhanë tokë, zihej me të shoqin, i cili nuk e ndihmonte hiç, po në verë e në një vjeshtë rrinte tërë ditën sipër tendës dhe në

dimër e në pranverë mbyllej në dyqan e loz-  
te backën.

Dielli po zbriste në perëndim dhe tani kish-  
te filluar era e zakonëshme e mbrëmjes. Rru-  
gës disa të vegjël ndiqnin njeri — tjetrin. Bri-  
njave, në të hyrë të fshatit, tufa-tufa të vogla,  
dhëntë e dhitë e fshatarëve po zgjidhnin barin e  
gjethet më të njoma. Ndonjë lopë e lodhur, duke  
ngjitur atë të përpjetë të fshatit, ecte dhe qën-  
dronte si e mërzitur. Ujët e çesmës së lagjes së  
mesme, që derdhej nëpër rrugën kryesore të  
fshatit kishte formuar vënde-vënde pellgje, me  
të cilat fëmijët merreshin gjithë ditën, duke bërë  
puse dhe mullinj.

Kur arriji Bejkushi në fshat, muzgu mbu-  
loi fushën. Nga dera e shkollës, një fshatar me  
një hinkë llamarine, po lajmëronte se pas darke  
bëhej një mbledhje me rëndësi.

\* \* \*

Zhurma e fshatarëve, që po vinin në mble-  
dhje, u përhap në gjithë fshatin. Ata thërrisnin  
njeri-tjetrin. Ca vinin duke kënduar, kush  
me ndonjë kandil në dorë, kush me ndonjë copë  
pishë. Nga zërat dukej se do të vinin shumë.

Ca të tjerë, që kur ishin lajmëruar për mble-  
dhje, kishin gjetur shkaqe, kush do të shkonte  
në pazar, kush në ndonjë fshat dhe, për të shpë-  
tuar nga fjalimet e agitatorëve, e mbyllnin me  
«brënda jam edhe unë».

— Oj, edhe ti teto Nasibe paske ardhur?

— Domosdo, po s'erdhi kjo, mbeti koopera-  
tiva. Unë them ta marrësh ti në brigadën tënde.  
Shkolla përdhese e Këmbëzës, një sallë tej-

përtej e gjatë dhe e ngushtë, me dy dritare të mëdha nga ana e lindjes, shërbente për klasë e për mbledhje.

Teto Nasibeja e Gjoovarfës, e ëma e Kames, që ishte rënduar nga veshët, as merrte vesh se ç'flitej. Vetëm kur u ul në fund të odës, tha nja dy herë «allah!»

— Ç'të bësh, jemi në punë, ja, erdha unë, se djali me nusen vanë në njerzi.

— E di që jemi mbledhur për kooperativë?

— Me sebeb. Ç'të veja unë, dërgova djalin dhe nusen.

Si perëndoi nja dy herë sytë, pa u mbledhur mirë fshatarët, teto Nasibenë e zuri gjumi.

— Na, moj nuse, merr një jorgan, se mos ftohet që flë ashtu zbuluar, pa kur të fillojë mbledhja e zgjuajmë.

— More, të gjithë brënda jemi, po ja që s'para e kuptojmë — i thoshte Dalip Zeshkani të deleguarit, Bejkush Konit.

— Ashtu është, ashtu.

— Nja dhjetë shtëpi kanë dhënë fjalën. Pardje sikur e dha fjalën edhe Kame Gjoovarfa.

— Sagllam. Bile ai ka dërguar teto Nasibenë.

— Si, ore?...

— Ja, e dëgjon atje ku gërhin?

— Një në dorë. Tani na mbeten nëndë.

— Këto janë shtëpitë. Po thanë këta, të gjithë jemi.

— Po ti, sikur ma dhe fjalën njëherë?

— Ç'm'u bë kjo gruaja... — dhe iku nga muhabeti.

— Dy në dorë. Na mbeten dhe tetë, shoku Razim! — i tha Bejkushi.



— Do bëhen, do bëhen. Kështu e ka ky fshati ynë. Ti e di.

— E mo, akoma do të presim?

Xha Sopi, atje në të hyrë të shkollës, po përrallisei, duke iu treguar qyfyre për teto Nasibenë, në kohën e luftës së italianëve me grekun, kur e mori ai onomatarqi angari dhe i thoshte: «Kace» e ajo i thoshte s'të marr dot «Kaçe» të keqen; nuk më sheh si e kam kurri-zin?

— Leji tani, ato Sopi, se do të fillojmë nga mbledhja, se ka ardhur edhe i deleguari.

— Pse, paskemi edhe të deleguar?. . O burra... Futu, futu.

— Jo, mor vëlla i dashur, s'fitem unë ashtu si qorr. Jam njeri që e ha bukën me presë brisku. Ku kam unë fuqi të fitem në kooperativë. Pastaj s'e kam biseduar edhe me gruan.

Në sallë u bënë nia dyzet burra e gra.

— Tani, shokë, e dini përse jemi mbledhur? Ca thanë e dimë, ca thanë s'e dimë.

— Ja, të ngrëmë dhe ne kooperativën. . .

— Po sikur thamë të mendoheshim një herë?

— Po u menduam tani. Statutin e kemi punuar. Pyetje kemi bërë. U sqaruam. Hë, tani kush e do fjalën? — i pyeti Razimi.

— Po them unë — dhe Bilush Rrumbullaku, veshur me një këmishë sikur ja kishin shqyer qentë, u ngrit në këmbë. — Më shkruaj mua të parin.

— Tamam. Me Bilushin e filluam? Mbarë e mirë na qoftë. Bilushi? Mur me horosan është për kooperativën.

— Po lemëni të flas, more shokë. . .

— Kështu si e zumë ne, as sot as mot s'ke-

mi për të ngritur kooperativë. Pse, me këta leçkamanë do të ngrihet kooperativa. Bilushi sot u fut në kooperativë, nesër prite te derë e Kryesisë për bereqet. Hyni ju që kini, të hanë dhe këta që s'kanë dhe, në fund, të bëhemi njësoj. Jo, more vëllezër, unë s'kam nge të prish shtëpinë time e të ndreq të Bilushit me shokë. Ai s'të ka as tokë. Me ato zallishtet do të hyjë në bllok. Merrni edhe teto Qerimenë dhe e kemi në vijë punën.

Bilush Rrumbullakut i qëndruan rëndë këto fjalë të Çune Bonjakut dhe e ndjeu vehten të poshtëruar.

— E pse, ç'kujton zotrote, more Çune, që ma paske hapur sonte gojën sa një kamare, me ndihmën tuaj do të rrojmë ne? Ne jemi të lidhur me Partinë, e s'na ha malli në mos do ti të hysh në kooperativë. — Ndaj s'ke folur kaq kohë, i ke ruajtur fjalët për këtë ditë.

— E oo hyr ti.

— Kështu është — i thoshte Bejkush Konit Razimi. — Shumica e atyre që duan të bëhet kooperativë, janë pa gjë dhe na prishin punën, se e marrin fjalën të parët. Fshatarët e mesëm na thonë se s'hyjmë, s'kemi takat të mbamë gjithë të këputurit e fshatit.

— Ama me grindje do ta fillojmë? Pse s'thoni ta lëmë këtë punë e të ngrihemi të ikijm.

Malo Bonjaku dridhej e përdridhej në prakun e penxheres, si urith. S'kishte nër mënd ta merrte fjalën.

— Po ti Malo, ç'thua? — iu drejtua Bejkushi.

— Lëre qelbësirën, se ai po na prish punën — i tha me ngadalë Veshua i Veli Çukës.

— Ajo dihet që është e mira jonë. Po mua këtë radhë s'më kini... Sa të rregulloj ca grindje që kam me vëllezër...

— Po Dinua, yt vëlla, do.

— Me që do, le të flasë, gojë ka vetë.

Mbledhja po acarohet. Dhe ata që thoshin më parë se ne brënda jemi, nuk po flisin. Fjalët e Çune Bonjakut prunë një farë përçarje në fshatarët.

— Atëhere të bëjmë dy kooperativa, një me të varfërit dhe një me ju të tjerët — tha me të qeshur Bejkush Koni.

— Po me që u bëka edhe kështu, kështu e bëjmë, ose ta lëmë një herë e shohim më tutje — u hodh Xha Sopi — dhe ta mbyllim e mos të mundoheni dhe ju të deleguarit, që për punën tonë, prishni punërat tuaja.

— Ju kini ca gjëra të paqarta... — u hodh Bejkushi, duke ja prerë fjalën xha Sopit.

— E dëgjon? Ne kemi kaq kohë që themi se kemi ca gjëra të paqarta, po fol zotrote. Megjithatë s'po na e vënë veshin, — ja pat xha Sopi.

— E para nuk është e vërtetë që fshatarët e varfër të hyjnë në kooperativë dhe të rrojnë në kurriz të atyreve që kanë. E dyta çdo njeri do të marrë aq sa do të punojë...

— Pra, po të kesh shumë duar nxjerr më shumë. Ç'të bëj unë që s'kam gjë tjetër veç rradaken time dhe një grua gjysëm njeri?

— Po unë, që jam i sëmurë nga veshkat?

— Të vëmë në ndonjë punë të lehtë ty — i tha Veshua.

— Ajo s'pyetet nga ti.

— Unë jam plak, more djalë, mua shuajmëni

nga defteri dhe po ngrihem se s'rri dot më! — ja priti një nga fundi i sallës.

Të gjithë dëgjonin e flisnin ndonjë gjë, vetëm teto Nasibeja, atje në qoshe, po flinte. Llamba me qelq të thyer, lëshont enjë tym që të zinte hundët.

— Unë, më dinë të gjithë, kam qënë si ajo trasta varur në degë — u ngrit përsëri Bilush Rrumbullaku. — Këtu në Këmbëzë u ka hyrë i mallkuari në bark, more shok i deleguar dhe na pengojnë neve të varfërve si mua e Nuredin Bardhin me shokë, për të ngritur kooperativë. Kanë ardhur të deleguar pas të deleguarve dhe s'kanë nxjerrë gjë në shesh. Unë them, sonte, që jemi mbledhur këtu, të shkruhen ata që janë për të shkruar dhe ata që s'duan të hiqen mënjana, se kështu s'dimë kush është e kush s'është.

— Pse, me frikë është puna?

— Ti, more Çune, pse të mos flasësh se ja hype kalit për vehte e prapa s'vështron. Po Partia nuk ka thënë kështu. Juve u gjeti çlirimi të rritur, nuk them, me punë i kini fituar qetë, mushkën dhe sot rroni si do zoti, me të gjitha të mirat. Po ama, po i harron shokët dhe të ligat shpejt. Bilushin e gjeti çlirimi të hollë, me fëmijë kokë-kokë. Nuk e bëjmë kabull të rrojmë me mallin tënd. — Xhikua e Bardhajve që s'kishte folur asnjë fjalë, i tha këto, duke e ngritur zënë dhe vazhdoi; — jazëk të qoftë që na tregon edhe frikën.

— More Razim, po ti sikur the që jemi nja dhjetë shtëpi?... Fol ti për vehte — iu drejt Bejkushi, më në fund, Razimit.

— Me që duhet ta ngrëmë kooperativën...

— pak me të përtypur Razimi e tha — unë jam dhe jam, po siç e sheh dhe e dëgjon e zorçme është.

— Edhe unë jam — tha Veshua.

— Edhe ne, o shoku Bejkush — iu drejtua Nuredin Bardhi.

— Po ti Bilush?

— Unë e thashë çfarë të them më?

— Edhe Cane Vojka — ma ka thënë mua t'jua them — u tha Bejkushi.

Gjer von dhanë fjalën nja dhjetë shtëpi. Midis tyre xha Sopi edhe Dalip Zeshkani.

Me që ç' filluan të dremitin, ca fësh-fësh patën ikur me kohë, mbledhja sikur po merrte fund. Kur u ngritën të gjithë filluan të mërmëlisnin me vehte. Dy fshatarë e zgjuan teto Nasibenë dhe, duke e mbajtur nga dora, e nxuarrën gjer jashtë në udhë.

— Po pse ikni, sikur thatë se do bëhej mbledhje?

Te dera e shkollës, kur po dilnin, Bilal Rrumbullaku iu drejtua Bejkushit:

— Një djalë si ti na duhet neve.

— Vjen? — folën disa të tjerë në një gojë.

— Ku e gjejmë atë fat, — tha Veshua.

— Do t'i dërgojmë haber Canes në kurs...

Nuk të lemë ne.

Bejkushi bëri buzën në gaz... Midis tyre vuri re Esmakon, të bijën e Nuredin Bardhit, e cila menjëherë u skuq dhe uli sytë.

## KREU I DYTË

### 1

Familja e Bejkush Konit, i ati e ëma dhe një motër e pamartuar, pas prishjes së tyre në operationin e Qershorit, si kaluan ca kohë tek tezja, teto Qerimeja, në Këmbëzë, u vendosën në fushën e Delvinës afër Vanës.

Me punën e tij e me rrogën e Bejkushit, që punonte si magazinier në një ekonomi ndihmëse të një reparti ushtarak, i ati, brënda pak viteve pas çlirimit, e mori përsëri vehten e i kaloi plagët e rënda të operacionit të Qershorit. I biri, njeri i papërtuar, i rrinte punës mbi kokë e kuqdo që ta dërgoje, ç'punë t'i thoshje, s'e bënte fjalën dy. Në aktivet e Rinisë, shpesh herë e lëvdonin e ai skuqej si vajzë. Po prapa faqeve të tia prush, fshihej një shpirt energjik, i mprehtë, sado i ngadalshëm që dukej. Ashtu si i ati, ai më shumë punonte, se sa fliste. E fjalët e tij i kishin duk, ashtu si i kishte puna. Kur u bë njëzet e tre vjeç, ai pa një ditë të bardhë, një ditë nga më të bukurat e jetës së tij. Me taserën e kuqe në dorë përpara byrosë së Komitetit, u zotua se do të ishte i gatshëm për çdo detyrë që do t'i ngarkonte Partia. Atë ditë ai i kishte më prush faqet e tij. Tani atë e shikoje më shpesh në organizatat e

rinisë e të partisë në fshatrat e rrethit. Prandaj, kur e dërguan për të ngritur kooperativën e Këmbëzës, fluturoi me gëzim të madh. Ai e ndjente besimin, ashtu si pulsën e jetës së tij të ushqyer nga Partia.

Kur disa nga fshatarët çfaqën dëshirën ta kishin kryetar dhe Komiteti i Partisë e liroi nga puna e magazinierit, ai e ndjeu më shumë besimin, se sa vështirësinë. . .

Po si ngaherë, kur një njeri kalon nga një punë në tjetrën, e më shumë kur lë një rrogë të caktuar, ka njerëz që flasin tërë natën, duke shpenzuar më shumë vajguri për hesapet e botës. Kështu ngjau edhe në Këmbëzë këtë radhë.

— Cili është ai që vjen tek ne kështu, me dëshirë. Ata këtu qenë, po i ngritën lekat e shkuan në Vanë. Po thuaj që do ta kenë çveshur. Se të kesh një punë me pozitë e ta lësh mirëkshillit, një çudi është.

— Kështu ta do mëndja; do të ketë pësuar ndonjë gjë.

Në këto fjalë i gjeti Veshua Malo Bonjakun, Razimin e Dalipin.

— Si me bar të bletës qënki mbledhur.

— Jo, mo Vesho, po themi se na ardhka Bejkushi në fshat, e themi që humbi ky fshati ynë për një djalë të vëndit? Nuk është i keq, po ai nuk na i di hallet, — i tha Dalipi, i cili shtëmëngu pak kryet nga Malo Bonjaku.

— Edhe ai djalë vëndi është. Dhe si anëtar partie që është, do t'i mësojë këtu me ne, mos u merakos ti Dalip.

— Ajo dihet. Po mos ka ngrënë ndonjë dru andej nga Partia që e çveshnë? Pse të na vijnë njerëz me cimbell?

— Atë s'donin ta linin, po e vendosi komiteti i Partisë së rrethit.

— Ashtu thuaj, qënka ndryshe puna. Ta mbledh ai, s'di llafe, vajti kaq vjet në ushtri... Tani mbase do të sjellë edhe familjen këtu e do të na shtohet fshati.

— E, — mezi e lëvizi kokën Malo Bonjaku. — I iku njëherë mëndja e la rrogën. Mos do t'i ikin përsëri të lërë shtëpinë e atë bostan, që mban me zarzavate Delvinën? Se mos do të mбетet këtu tek ne për gjithë jetën.

Atë mbrëmje, në Këmbëzë, shtëpi më shtëpi, kjo bisedë bëhej. Njëri thoshte si i mori perëndia mëndjen e la gjithë ato të mira. Tjetri thoshte kush do t'ja punojë tre dynymshin. Po kur Veshua i thoshte t'et se, hëpërhë, do të marrë rrogën, xha Sopi sa e dëgjoi: — kjo qënka punë e mirë... — tha — të vish në fshat edhe me rrogë nga prapa... s'ka më mirë se bëhet. Të kishim edhe ne nga një rrogë s'qe keq. E dëgjuat për Lamen. Hem tridhjetë napolona merr, hem triskat, hem ditë pune... kur të hyjë në kooperativë, nikoqir do të bëhet. Kismet, a derbardhë. Kur është për të ardhur, vjen: mbylli derën, bumb nga penxherja.

Po më në fund njerëzinë e zuri gjumi dhe gojë të pushuan.

Vetëm në atë shtëpinë e vogël në krye të fshatit, si mënjanë, Esmakon e Nuredin Bardhit nuk po e zinte gjumi. Ajo e njihte Bejkushin qysh në vitin 1952, kur vinte i deleguar në mbledhjet e rinisë së fshatit.

Esmakua po sillte nër mënd fytyrën e Bejkushit, trupin e tij të lidhur mirë dhe i kumbonin në vesh fjalët që i tha për herë të parë në



mbledhjen e fshatit: «Esmako, qënke bërë goxha vajzë».

Kur ishte në ushtri rrobat ushtarake i shkolin bukur. Po edhe tani, me xhakëtë të hapët dhe pa kapë, përsëri ai Bejkush do të jetë: i gjatë, fytyrë mbushur e tërë buçka. Këndeje e tutje, edhe atij llërët e fytyrën do t'ja rrahë dielli e do të zeshkonet. Sa dëgjoi për të se do të vinte në fshat për kooperativë, Esmakos iu ndryshua i gjithë fshati: arat filluan të gjelbëronin më shumë. Zëmrën tani e ndjente më tepër dhe mundahej t'i shtynte ditët sa të vinte.

Atë vit Esmakua po mbushte 21 vjeçe. Disa vjet më parë, nga fshati edhe nga disa fshatra të rrethit, e kishin kërkuar Esmakon. Po t'et dhe së ëmës nuk u kishin pëlqyer ato vënde. Është e vërtetë, mendonte e ëma — se nuk bën t'i shtysh fatet e para të vajzës, se vajzave, po u shkau këmba, mezi u del pastaj fati; po gjene nuk e jipte vehten. Esmakon e saj kush nuk e mirrte. Ajo s'dukej fare si vajzë e moshuar. Po sytë e zes, nën ato vetulla të holla, me bisht, si të shkruara me kalem, ruanin ende bukurinë e gjallërinë e rinisë së parë. Mjekra me një gropkë, i jepte fytyrës së saj një trajtë gjysëm rrumbullake. Gjiret e mbushura, fshehur nën jelek, sipër rrathëve të dimitëve, e tregonin të gjatë e të plotë.

Që pas vdekjes së të vëllajt, në operacionin e dimrit, kishin kaluar shumë vjet. E ëma, si vajzë të vetme që e kishte, ja pat hequr zinë; për kokë i kishte blerë, si të shoqeve të saj, shami buzël të kuqe dhe i kishte dhënë lejen ta lidhte me bisht.

Me këto mendime edhe Esmakon e zuri gjumi.

## 2.

Nënë Gjelina e Cane Vojkës, atë natë s'mbylli sy fare.

Në katua Kaziu po përtypej pa vrarë mendjen se e zonja po përpilitej n'atë dyshek me bar. Sa herë Kaziu shfrynte, nënë Gjelinës i këputej shpirti. Atë Kazi, që ja kishte zili fshati, ajo e dinte se qysh e kishte vënë në dorë, menjërijë mundime dhe hidhërimë.

Nënë Gjelina, kur dëgjoji Bejkushin, se edhe i biri i saj e kishte dhënë fjalën për kooperativë, u bë helm e pikë. Po atje në mbledhje e zunë keq. Të hidhej e të fliste kishte frikë se mos i bënte ndonjë dëm të birit. Disa, sipas mendimit të saj, bënë mirë që e shtynë për më tutje.

Me këto mendime u gdhi atë mëngjes pa një çikë gjumë.

Në mëngjes u ngrit shpejt e shpejt.

Bejkushi, te ovoroi i oborrit të shkollës, po lidhte dollakët.

— Si u gdhive, Bejkush?

— Mirë fare, nënë Gjelina. Ç'bën? të mori ndopak malli për Canen? Edhe ndonjë muaj e pastaj këtu e ke.

— E, Bejkush, e, po edhe ai djal është akoma e ku i di ai hallet e shtëpisë. More Bejkush, po sikur të dojë njeriu të japë para në vënd të kaut, nuk është më mirë për kooperativë?

Bejkushi e kuptoi nënë Gjelinën për ku e hidhte fjalën dhe bëri buzën në gaz.

— Të vjen keq për Kazinë, ë? — iu qas afër

dhe i vuri dorën në sup. — Nënë Gjelinë. ti s'duhet të mendosh kështu. Shtëpia juaj është tjetër soj nga shtëpit e tjera në fshat. Ti i dhe luftës një djalë, e tani dridhe për një ka...

Nënë Gjelinës po i ndërrohej fytyra dhe sytë iu mbushën me lot si rruaza.

— Për perëndi, Bejkush djali, në e kam për të keq, po ku di unë e mjera si më vjen për Kazinë. Të tëra i kuptoj, more Bejkush, të paça, po tani u kam juve e të më rroni, të ma lerë perëndia Canen, tëpkë si ai, po është akoma axhami e i hollë. Pa ku di unë e mjera, për Kazinë e kam një gjëmë. Dhe ai Sopi, kur xhindoset, s'pyet ku të bie, do të ma shuajë fare... Me Canen, të vogël, e me atë Kazi i hoqa gjithë hallet e hidhërimet e luftës e kur mbetëm vetëm e hiqnim pas vetiu të dy si keçe. Nga duart ja u kërreva ballistëve, kur më bastisën shtëpinë e më muarrën lopën.

Bejkushi e shikonte me dashuri këtë plakë thatine e të vojtur, që thuhet një fjalë e i mbusheshin sytë me lotë. Ai e kuptonte mirë nënë Gjelinën, e cila bashkonte me ndjenjat dhe kujtimet e saj atë pronëzë, që, në fund të fundit, s'i vinte mirë ta hidhte në shoqëri. Nënë Gjelina kish filluar të shqetësohej që kur u punua statuti i kooperativës. Ajo nuk e bëri vehten, po sa herë flitej për mbledhje, vinte mënuar e rrinte andej nga fundi.

— Po të zëmë e të mendojmë të gjithë kështu, moj nënë Gjelinë, s'e bëjmë dot kooperativën. Dua të të pyes një gjë. Për kë mendon ti, nënë Gjelinë?

— Për Canen, t'u bëfsha, ta martoj e ta shoh që të më rrojë rehat.

— Ahere jepi uratën t'ët biri dhe hapi rru-  
gën të shkojë andej nga është e mira. Unë e di  
që tyj të vjen keq se të duket sikur do ta nxje-  
rrësh nga dora e ç'do të bëhet. Besove ahere në  
fjalët e të ndjerit. Po. Dhe i dhe uratën e e nise  
në luftë me një palë opinga dhe me një trastë  
të vjetër. Edhe në kohë të luftës na tha Partia të  
bënim ashtu, se qe e mira e jonë dhe ne e besuam  
dhe ashtu dolli. Sot prapë na thotë Partia të  
bashkohemi si vëllezër e të punojmë tokën së  
bashku, të punojmë e të fitojmë bashkë, se kjo  
është e mira e jonë. Ne i besojmë Partisë dhe  
kështu do të dalë. Ti sot ke një ka, nesër do të  
kemi bashkë shumë qe, shumë maqina, shumë  
beregat. Delen e vetme e ha ujku. thotë populli.

Nënë Gjelina kishte ulur kokën. Asnjëherë  
s'e pati ndierë vehten aq të turpëruar.

— Mirë, more Bejkush, m'e mira u'bëftë —  
dhe i hodhi duart dhe e puthi në të dvia faqet. —  
Ku dimë ne të shkretat nëna? pandehim se kësh-  
tu mendojmë ne për të mirën tuaj. Po ikij. Ha-  
llall i paçi të gjitha — dhe me të shpejtë u kthye  
në shtëpi.

Nga mullari me bar, n'anë të baçës. pas shtë-  
pisë, mori një krah bar dhe ja hodhi Kaziut.

### 3.

Këmbëza po zgjohej e gëzuar.

Një bilbil majë manit të madh në oborr të  
shtëpisë së Esmakos, ja kishte filluar këngës e  
s'po pushonte çikë. I dehur nga hieshia, nga era  
e madhe e luleve dhe e gjetheve të gjelbëra, si  
sevdalli i tërbuar e lëvdonte pranverën me kën-  
gë të shumta.

Esmakua sa qe ngritur. Hapi kanatën e dritares e po dëgjonte e mahnitur këto këngë të atij bilbili, që i këndonte një pas një. I dukej sikur edhe ai e kishte kuptuar se asaj do t'i pëlqenin shumë ato këngë e do ta zgjonin me plot ëndërra të mrekullueshme. Andej nga dritarja ajo shikonte baçet e fshatit, ku pemët fërfërinin nga era e mëngjesit. Rrezet e para të diellit, po e skuqnin pak e nga pak Bedenin. Duke mpleksur gërshetat, kujtoi atë mëngjes edhe njëherë shikimin e Bejkushit, mbrëmjen e mbledhjes, kur u ngrit kooperativa. Një ndjenjë gëzimi dhe turpi ja përshkoi trupin, dhe faqet iu ndezën menjëherë; si pa e kuptuar hodhi dorën mbi shpatullën e mëngjër me dashuri.

Rrugët oshëtinin nga zërat e fshatarëve, që po grumbulloheshin te sheshi i shkollës, përpara se të binte cinga.

— Hëni, — u thosh xha Sopi.

— Ta marrim ne Kazinë?

— Ama ja filluat? Ahere ç'kuptuam që i bëmë bashkë? T'i mbante gjithsekush në shtëpi? Si thua, ti mëmë e Esmakos?

— Si ta ketë menduar Kryesia, more Sop.

— Unë e kam me plan. Unë s'di hatëre.

Bilush Rrumbullaku e Nuredin Bardhi, sipas planit muarrën pendët dhe u nisën poshtë nga fusha.

Mjegulla e imtë, mbi sipërfaqen e tokës, pak e nga pak po zhdukej nën rrezet e diellit e po fillonte të përhapej nëpër të gjithë fushën, duke zbuluar mirë atë baltë të zezë t'arave buzë lumit. Parcelimi i tokës nuk qe bërë i plotë. Midis arave të antarëve kishte akoma ara të bujqërve individë. Megjithatë kishte parcela të mëdha, që

u krijuan nga bashkimi i arave kufitare të mjaft anëtarëve të kooperativës.

— Do të ma japësh Kazinë? Na, për kokën tënde merre Murrin, jo për ndonjë gjë, po sikur jam mësuar me kazinë e ma njuh zërin kaq mirë, sa s'kam nevojë ta ngas me hosten. Hë, më qafsh.

— Ky është plan, moj motër, dhe unë jam «individual» që s'mund të vendos pas kokës sime, se pastaj më kritikojnë si kult. Ou, sa është menduar Kryesia t'i rregullojë këto pendë, që të jenë njësoj. Unë s'e bëj dot këtë që thua ti, se hatrit, tani që u bëmë kooperativë, i thonë «të hedhish prapa krahëve disiplinën e planit.»

— U, e ç'hatër është ky.

— Hatër me okë. Pse? mos ka brirë hatëri? Ja, kështu bëhet.

Pas pak, qetë e mbrehur në parmënda po bënë brazdat e para. Toka e shkrifët kthehej si çyrek. Avulli i saj binte një erë të këndëshme dheu dhe qetë e thëthinin me kënaqësi të madhe.

Esmakua u kishte kërkuar të lëronte edhe ajo me qe. Megjithëse disa nga ata të Kryesisë kishin kundërshtuar, Bejkushi, më në fund, u kishte thënë: «E po me që do, le të punojë dhe, si për në fillim, ta ndihmojë edhe i ati, Nuredini.

Asaj, ajo punë e re, që po bënte për herë të parë, në fillim i dha ca mundim. Gjer ahëre e ëma s'e kishte lënë kurrë të lëronte me qe, po punonte vetë dhe kur s'arrinte dot, i thoshte të shoqit ta ndihmojë. Prandaj, tek po e bënte sehir, çuditej se qysh ua mori menjëherë dorën qeve dhe, duke kujtuar sevdanë e të rinjve për punë, i jipte njëqind urata. Për vehte të saj, kur ishte

aq si Esmakua, jo vajzë, po edhe nuse, nuk e linin të punonte kështu me burrat dhe djelmurinë e fshatit. Më tepër i binte bretku në punët e shtëpisë dhe në mal për dru e mërginja.

Si e prunë kohrat! Ku vajzat e njëherëshme e ku këto të sotmet! Dikur ato sa i vlonin, mbylleshin brënda në shtëpi e s'e kapërxejnë pragun e portës, gjer ditën që dilnin nuse. Edhe kur rrastisnin e delnin, sa shihnin mashkull në rrugë, i kthenin krahët, ecnin si ajo karavidhja shtrembër e shtrembër e mbuloheshin që të mos u dukej asnjë çikë mish. Ku bënin mbledhje, si këto vajzat e sotme? Ku hapnin gojën, si këto vajzat e sotme?

Esmakua sot e ndjente vehten më të lirë. Duke ngarë me qe, i shikonte ato brazda e kënaqur, me zemër të gëzuar. I ati e ndihmonte vetëm në të kthyer, kur i duhej të ngrinte parmëndën. Pas disa brazdave u ulën të pushonin pak.

Një tufë stërqokash përpiqeshin, në ato brazda të freskëta, të gjenin ndonjë glistër. Një laraskë çapkëne, duke tundur bishtin e saj si këllëç, i binte më qafë Kaziut dhe në kurriz i tërhiqte ndonjë qime. Kaziu e trëmbte me bisht, po me që s'e arrinte dot, ajo nuk çante kokën.

Dielli i Marsit filloi të digjte dhe Esmakua e tërhoqi shaminë e bardhë, si kufje sipër ballit. E ëma hapi trastën dhe nxorri një kupace me djathë dhe disa copa kulaç të misërt. Mbi një boçe të bardhë shtruan bukën dhe të tre filluan të hanë.

Qetë, aty mënjanë, dridhnin kryet për t'u lehtësuar nga telvigu.

Disa re të imta rendnin me vrap në qiell dhe, herëherë të bashkuara, formonin grupe të

vogla, që për disa minuta zinin diellin. Zogjtë, nëpër pemët e lulëzuara, që kishin filluar të lidhnin kokrrat dhe të rritnin gjethet, ja thoshnin këngëve të tyre të ndryshme që të kënaqnin. Një mëllënjë në një ferrë, aty buzë arës, s'rrinte e qetë, po duke rrahur krahët, ndiqej me shpejtësi me një shokun e vetë.

Të gjitha këto bukuri Esmakos ja shtonin më shumë dashurinë për vendlindjen dhe ëndërrat për jetën e saj, që po i ndriste si drita e diellit.

Fusha e përtejme, nga gruri që po krekosej, shtrihej si det i gjelbër.

— Sa me oreks po hamë sot, mëmë.

— Puna, jeto, — iu përgjegj e ëma.

Edhe Nuredin Bardhi, që po përtypej me avash, tundi kryet.

— Puna e bën njerinë njeri, moj vajzë. Ne njëherë e një kohë punonim e robëronim. Po të kishe në xhep, të bënin njëqind temenara. Ne e dimë ç'kemi hequr nga ata Kokëzinjtë. S'thoshin kot pleqtë, puno o fatzi e ha o barklubi — dhe vështroi duart e tij, dy duar të mëdha plot kallo, pastaj vazhdoi:

— Ahere ne ishim si ai njeriu pa njeri. Ti gëzon, po pa pyetëm edhe mua se çfarë gëzimi ndjeva sot, kur dolëm nga fshati, ashtu të bashkuar, si do vetë perëndia. Apo s'është kështu, moj? — iu drejtua së shoqes. — Ta kisha edhe djalin, pa le mos kisha një sy... Ç'ti bësh, ashtu qe kismet. Po sot sikur ajo plagë e shkretë m'u mbyll.

Si u përtyp edhe nja dy herë, u ngrit;

— Hajde Esmako, tani më ndihmo ti mua, do t'i ngas unë qetë, se je vajzë e lodhe.



— Jo, jo, kam qejf. Nuk lodhem.

Nuredin Bardhi nuk ja prishi dhe vazhduan punën.

Xhikua po e shikonte me dashuri të bijën. Po, duke shikuar të shoqin, atë burrë trupmadh, e pushtoi një ngashërim për të dhe psherëtimi. Mblodhi boçën dhe, si e vuri torbën në një degë gorrice në bisht të arës, shkoi te e bija dhe zuri bashkë me të të lërojë. Puna, sikur po i largonte edhe asaj dhëmbjen prej nëne, për të birin e vetëm.

Atë ditë lëruan afro një stremë. Sa zuri të perëndonte dielli, Esmakua nuk e mori vesh fare kur u ngrys.

— Sa shpejt iku dita! — dhe zuri me t'anë të zbërthejë qetë.

#### 4.

Teto Qerimeja, tezja e Razimit, si mblodhi një futë me lakra të egra, po vinte në shtëpi.

Sipër bregut, shtëpia e Malo Bonjakut zbardhonte nga gëlqerja. Drita e diellit në xhamet e dritares dukej si zjarr. Në të dyja anët e çatisë, fundi i shisheve të rrumbullakta shkëlqente si xixa.

Fëmijët e saj, tre djem, si vorba japraku, të zbathur, po loznin përpara shtëpisë. Teto Qerimeja i shikoi me ngashërimë dhe u fut brënda. Griu lakrat dhe, me një tas oriz, u përgatiti një borani. Pas pak fëmijët u mblodhën rreth zjarrit dhe po prisnin sa të bëhej gjella.

Që kur i vdiq burri, teto Qerimeja mezi i bënte ballë jetës. Nga dimri i keq që bëri vitin

e kaluar, i ngordhën tri kokë cangadhe dhe mbeti vetëm me dy dhi. Fjalët, që ishin hapur ato ditë, se tani që u ngrit kooperativa, tokat më të mira të fshatarëve do të hynin në bllok dhe kush nuk do të hynte në kooperativë, ai do mirrte tokë tjetër në vënd tjetër, e kishin mërzhitur shumë. Bile e shoqja e Malo Bonjakut një ditë i tha se, këtej e tutje, «edhe lakra nuk mund të mbledhim ku të duam». Kjo i kishte rënë si bombë, se me këto lakra që mbledhte, duke i shitur në qytet, çoç nxirrte, sa për të rritur ata tre djem kërthinj e pa njeri.

Po më shumë ja kishte futur frikën kur i kishte thënë që: nuk do të ketë as argatllëk, se në kooperativë çdo njeri do të ketë hallin e tij. Në kooperativë lum kush ka krah pune. Pastaj do dhe mall e gjë kooperativa.

— Po ju përse nuk u shkruat?

— Edhe ne do të shkruhemi, po më pas, se ashtu e kemi punën. — Ndofta kështu do të ishte mendoi ajo, duke gatuar boraninë, se edhe pas mbledhjes që u bë, në fshat s'e kishte pyetur njeri se ç'thoshte edhe kjo, si i kishin pyetur ata që kishin jo qe, jo mushkë, jo dhën dhe që ishin plot krahë.

Me këto mendime në kokë, si një plakë e gjorë, teto Qerimeja u hodhi fëmijëve boraninë dhe po gëzohej se po e hanin me dëshirë të madhe.

N'atë çast dëgjoi që jashtë zërin e Bejkushit.

— E, moj teto Qerime, nga vajte?

Ajo u lëshua me të shpejtë:

— Këtu jam, more Bejkush, t'u bëfsha.

Bejkushi u ul përpara derës, mbi një gur

të madh, që fëmijët e teto Qerimesë e kishin lëmuar, duke e fërkuar me zaje nga të lumit.

—E, moj teto Qerime, si je, si i ke fëmijët, se kam ca ditë që s'të kam parë.

— E si do të jem, more Bejkush. Mjerë halli që më gjeti, të mjerën. Po që kur erdhe ti, mua m'u zbukurua fshati.

— Ç't'i bësh, tani duhet të bësh zemër e t'i rritësh djemt; ja, na ke neve. Ç'thonë për kooperativë, e ti ç'do të bësh? Nuk do të hysh në kooperativë?

— Ç'të thonë, more Bejkush? ku jam unë për kooperativë? Me çfarë të vij, unë e zeza? E mirë është, po është për ata, që kanë një çikë gjë. Mos të kam kanë, a mos të kam lopën, a mos të kam dhëntë? po sa për të punuar, s'i trembem punës. Po aman, të marrça të ligat, vur dorën në zemër e lermëni të mbledh lakra e t'i shes në pazar, ti e shikon, sa të më çuhen këta jetimë.

— Pse? Kush të pengon?

— Po thanë se tani që u fillua kooperativa, neve që s'na keni pranuar, nuk do të na lini të mbledhim lakra. Thanë do t'i mbledhin antarët e do t'i ndajnë në mes të tyre.

— Po tjetër ç'ke dëgjuar?

— Thonë se ne që s'jemi futur në kooperativë, do të na heqin nga arat që kemi këtu afër e do të na japin lark, se do t'i mbledhin tok ato të kooperativës? Ç'të bëj unë korba? mua atë ma dha qeveria dhe atje ma caktoi. Po të doni, mos më bini në qafë. Për këtë arë mu në qeveri do të vete.

Bejkushi e shikonte teton e tij, të vrrarë në fytyrë, — e cila, sado që dukej e lodhur nga përpjekjet, ruante të gjallë shkëndijën e jetës, dë-

shirën për të rritur djemt e saj, — që i fliste gjithë ato fjalë pa djallëzi, po që ja kishin tron-ditur zemrën shumë thellë.

— Do të të marrim edhe tyj në kooperativë, dhe lakra do të mbledhësh sa të duash, të mbledhësh me gjithë djemtë.

Ku ta kem unë atë fat. Ti mbase do, të keqen, po ku të lenë të tjerët. Unë i kam parë me këta sy shoqet e mia në kooperativën «Çlirimi», që janë bërë zonja, po kishin ca gjë të gjallë, mua edhe ato tri cangadhe, m'i hëngri dimri vjet.

— Po ikij, teto Qerime. Kisha dëshirë të rrija sonte, po kam mbledhje. Pa në mbarofsha shpejt, do të vij.

— Të pres, Bejkush.

— Mirë, mirë.

Teto Qerimeja ndjeu një gëzim të madh në zemër. Ajo e përcolli me sy gjer tej.

## 5.

Elmaja si grua e re e e paburrë, me qënë se do të mbetej një javë vetëm, se i kunati me të shoqen shkuan në dasmën e të nipit, në Vilëzë, mbyllte me kohë kanatat e dritareve e i vinte hekurat derës. Po që natën e parë asaj i ngjau një gjë e papritur. Për një orë rresht dikush po i hidhte gurë mbi çati. I shkonte në mëndje se patjetër këtë gjë ja bënte ndonjë që i vinte rrotull, më shumë ndonjë djalkë mëndjelehtë, se një i pjekur nuk bën budallallëke të tilla.

Malo Bonjaku e kishte shikuar disa herë në një mënyrë që kjo e kishte ulur kokën, pak e sku-

qur në fytyrë. Elmaja e dinte fare mirë se ai ishte i dhënë pas grave, dhe mundohej ta largonte. Megjithëse i shoqi po bënte kohë që nuk po i dërgonte asnjë letër, ajo e dinte se Malua s'qe për të. Fundi edhe në do të martohej, do të gjente një shokun e saj.

Nata e parë kaloi, edhe e dyta me gurë përsëri. Kjo u dëgjua, dhe në fshat zunë të flasin. Malo Bonjaku, të katërtën ditë, afër të mugtit, kaloi përpara portës e i thirri:

— Elma...

— Urdhëro!

— Pa del njëherë te porta.

Ajo doli me të shpejtë.

— Dëgjo këtu. Sonte kemi vendosur të bëjmë roje e të shohim se nga vijnë gurët. Ata të sigurimit dyshojnë për... dhe u përtyp pak, pastaj nëpër dhëmbë vazhdoi — t'ët shoq. Tani vijnë edhe diversantë. Edhe Durua, që iku për tërë javën e dasmës, nuk iku se i pëlqejnë dasmërat po... si i thonë: jashtë shtëpisë sime.

Ajo e tronditur shtangu më këmbë. Pastaj u mbështet në kanatën e portës dhe psherëtit: e zeza unë!

— Mos u mërzit — dhe i shtërngoi llërën. Ajo, nga që s'e kishte mëndjen, nuk e largoi, po si për t'u mbrojtur nga frika, iu afrua më shumë.

— E kemi biseduar edhe me Razimin. Ai ka folur edhe me të degës. Lëre portën dhe derën hapur. Do të vij pas një çikë; sa të marr pushkën. Do ta gjejmë, mos u mërzit. Po ama, s'ma do mëndja të jetë ai.

Gurët filluan përsëri, ashtu si për çdo natë, po nuk vazhduan shumë. Elmaja e ngrirë rrinte afër dritares, pa llambë.

— Do ta gjejmë — i tha Malua, duke hyrë me nxitim. Gurët që prapa shtëpive të Bardhajve vijnë. Ajo u mat të ndizte llampën. Jo, — i tha, — se s'bën. — Pasi hoqi gjerdanin e vari në një gozhdë, te kreu i odës, bashkë me pushkën, dhe u mbështet mbi minder, si për t'u çlodhur.

Në errësirën e dhomës, të dyve syri u bëhej dorë.

Elmaja vritej se qysh e bëri këtë kuture dhe u gënjye e la dyert hapur t'i futej brënda burri i botës; mbulohej nga djersë të ftohta dhe po merrte frymë me mundim. Çdo lëvizje e vogël e shqetësonte dhe mekej nga frika e ndonjë të pabëme.

Malua, pa humbur kohë, rrëshqiti si bollë n'anën tjetër të vatrës dhe, më në fund, ngjau ajo që do të ngjiste.

— Lemë, lemë... — i lutej me zë të ulët. — Nuk bën... Prandaj e kurdisë këtë kurth? Si duket ti m'i hedh gurët... Lemë të ngrihem...

Malos, rënduar mbi të, i ranë pendët shpejt e u shkreh fare, pa kohë.

— Kij mëndjen. Mbylle... — dhe u largua me të shpejtë e humbi në errësirën e natës.

Që prej kësaj nate, ose nga turpi e frika, ose nga inati se çdo përpjekje i vajti kot, Malua, sa herë takohej me Elmanë, bënte sikur s'e shikonte, edhe në sy të të kunatit i qëndronte pak si rëndë. Elmaja as ja hodhi në sy, e bënte sikur s'kishte ngjarë asgjë.

Po puna e gurëve s'i kish mbyllur gojët. Atje te sheshi, xha Sopi përrallitej mbarë e prapë.

— Sikur do t'i hidhnin gurë plakës sime. Ç'ta bësh atë, ajo s'është as për mua, jo për të tjerët. Pa le tani që është enjtur nga një dhëmballë; është bërë si ndonjë pjepër i shtrembër.

— Nejse — ja preu fjalën Veli Çuka — më në fund na pushuan veshët.

— Si duket, kush e nisi do ta ketë mbaruar qëllimin. Po nuk e zumë dot ta shikonim edhe ne këtë bandill se ç'lloj ishte, se si nga ne të qëmotit do të jetë.

— Njerëz pa vigjilencë, o Sop...

— More, sa për atë unë s'dua t'ja di, po them që duhet të ishim ngritur të tërë më këmbë e ta gjenim se u bëmë emër fare. Në ka qënë brëndë nga fshati, s'na ka për të shpëtuar... e thua j qoftë nga fshati ynë... se po s'qe i yni, aq më keq. Ahere do të na qeshin të gjallë e të vdekur. Që do të dalë, do të dalë... ja, këta të kryesisë do të merren me këto punë. Po këta të kryesisë, si të gjitha punët, e mbajnë të fshehur nga populli, e nuk na thonë gjë edhe neve... Apo s'them mirë, o Malo?

Malua u përtyp e nuk u muarr vesh se çfarë tha.

Xha Sopit i mbeti pështyma në grykë, sa e pa që Malua i hodhi një sy të egër, si ta hante të gjallë. Ai e kishte provuar disa herë frikën e tij, që ja mblidhte e e bënte pulë.

Kur u ngrit Sopi për të shkuar, Malua iu qep prapa dhe te kthesa e rrugës, pranë shtëpisë së vet, i hodhi dorën e e tërhoqi prapa portës.

— More plaku i dreqit, do ta mbyllësh ndonjëherë gojën? Fol...

— Pse, more Malo djali, mos thashë gjë për tyj? Ato që u thanë i flet gjithë fshati...

— Shiko... — nuk kuptohej sepse dridhej i tëri si purtekë, nga inati apo nga frika-mbylle të them se... për emër të zotit... do të të heq një dru që të mos e ngrësh kokën...

Xha Sopi po e shikonte me frikë e me çudi Malon, që po i sillej kështu. Po në atë çast, si vetëtimë ja përshkoi trurin mendimi se, në punën e Elmasë, në mos ishte ai dora vetë, gisht kishte pa tjetër.

— Ah, axhamiu i varfër, që u jep rëndësi edhe gjepurrave. Dëgjo more djalë, unë e marr vesh që ti nxehe, se s'do që të na merret fshati në gojë, po ç't'i bësh një bishtdredhure, që është e djegur për burrë? Mirë thonë sherr pa grua s'ka. Ruani Lluqo Certexhinë... Ai kokosh budalla po i vjen rrotull; pa s'ka fshati ynë djem të tillë.

Malua nga këto fjalë sikur u ngroh. Ja lëshoi krahun e i hodhi dorën në sup, me të qeshur.

— E kam parë diellin më përpara nga ti, more Malo djali; plakut... mos i dëgjo, po fjalën dëgjoja. — vazhdoi xha Sopi.

Të dy qeshën aq fort, sa që si njeri, edhe tjetri, sikur e harruan atë që ngjau pak përpara.

Xha Sopi nuk e mbante mend të kishte rendur aq me vrap ndonjëherë, sa atë mbrëmje. Kaq mezi po merrte frymë, sa kur hyri në shtëpi, u plas pas minderit me kashtë, si i vdekur.

— Ç'pate, o ditëzi? — e pyeti e shoqja, e cila kur e pa në këtë gjëndje, zuri të thërrasë, se pandehu që i ardhí fundi.

— Mos, mos mblidh mëhallën... ai i mallkuari, qeni i Malo Bonjakut desh më coptoi



fare... Kam thënë unë... Po kush të dëgjon?  
Edhe ato fjalë të drejta që thotë Veshua i shkretë,  
ja marrën për ters. Po më jep një nga ajo  
e manit të mbledh veten?

Si hodhi dy gllënka, xha Sopit i shkuan të  
gjitha të ligat e u cucureps.

## KREU I TRETË

### 1.

Kame Gjovarfës kishte ca ditë që i qe prishur qetësia e shtëpisë. Po të qe e mundur edhe natën nuk rrinte më dot brënda. Dino Bonjaku e Shkurta e tij e vunë në mendime dhe në grindje me të shoqen.

Gjatë luftës për çlirimin e atdheut nga zaptuesit fashistë, Kame Gjovarfës i kishte pëlqyer shumë puna e partizanëve dhe, me që disa herë i kishin ardhur në shtëpi ilegalë, një ditë, kur ai lëronte në fushë, karabinieria i kishte marrë gruan e tij, në burg e pastaj ja internuan në një kamp provizor. Kjo gjë atë e vrau shumë dhe qe i pari që doli vullnetar me një njësit për të sulmuar këtë kamp. Pas një përpjekjeje të fortë, një natë të errët shumë, njësit partizan i shpëtoi të gjithë të internuarit. E shoqja, duke parë Kame Gjovarfën, iu hodh në qafë, duke qarë si foshnje. Nesëret në mëngjes e dërgoi në njerëz të saj, ta shpëtonte dobareme nga ndonjë gjë më e madhe.

Burrë pak i hequr në fytyrë, vënde vënde me ca pika të kuqe, si prek, Kame Gjovarfa vishet me një xhaketë si në hi, ushtarake dhe pantallona gjysëm kilota, me çorape të gjata leshi, ngjyer me cefla qepe.

Si qe grindur me të shoqen, pa dalë mirë dielli, shkoi në kopështin pas shtëpisë dhe po merrej me shkrifrimin e dheut në rrënjët e atyre portokalleve, që kishin filluar të rriteshin e me lulet e tyre kundërmonin.

Në fund të kopështit, dy mushmolla, me ato gjethe si gjuhë lope, të lëmuara e të ndritura, kishin lidhur kokërrat e para, me push të imët anëve. Në një pellg një tufë bletësh pinin ujë, pastaj, lule më lule, i kërkonin të gjitha pemët.

Gruaja e Kame Gjovarfës po mërmëliste në oborr, si e marrë dhe e mallkonte të shoqin.

— Këmbës mos i rafsh. U priç nga mëntë që kërkon të na priç shtëpinë.

Edhe ai, duke punuar, shkrofëtinte nga inati e nuk i fliste fare.

Shkurta, së cilës i vinte likësht për t'anë, i lutej së ëmës që të mos bënte kështu.

— Ç'më thua, moj bijë? Ai kërkon t'i vërë kasmën shtëpisë... Dhe ti, kuçkë, u tërbove pas mbledhjeve... Ju doni të hyni në kooperativë? Merr babanë edhe shkoni.

— Po ti?

— Unë do të ndahem.

— E pse? Ç'të keq do të kesh nga kooperativa?

— S'ja kam fuqinë. Unë jam grua gjysmare. Kooperativa do punë.

— Do të punoj edhe unë.

Shkurta ca kohë më parë qe pranuar antare e Rinisë së Punës. Atë grup lezimi, që i kishin caktuar, e mblidhte rregullisht. Në sallën e shkollës, saherë bënin ndonjë ekspozitë, edhe

ajo, së bashku me Hënën e Esmakon, punonte tërë ditën. Po, kur në Këmbëzë u ngrit kooperative, ajo e ndjente vehten si të huaj në sallën e leximit, mbasi familja e Gjovarfës nuk kishte hyrë akoma.

— Ëh, — ja bëri e ëma... — të shoh, të shoh, që punon në shtëpi, iu akërrua së bijës dhe u fut në qilar për t'i vënë saçin. Pastaj doli nga kopshti.

— More, unë s'ta lë Baliken, që copa — copa të ma bësh mishtë. E qysh, more burrë, si ta nxjerrim nga dora Balikën? Si ta nxë goja e më rri e më dëgjon ata axhamij...

Kames, kur i fliste e shoqja për Balikën, sikur i fuste një hekur të përvëlur në bark. Nga e keqja, që ndjente, i akërrohej e i hidhej asaj sikur ta përpinte. Po kur një ditë Shkurta i pat thënë: mendo edhe për mua e për Dritën, baba, atij papandehur diçka ja ndriti mendimin.

Gjatë atyre ditëve, natën, kur binte për gjumë, kthehej e rrotullohej në dyshek shumë i shqetësuar. Gjithfarë mendimesh ia përshkonin mendjen si vetëtimë. Mirë se është mirë, por po ta pësojë, si thoshte Malo Bonjaku, si disa që zinin kokën me grushte dhe dilnin me thes në krahë për të marrë hua? ec e vure prapë mallin pastaj. Po kur agjitorët i tregonin se si po shkonin në shumë kooperative, se si ca, që ai, më përpara, i njihte se ç'kishin dhe sot i kishin marrë gazeta, i qetësohej zemra.

Megjithëse Kame Gjovarfa e kishte dhënë fjalën, nuk i bënte zemra të ngrihej. Shkurta, e bija, i qe lutur të vishej me rrobe të reja e të rruhej, pastaj të shkonte në mbledhje. Edhe ai

për të mos ja prishur qejfin, veç kalcave dhe mengores, veshi edhe xhamadanin me gajtane. E bija i nxorri edhe medaljen e trimërisë. Shumë kujtime i erdhën atë çast në mëndje.

— Hajde, me hair — dhe u ngrit. Rrugës sikur e shpejtoi hapin. Posa erdhi te shkallët e godinës, ku kooperativa kishte zyrat, zuri të mbahej pas parmakëve. Fytyra i ndërrohej herë pas here dhe zemra i rrihte tak e tak, sikur e pushtonte ndonjë frikë.

Ai priti nga vjeshta e në mars. Shkurta dhe agjitorët s'i qenë ndarë. Kooperativa po shtohet dhe Kame Gjovarfa dukej sikur po ndahej nga shokët.

Atje në kryesi ishin edhe fshatarë të tjerë. Ai dëgjoi se dy prej tyre po bënë llogari se sa djathë do t'u binte.

— Njëzet e pesë okë.

— Ti njëzet e pesë okë?

— Po.

Kamja e dinte se Bilush Rrumbullaku s'bënte kurrë as bukën e vitit, jo të merrte edhe njëzet e pesë okë djathë dhe çuditej qysh po i bënin këto llogari. Si familje ishin barabar, vetëm se kishte një djalë më tepër. Fundi mund të merrte njëzet okë për vehte.

Si ndënji një çikë atje në mes të odës, u afrua afër tavolinës. U ul në një fron dhe, duke nxjerrë kutinë e duhanit, mbushi çibukun dhe e ndezi me eshkë.

— Ku e ke atë lutjen?

Bejkushi palosi disa evidenca, i futi në një fletore dhe mori një letër të pashkruar.

— Ja, e bëjmë tani — dhe filloi e e shkroi

vetë lutjen. Këtu do të hedhësh firmën.

Shkurta i rrinte në krah.

— Këtu do ta hedh emrin? — dhe mori penën. — Ashtu. Pa ma këndo dhe një herë!

Bejkushi ja lexoi përsëri.

Kames dora i dridhej. Buzët i ishin bërë pëlhurë dhe çibuku në dorën e mëngjër i qe shuar.

— Mirë — dhe filloi të shkruajë emrin. — Po lopën për shtëpi, do të ma lini?

— Posi — i tha kryetari.

— Balikën? ë?

— Atë që ke.

— Mirë — dhe vazhdoi. Prapë e preu.

Dy gërmat e para të emrit mezi i kishte shkruar. Edhe ato nuk kuptoheshin mirë.

— Zotrote sikur e ke bërë edhe kursin kundër analfabetizmit? — i tha Cane Vojka.

— E, po tani ai mbaroi, more djalë. Unë e kalova moshën. Në e pranoni kështu, mirë. Në mos po vë gishtin... Po desha të pyes, kur sëmuret njeriu, a ma jep kooperativa një mushkë, sa të vete te doktori?

— Pse mendon të sëmuresh?

— E, po njerëz jemi... Unë s'mund të them se s'do të sëmurem hiç... Unë jam edhe nga veshkat pa qejf... Nuk ma këndon edhe një herë ti djalë, këtë lutje?

Ja lexuan edhe një herë.

— Ashtu.

Shkurta e shtyu që prapa e i foli me ngadalë:

— Hidhe firmën!

— O! Këtu je ti? Pa këndoje edhe ti një herë?

Edhe e bija ja lexoi lutjen.

— Po e sheh.? Këtu s'thotë gjë për ato që the ti.

— Kjo është lutje, baba. Ato i thotë statuti.

— Po sikur ta lemë tani, të shohim edhe një herë atë statutin, pa emri është kollaj.

Në këtë kohë, Veli Çuka, ai plaku i pakët nga boja, që nga dera i thirri Bejkushit:

— Ma bëre atë lutjen? Unë gishtin do të vë, se s'di të shkruaj. Hajde, se mbetëmi edhe pa punë. Ja, dhëntë i dërgova me djalin t'i regjistronë...

Bejkushi ja dha lutjen Veli Çukës, dhe ai vuri gishtin, të cilin ja vërtetuan Cane Vojka, Shkurta dhe Kame Gjovarfa.

— Hajde, more djem, më e mira u bëftë. Çdo gjë që ka thënë partia, ka dalë. Pse na lëftuan djemtë?

Kame Gjovarfa uli kryet dhe po shikonte medaljen e trimërisë.

— Hajde — i tha së bijës. — Jepu dorën këtyre shokëve, se edhe ne s'jemi më poshtë nga Veli Çuka. Mori Shkurtën nga dora dhe doli shpejt e shpejt.

Gëzimi i Shkurtës, Kame Gjovarfës nuk ia mundi dot atë mendim, që e rrëmbeu ato çaste kur Veli Çuka nënshkroi më përpara lutjen. Ai u vrënjt në fytyrë: me buzën dhe dhëmbët e poshtëm kafshonte cepin e mustaqeve, që kishin filluar t'i zbardheshin më shumë.

Shkurtës, duke e vënë re këtë gjëndje të t'et, shumë mendime ja përshkuan ballin e saj të ulët, mbi ato vetulla të trasha, që i bash-

koheshin nën shtegun e ballit. Ajo pandehi se mos i ati nuk kishte dalë me gjithë zemër dhe pyeti:

— Ç'pate kështu, baba?

— Nuk u pendova. Nuk jam budalla. Edhe unë mendoj për tyj edhe për Dritën. Po më erdhi rëndë se edhe Veli Çuka që më burrë nga unë. Me çap të shpejtë u nis përpara së bijës për në shtëpi.

Gruaja, ajo katana, me ato dimite të zeza, me një lule miza-miza të bardha, duke u grindur me të vjehrrën, Nasibenë, e priste te porta. Sado që aq ditë me radhë që ngrënë me të shoqin, më në fund, si e pa që s'i doli dot në krye, pat ulur kokën dhe kishte hequr dorë. Shkurta i që lutur shpesh që të shikonin edhe këta se ç'bëjnë bota. Vetëm Balka i kishte mbetur si një gozhdë në zemër. Sa herë e kujtonte, qante për të, si për djalin e vetëm.

— E, more burrë, ç'bërë?

— Ik, se rrëmbeva hunë, more vesh? Se ti më humbe nderin dhe burrërinë. S'jam më poshtë se Veli Çuka — dhe hyri brënda.

— Për Balkën, Balkën, ç'bërë?

— Mos u mërzit, mëmë, Balkën do ta mbajmë. — Shkurta e puthi të ëmën me gëzim.

— Më rrofsh, moj bijë!

## 2.

Dëbora e re, që pat rënë ato ditë të para të Marsit, e zbardhi malin gjer përmbi fshat. Era e ftohët, që të priste turinjtë, edhe ato pak lule, që kishin filluar të çelnin, i prishi



fare dhe ngjante sikur dimri po kthehej përsëri. Bajamet, ato pemë budallaçka, që gënjehen me një ditë të ngrohët e me diell të shkurtër, dukeshin sikur ishin penduar, se lulet e tyre i fringëllonte era tej, si flokë bore. Nga ngricat e natës e të mëngjezit, toka kërciste nën këmbë, si krandet e thata.

Po pranvera në Këmbëzë vjen shpejt. Sa pushoi era, moti u ngroh dhe qielli zbardhi si xham.

Mbi tjegullat e shtëpive bryma po zhdukej që me rrezet e para të diellit dhe në fushë po përhapej si një avull i përhimtë, me shpejtësi të madhe. Era e marrë e kishte lënë inatin e saj e tani po loste me lulet e gjethet e pemëve që sapo kishin filluar të gjelbëronin. Lulet e kumbullave, duke u gudulisur pas saj, lëkundeshin në ajër, me kënaqësi, gjersa binin në tokë, si flokë të imta dëbore.

Nëpër barin e njomë, palcë, kishte buisur shtrapëri. Anëve të rrugëve, murrizat mbuluar me lule të bardha, veshur pas degëve si shtëllungë, krekoseshin midis asaj hieshie të madhe. E me to bashkë, edhe lule kumbora, xhabina e brokëri, me lule të verdhë, përpiqeshin të merrnin pjesë, duke qendisur me ngjyrat e tyre, akoma më tepër, këtë bukuri të vëndeve tonë në kohë pranvere.

Dallandyshet venin e vinin sipër fshatit dhe secila, si në mall të vet, kishte zënë strehët e ndonjë shtëpie. Herë-herë, me krahë të kryqëzuar sipër bishtit, qëndronin për pak kohë si të ngjitura pas murit, pastaj vrik rrëzoheshin dhe bridhnin në ajër si shigjeta.

Në qiell u duk lejleku i parë. Ai, si u suall disa herë rreth fshatit, filloi pastaj të ngadalësojë fluturimin, vari këmbët e zbriti sipër minares së prishur, në çerdhen e tij të vjetër dhe nisi të rrahë sqepin, duke shtrirë sipër kraheve, qafën e tij të gjatë.

Fëmijt atëkohë po shkonin në shkollë, për të dalë shëtitje, për ditën e Verës. Sa e panë lejlekun u lëshuan e vanë ta vështronin. Lejleku, sikur donte t'u thoshte «gëzuar, gëzuar pranverën», tundte kryet e po i përshëndeste këta miq të vegjël, që i njihte qysh nga viti i kaluar.

Fëmijët si fluturat, u grumbulluan përpara oborrit të shkollës.

Hëna, si lidhi fjongon e kuqe dhe mbësh-tolli buklet në gropën e zverkut, dolli në krye të shkallës dhe po gëzohej për ata fëmijë, që prisnin të binte zilja, për të shkuar shetitje. Një vajzë, fytyrë gjatë, me dy sy të rrumbullakët, gështënjë, i dhuroi një tufë me lule, lidhur me kujdes, me disa fije bari.

— Të faleminderit, Dritë — dhe mësuesja e puthi në të dyja faqet. Pastaj, duke i vësh-truar fustanin e ri, vazhdoi:

— Paske veshur fustan të ri sot, për ditë vere, ë?

— Po, zonjushë, ne mbrëmë hymë në koo-perativë.

Ajo e pushtoi fort pas gjoksit, e përkë-dheli me kujdes që të mos i prisheshin pliset e fustanit.

Në çdo portë fshatarët kishin vënë degë thane. Atë ditë, ishte dita e parë e pranverës.

Esmakua, si vuri në thesin me miell një degë ulliri dhe afër vatrës dy buca me bar të njomë, vari në gushë veroren dhe në pasqyrë e provoi si hapej e mbyllej, kur e tërhiqte dhe e lëshonte me majat e gishtërinjve. Gëzohej si ndonjë vajzë e vogël, dhe qeshte me vehten e saj, kur mendonte se e ëma do t'i thoshte, duke i tërhequr veroren, «plot këmishë burri». Një të kuq i ra atë çast në fytyrë, kur mendoi këto gjëra. Në sobën matanë e ëma po rrihte qumësht. Edhe ajo, sipas zakonisht, në krye të dybekut kishte vënë një degë thane.

Rrezet e diellit po hynin nëpër dritore dhe goditnin drejt në fund të odës, te pasqyra, ku bëheshin ngjyrat e ylberit.

Esmakua, si përveshi duart, shtroi në mes të odës një çarçaf të bardhë dhe mbi te vuri sofrën. Brumi, që pat zënë e ëma, ishte bërë. U ul në shesh dhe filloi të t'hollë petët. Byrekun me qumësht, që do të bënin në Bardhaj atë ditë, do ta hante Esmakua me shoqet në baçen e madhe me qershi e kumbulla.

Të ëmës i pëlqenin këto gëzime vajzërisht. Prandaj ajo, pasi rrahu qumështin, po përgatiste në një tepsi të vogël alumini, një pepeku me djathë të njomë.

Të gjitha u përgatitën. Nga hauri filloi të dalë një tym i madh. Dy saçet u bënë gati, dhe e ëma vetë i hodhi byrekun dhe pepekun, e pastaj i tha së bijës:

— Shko tani, Esmako, e vishu.

Esmakua veshi atë ditë dimitet e reja beharore dhe jelekun e kuq të qindisur me gajtanë, mëngët e këmishës i ngriti pak lart bi-

lurit për t'iu dukur llërët më të plota. Përpara pasqyrës kreu flokët, lidhi gërshetat, e duke i përmbledhur në bishtin e shamisë i hodhi pas kraheve. Sipër ballit hojat i rrinin si lulka. Një tufë i flokëve, që i delte nga shamia, në anë të majtë, ja zbukuronte ballin, të cilin kish filluar t'ja merre dielli i marsit.

Zakonisht, vajzat e mëhallës mblidheshin në shtëpinë e Esmakos se aty s'kishte mashkull. Atje qëndronin më të lira e nuk u binte rrasti të ulnin kryet, të skuqeshin përpara ndonjë burri.

Vajzat me kanistra e tepsira në duar u mblodhën në oborr. Si shtruan disa rroba në baçen prapa shtëpisë, ja filluan valles.

— Vajzë e shtëpisë, vajzë e shtëpisë, më përpara.

Esmakua nga rrethët e dimitëve nxorri një shamiçkë dhe filloi të heqë vallen.

✓ Këto çupat e sivjeme,  
Hajd, moj vetulla kaleme,  
U vijnë në ndihmë djeme,  
✓ Hajd, moj vetulla kaleme.

Pas valles së parë u ulën dhe secila nxorri ushqimet e veta. Esmakua i mblodhi bashkë dhe i vuri në një kanistër të madhe, pastaj i mbuloi me çarçaf.

Secila filloi të tregojë ndonjë gjë nga ato të shtëpisë. Njera tregonte se si kishte harruar kulaçin pa krypë, se si i qe djegur njëherë mishi.

Shoqet e ngisnin e i thoshin se kushedi ku e kishte mendjen.

E ëma e Esmakos ndenji me to një çikë, sa i puthi e i pyeti. Ç'të rrinte me to. Vashast kanë qejfin e fjalët e tyre; ç't'u bie më qafë — mendoi ajo e u ngrit e shkoi përsëri në haur.

Shkurta e Kame Gjovarfës, ashtu thatime e me një nishan në faqe, ishte shumë shakatare. Filloi t'u tregojë edhe njëherë historinë e një budallai të Gjonçejve, i cili, kur e ngisnin në fshat se kë do të merrte për nuse, thoshte «Shkurtën, Shkurtën»... dhe sa herë që vinte në Gjovarfaj për të kërkuar ndonjë gjë, gjithënjë kur binte te porta «Shkurtë, Shkurtë» fliste.

Herë-herë nga degët e kumbullave dhe qershive këputeshin lule të vogla dhe u binin vajzave në kokë.

Manushaqet e para, që kishin çelur, kundërmonin dhe disa prej vajzave u hapën të mbledhin. Ato bënë tufa të vogla dhe i vinin në anët e shamisë së kokës.

Dielli po ngjitej sipër qiellit dhe koha po bëhej më e ngrohët. Faqet e vajzave digjeshin si prush.

## KREU I KATËRT

### 1.

Ardhja e Bejkushit si kryetar i kooperativës, Razimit i qëndroi rëndë. Gjithë kohën e parë që u ngrit kooperativa, ai rrinte i ngrysur dhe sa herë që e pyste ndonjeri, ngrinte supet e i thoshte «ku di unë, s'kam gjë në dorë unë tani... i thoni kryetarit...»

— Po qysh s'di, — i thoshnin, — ti je brigadier.

— Brigadier, brigadier, po kush të pyet?

Bejkushin disa e thërrisnin në majë të gjuhës «zabiti». Dhe Razimi, kur i dëgjonte, qeshte nën buzë. Vetëm Dalipi, duke zbardhur dhëmbët, kur e takonte Bejkushin e pyeste: E, mor zabit, ç'kemi gjë? Kini bërë ndonjë mbledhje për këto punët tona? Më hangri shpirtin një përdhes, o kryetar, që më ka prerë fuqinë, sa jo që s'punoj dot me bel, po as belin nuk e ngrë dot ngá sheshi... Po kur do të ndreqemi edhe ne, o Bejkush? Kështu do të mbetemi?

— Ajo koka jote me ato tru të mykura, si sot edhe mot do të mbetet.

— Po ahëre pse e bëmë edhe ne të varfërit kooperativën?

— Pandeh të ushqehesh qyl? Punove? gëzove...

Razimi ngjitej shkallëve të zyrës së kooperativës, për mbledhje.

— Ç'e ke humbur, o Razim? — e pyeti Dalipi, që po nisej për pazar, me një shportë fiq shëngjinës.

— Kemi mbledhje.

— Me zabitin?... Zabit ja vumë e zabit është. Kur s'ke fuqi të punosh, ç'të bësh? Shogëria duhet të na hedhë dorën. Punë është kjo? Ja, me këta fiq do të blej një kuj bukë... mbahet shpirti gjallë? Kur s'hynë ca të shëndoshë, ç'do të presësh nga një takëm si ne? Ne jemi që sot për torbë. Shikojeni këtë punën tonë, me që paski edhe mbledhje... Ti jeshe për kryetar, po ç'e do... Ka hakë Malua që nuk hyn... Ja, ikën kaq kohë, ç'nxorrem në mejdan?... Vini veshin, ju djemt e vëndit... Më kërkon shtëpia bukë, ndaj vete me një shportë fiq në pazar dhe humbas punën... nuk e lë punën nga e mira... «puno, puno» thotë zabit... po për vete i vret pesëdhjetë napolona. E di ç'më tha një ditë? Isha i sëmurë e i thashë të më gjejë një punë të lehtë e ai më tha të të vëmë te derrat. Dhe ai qeshi e qeshi sikur unë isha pa brekë. Pastaj më tha më të madhen, punë pa mundim është — më tha, — të të vëmë në mes të arave, si nuse të koshrave, të tremben sorrat!

Në krye të udhës u duk Cane Vojka.

— Edhe ky s'dolli gjë... E, o Cane, mbledhje kini? Po s'na, nxuarrët gjë edhe me këto

mbledhje... Ja, mbahet shpirti me fiq? — ngriti lart shportën mbuluar me fleta hardhie.

— Prapë ike nga puna?

— Ohu! Tjetër të them unë, tjetër më thua ti. Zoti bëftë në këto punë... — dhe Dalipi, me shportën nën sqetull, iku si i rrëmbyer nga inati. Qylafi i palarë, pas një çike, nuk i shquhej fare.

Shokët e partisë u mblodhën.

Tani, me ardhjen e Bejkushit, të Dinos dhe Canes që ishte kthyer nga kursi, në Këmbëzë po ngrihej organizatë partie.

Pa filluar mirë mbledhja, Cane Vojka me Razimin u kunjisën. Fjala që për Dalipin, që sikur Dalipit shumë po ja zgjaste dhe nuk ja mblidhte për të dalë në punë.

— Po me të tillë e ngritën kooperativën!

— Qysh o me të tillë?

— Kur tjetri ka nevojë për bukë, ta dërgoj me zorr në punë? ja ke parë fëmijët e tij? Kokë — kokë i ka... të gjithë nga ai presin.

— More mblidhja! Po ai ato para raki do t'i pijë... Sa ditë pune ka?

— Ka gjithësej nja tridhjetë e pesë dit.

— Në tre muaj... Mirë, mirë... fillojmë?

Për dreitim të mbledhjes zgjodhën Bejkushin. I deleguari dhe Bejkushi zunë vend në tryezën e zyrës së Kryesisë.

Cane Vojka, në një relacion të shkurtër, si foli mbi rëndësinë e ngritjes së organizatës dhe të zgjedhieve, për forcimin e jetës së brëndshme të partisë, ja kushtoi vëmëndjen punës për forcimin e kooperativës.

«Kooperativa e jonë është e re, siç dihet,



ajo u ngrit në luftë me pikpamjet e gabuara të disa fshatarëve, të cilët, për një farë kohe, gjetën edhe përkrahjen e anëtarit të partisë, shokut Razim...»

— Janë sqaruar njëherë ato — u hodh Razimi i nevrikosur — gjithënjë tagji në hundë?

— Kur të diskutosh, shoku Razim, bën vërejtjet e tua — dhe Bejkushi i bëri me shenjë Canes të vazhdojë.

«... Po për ne të organizatës bazë, problemi më me rëndësi është puna politike që duhet të bëjmë me anëtarët, për të dalë në punë. Kemi anëtarë që i bëjnë bisht punës dhe merren me punët e tyre, më shumë me kopshtet individuale dhe për punët e kooperativës nxjerrin shkaqe të parëndësishme. Dalipi, për shembëll, në tre muaj, vetëm tridhjet e pesë ditë pune ka, le për vete, po edhe të shoqen nuk e nxjerr në punë. Brigadieri, shoku Razim...»

— Pse s'thua që kjo mbledhje u bëka vetëm për mua... — u hodh përsëri Razimi dhe u kthve në gjysmë krah.

«Shoku Razim — përsëriti Cane Vojka — pak kujdes tregon për t'i nxjerrë në punë të gjithë anëtarët e brigadës dhe lejon bujqit që, në punë e sipër, të merren me llafe dhe të humbasin kohën me gurët që hidhnin mbi shtëpinë e Elmasë...»

— Po bëhu ti ahëre brigadier... Po kjo kryesia s'paska ndonjë të metë.

— Edhe ti anëtar i kryesisë je, o Razim, — i tha Bejkushi.

I deleguari, që dinte se si kishin shkuar punët në kooperativën e Këmbëzës, i foli Ra-

zimit ta ulë gjakun dhe të mos ia presë fjalën Canes.

— Po për gjëra që s'janë të drejta...

— Kur të marrësh fjalën, pas relacionit, kritiko!

Relacioni nuk ishte shumë i gjatë. Cane Vojka mbasi preku edhe çështjen e ngritjes së stallës, që po zvarrisej, foli për punën që duhej të bënin për shtimin e radhëve të kooperativës — dhe shtroi detyrën për të plotësuar, brënda pak kohëve, mbjelljet dhe antarët të dorëzojnë nga një dele nga tufa personale, ose dhi, për shtimin e tufës së kooperativës. Ai u bëri thirrje që për këtë punë, si për të gjitha, komunistët duhet të jenë të parët...

— Kush ka ndonjë pyetje? — pyeti Bejkushi.

— Këto delet qysh tani, që janë dhe me qumësht, t'i dorëzojmë? Edhe a do të shpërblehen? A do t'ja shtrojmë këtë gjë asamblesë?

Cane Vojka vesh më vesh me të deleguarin, diçka bisedoi.

— Edhe tani me qumësht s'është keq t'i dorëzojmë, në dobi të kooperativës do të jetë. Po të duam ne, edhe pa shpërblim mund t'ja falim kooperativës. Asamblesë do t'ja shtrojmë me domosdo.

— Qartë, Razim, — i tha i deleguari.

— Tjetër?... S'ka... Ahere kush e do fjalën? — pyeti përsëri Bejkushi.

— Me leje?

— Hajde, Dino.

— Raporti m'u duk i mirë. Ne jemi gjer më sot, po thuaj njëzetekatër krah pune. Po

bëhen shumë mungesa. Sot s'dal unë, nesër s'del tjetri dhe s'bëjmë dot kritikë. Vërtetë se ne jemi kooperativë e re, e vogël, po këtu afër kemi edhe kooperativa të vjetra, që mund të mësojmë prej tyre. E pakë është kooperativa «Çlirimi»? Atje, mor zot, bëjnë nga dyqind e ca ditë pune për shoq, dhe kështu duhet. Në paç në mëndje të rrosh tetë ditë, puno për nëndë — ka thënë i pari. Do bukë Dalipi për kalamanët? Të punojë sa të lodhet, jo hop e në pazar. Edhe xha Veliu yt, Vesho, më për mbarë i vjen të kujdesë kopshtin dhe të kullosë lopën. Ai punën e rojes ka, po shumë dëme bëhen. Sa para bëjnë gjobat?

— E po me ato gjoba janë mbledhur ca të holla — ja priti Veshua.

— Pse, o Vesho, si thua ti? me gjoba do ta pasurojmë kooperativën? — e ndërpreu i deleguari.

— Atë them edhe unë — vazhdoi Dinua. Edhe Razimi s'i rri punës mbi kokë. E di si duhet t'i rrimë punës, si vaji mbi ujë. Kështu ka të mirë kooperativa dhe shtëpia.

Pas Dinos, e mori fjalën Razimi. Ai e gjeti më të udhës të mos përsëritë më ato që tha Cane Vojka e Dinua, prandaj që në fillim tha:

— Unë bëj autokritikë që i preva fjalën Canes, pa marrë leje. Vetëm se s'më duket e drejtë që të themi ngaherë ato që janë thënë e dihen. Ne jemi të pangritur, e si fshatarë kemi akoma disa mbeturina nga ato të borgjezisë, që do t'i zhdukim; pa sa për atë që u tha se ikin nga puna, ikin se kanë nevojë për bukë. Për punën time — që u kritikova — kryesia, po të

mos jetë e kënaqur, le të verë një shok tjetër... Për detyrat jam dakord.

Bejkushi, si foli për detyrat, iu kthye Razimit:

— Mua më duket se shoku Razim nuk i shikon drejt e në sy dobësitë. Nuk është puna që ta shkarkojmë si brigadier, po është që ai, si komunist, ka për detyrë të mobilizojë vehten edhe shokët e brigadës. Kooperativa e jonë e re i ka të gjitha mundësitë të ecij përpara. Tokën e kemi të mirë, pjesën më të madhe nën ujë. Po si thonë toka bën shumë, po krahët më shumë. Prandaj kritika na vlen për të përmirësuar punën tonë, jo për t'u zbythtur përpara vështirësive... Për shtallën të vihet si detyrë, po të shënohet edhe koha. Për të kam përgjegjësi unë. Dhe ditët e punës t'i ngremë edhe ne, siç po i ngrenë në të gjitha anët.

— Unë jam dakord me problemet që u ngritën. Ju kini plot detyra. Organizata e juaj nuk është edhe e vogël. Duhet pasur në qendrën e vëmëndjes punën politike me fshatarët, që t'i kuptojnë vështirësitë e fillimit e të luftojnë për t'i kapërxyer: e para; duke dalë në punë burra e gra, e dyta; duke iu bërë të gjitha kulturave shërbimet e duhura për rendimente të larta. Dalipin tuaj më shumë e shikon në pazar, se sa në arë. Po në qahet, le të qahet. Pa punë s'mund të jemi të lumë. Ndihejmojeni, po ama, ta shtroni në punë. Dhe mos harroni se armiku punon. Dalipi bëhet lehtë altoparlanti i parrullave të tyre. Po ama, duhet ditur se puna e bën njerinë njeri dhe jo pazari varavingo. Pak gojë ka Bilushi për të ushqyer? Po Bilushi

i ka të rrallë shokët: vet i tretë ka bërë në tre muaj dyqindedyzetë ditë pune. Bëjeni shëmbëll në fshat që t'u mbyllni gojën të tjerëve. Zgjedhjet, që do të bëni sonte t'u shërbejnë për një punë më të mirë, shokë.

I deleguari nuk u zgjat shumë. Veshua që merrej me agjitacionin dhe Rininë, pothuaj i shënoi të gjitha në një bllok të vogël, që e mbështillte me një qeskë mushamaje dhe e hidhte krah-qafë si çantat e shkollës.

Sipas propozimeve që u bënë, Cane Vojka u zgjodh sekretar me katër vota dhe Dinua zëvendës sekretar me tri vota. Një votë e mori Veshua.

— Të kishim byro — do të isha edhe unë — tha Veshua.

— Po të punosh me rininë më shumë e të shtohen radhët e Partisë, edhe byro do të kini, — dhe i deleguari i hodhi dorën në sup — po jo si xha Veliu me gjoba, ama.

Veshua, të deleguarin. Bjekushin e Canen i mori për darkë, Razimi nuk deshi, ai u tha se i dhëmke koka.

I deleguari nuk kishte dëshirë të rrinte, mbasi donte të shkonte në kooperativën «Çlirimi», tek e motra. Po Veshua nuk iu nda.

— E, po shkojmë ta gjobitim edhe xha Velinë njëherë — tha Bejkushi.

Dhe ashtu bënë.

## 2.

Esmakua, sipas radhës, kishte kthyer vijën e ujit për të vaditur misrin. Ajo gëzohej, kur

shikonte se misri, papandehur, filloi të kreko-  
set e të gjelbërojë më shumë. Edhe gjethet e  
fasuleve midis radhëve të misrit e lëshuan atë  
push pluhuri, që kishin zënë gjithë ato ditë.

Ngritur këmbët e dimiteve, zbathur, ajo,  
për së largu, nuk dukej fare. Era ja merrte  
shaminë e kokës dhe ja trazonte flokët, që i bi-  
nin përpara fytyrës e ja gudulisnin. Nga që i  
ngrinte me dorë, në disa vënde, fytyra i ishte  
bërë me baltë.

Në muajin e gushtit ndodh që dielli për-  
njëherësh të vishet me re të zeza dhe të shkrep-  
pin vetëtima pa pushuar. Edhe atë ditë, retë që  
u grumbulluan në Beden, kur arritën në shpat-  
tin e hapët, ku formohet një grykë, në ato ra-  
dhë kodrash, era i vuri përpara e i përhap  
sakaq në fushë. Sadoqë dielli kishte një copë  
herë që u fsheh pas reve, akoma ishte një zagu-  
shi e madhe. Disa pika shi kaluan si një e spër-  
katur e lehtë, që më shumë digjte se freskonte.  
Qielli mori një ngjyrë të murme që sapo vinte  
errësohej. Me që retë, nga era, shtyheshin një-  
ra pas tjetrës, formoheshin në qiell gjithfarë  
figurash. Larg vetëtium dhe u dëgjuan disa shkrep-  
pëtima të thata. Kjo kohë Esmakon e trëmbi. Ca  
nga frika, ca nga të lodhurit, dolli buzë ledhit  
dhe po rrinte në këmbë nën një radhë plepash  
të lartë, që fëshfërinin me shpejtësi. Vuri do-  
rën dhe po shikonte se mos shquante ndonjë  
njeri në fushë. Buzë vijës pa se po vinte Bej-  
kushi. Ju duk sikur zemra iu këput. Nga gëzimi,  
a nga turpi, as ajo s'e kuptoi dot. Bejkushi sa  
e pa, iu afrua Esmakos:

— Mbarove?

— Jo, kam akoma gjysmën.

Shiu po qasej i dëndur dhe po qasej me nxitim.

Bubullimat u afruan. Qielli u bë pus i zi.

— Qyqja! — dhe Esmakua, pa kuptuar, u gjënd në krahët e Bejkushit.

Një shkrepëtimë e madhe shpërtheu fare pak lark atyre plepave, që tani po lëkundeshin, sikur do të thyheshin. Drita e vetëtimës, si gjarpër përshkoi një hapësirë të madhe. Zëri i bubullimës vazhdoi përsëri.

Shiu u largua dhe, me shpejtësi, një erë e madhe i kapërceu plepat dhe dielli filloi të dalë.

Esmakua me rrëmbim e hoqi kryet nga gjoksi i Bejkushit dhe për një copë herë, sytë nuk i lëvizi fare. Fytyra e saj, që, pak më parë, kishte marrë ngjyrën e limonit, u skuq prap si ndonjë lulekuqe. Bejkushi, që s'ia kishte hequr akoma dorën nga shpatulla e saj e hapur, pjekur në rrezet e diellit, po e shikonte drejt në dritën e syrit. Ajo me shkathtësi i uli sytë dhe u shtëmëng. Për pak, Bejkushit i mbeti dora ashtu hapët, siç e pat mbi shpatullat e saj. Edhe ai u turbullua, e s'dinte ç'të bënte.

Esmakua mori përsëri shatin dhe po futej në arë.

— Ke akoma?

— Kam edhe gjysmën! — iu përgjegj ajo me gjysëm zëri. Gryka i qe tharë dhe mezi po shkonte pështymën. Si kapërceu vijën, i hodhi fytyrës nja dy grushte me ujë, ndreqi shamënë e i mblodhi flokët me kujdes, që të mos i binin më mbi fytyrë.

Pas atij shiu, ashtu me rrëmujë, nëpër fushë nisi një erë e freskët; gjethet e misrave, duke u përpjekur njëra pas tjetrës, nxirrnin një fëshfërimë të këndëshme, që përzihej me atë të gjetheve të plepave, dhe pastaj humbiste ngadalë-ngadalë poshtë fushës.

Esmakua, duke vaditur misrin, u ngrit disa herë në këmbë. Bejkushi po ngjitej në fshat.

### 3.

Më në fund Razimi ja dha fjalën Malo Bonjakut për Larushen, e cila jo vetëm që ishte e bukur dhe plot shëndet dhe puntore, po kaq vjetë që jetonte te Bonjakajt ishte bërë si vajzë e tyre dhe fshati, thuj, nuk e quante më si të bijën e Xhezair Kokëziut.

Po kjo fejesë e papritur, mjaft fshatarë i çuditi dhe disa zunë të hidhnin nga ndonjë fjalë. Prandaj urimet, që të ëmën e Razimit e gëzonin pa masë, atij i shponin veshët, sidomos në fillim të darkës, kur shumë të ftuar ende nuk po i vinin.

Malo Bonjaku në haur, përveshur duart e hedhur një mandile në sup, po i thoshte Çunes ta rrotullonte me kujdes mishin dhe, herë pas here, ta pikonte me flamurin. Me një mashë të gjatë e mënjanoi vetë prushin dhe e hapi në gjysma rrethi. Pastaj mori kukurecin dhe, si e preu pjesë-pjesë, e hodhi në një apllalle cingo dhe e mori me vehte.

Në odën e madhe Razimi, me ata miq, që i kishin ardhur, rrinte si i mpirë. Një fytyrë i shkonte, një fytyrë i vinte. Malua, duke e vënë



re shqetësimin e Razimit, për t'u hapur muhabet miqve, e ngau:

— Mos iu mendo djalërisë, po gëzoi miqtë. Të gjithë e kemi shkuar këtë radhë — dhe e vendosi në sofër apallallen me kukurec, që mbushi dhomën me një erë, e cila të gjithëve u giciloj hundert e u hapi oreksin për të pirë.

— Merrni nga një meze.

Mysafirët u lëshuan në të si dhëntë në kripë.

— Po marr edhe një — tha xha Sopi — se qënka i mirë. Nuk them, edhe mëlçitë janë të mira, dhe së bashku me kukurecin mori edhe dy copa mëlçi; — po kukurecin çoç e kam pasur me sevda të madhe — nga bulçijt e mbushur, fjalët i nxirrte gjysma-gjysma.

Sofra e madhe, e mbuluar me mezera, u a bënte pizili. Po asnjëri nuk po qasej.

— Do presim më? — pyeti Dalip Zeshkani.

— E ç'të presim më?... Kush të vijë, mirëse të vijë. Ata që ishin për të ftuar, ne i ftuam — iu përgjegj Malo Bonjaku, i cili atë natë, si vjehërr, po bëhej edhe ai i zoti i shtëpisë. — Urdhëroni... Ngreu, Razim, e mirseardhi miqtë.

— S'na erdhi Bejkushi... —

— E po ruan klasën — i tha Malua nëpër dhëmbë, duke mbushur gotat e rakisë.

Tri llamba të mëdha llamburitën dritaret e odës së madhe të Razimit. Miqtë rreth sofrës, me gotat përpara, po rregullonin në pëqi sofrabezin dhe prisnin të ëmën e Razimit për ta uruar. Sa erdhi e ëma, Razimi, duke marrë gotën, iu drejtua miqve:

— Mirse na urdhëruat, shokë, edhe në shtëpitë e zotrisë suaj.

— Të trashëgohesh, Razim!

— Të trashëgohet, nënë e Razimit...

— Dhe në vatrën tuaj...

— Malo, të trashëgohen... në dasmë të vëllezërve.

— Ja u paçim hua...

Në fillim rakia kaloi kështu dorë më dorë, me këto urime. Dy djemt e dajës së Razimit, i plotfuqishmi i grumbullimit dhe rojtari i pyjeve, të cilët kishin ardhur që në drekë, ishin më të çlodhur nga Dalip Zeshkani e xha Sopi. Prandaj ata nisën t'i fshikin gotat njera pas tjetrës, me fund.

— Mirse të gjej, o i plotfuqishëm — iu drejtua Dalip Zeshkani — shëndeti i Razimit. Të na trashëgohet.

— Mirse më vjen. Ti që më gjete mua, të gjettë e mira. Ky është shëndeti i Razimit...

— Nderi i zotrisë suaj e i atij që e ngriti — ja preu fjalën Razimi.

— Dollibash, të na trashëgohet... udhë.

— Bjeri Malos...

Dollia që ngriti Dalipi për Razimin, zuri sikur t'i mënojë ca gotat, po më shumë këngët, që filluan, njerën pas tjetrës, dy djemt e dajës së Razimit dhe rojtari i pyjeve, që ja kthente me grykë.

— Ore, ku ka mbetur dollia? — e ndërpriste ngandonjëherë Dalipin xha Sopi — ngaje një çikë.

— O dollibash, kujt t'i bije? — e pyeti Mahua.

— Sopit...

— Mirë se të gjej. . . apo s'më pret mua, se s'kam hyrë akoma në kooperativë.

— Jo, mo, këtu të pres. . . po edhe atë punën e kooperativës si rrotull shumë po e bije. Ja, të ta them, janë edhe këta miqtë. . . T'ua them, more vëllezër, ne na duhen ca copa si ky, në kooperativë, se jemi shumë hollë. . .

— Po pse e vonon, o Malo? Ta kam thënë edhe njëherë tjetër, mos na e hedhësh. . . — dhe i plotfuqishmi e shikoi në sy, pak si i zemëruar me të.

— Dhe unë i kooperativës jam. . . Ja, një krah pune u a jap sonte. . . Dinon u a kam dhënë. . . po e dinë fshati punën time, sa të ndreq ca punëra me vllzëri. . . Shëndeti i Razimit, Sop, se t'u tha gryka. . .

— Se mos i hedhësh qoftën Razimit — ja preu fjalën rojtari i pyjeve. . . Iu drejtua Razimit — Mos ha sonte qofte. . . se janë magjistarë të mëdhenj këta Bonjakajt.

— I kam gatuar unë — u hodh mëma e Razimit.

Dollia, këngët dhe gëzimi, që ndjenin mysafirët, Razimit nuk i zinin fare vënd. Fjalët e rojtarit të pyjeve, Bejkushi e Cania, që nuk i erdhën për darkë, edhe atë pak raki që pinte, ia bënë ujë.

— Hë, Sopi. . . dollinë. . . — i foli Dalipi.

— Pse? E piva unë? . . . Në kam gabim, dënomë.

— E piu, e piu. . . po dënoje.

— Mirë, o Dalip, vra, pre, po gjak mos kre. . . po e pi edhe një. . . udhë.

— Te ky i pyjeve. . .

Mishi i pjekur në mes të sofrës, kundërmoi.

— Çunia e ka pjekur? është usta!

Malua i vuri të plotfuqishmit bishtin dhe rojtarit të pyjeve kokën me një brinjë në gojë. Xha Sopit po i delte syri për veshkat, që nuk shquanin nga dhjamët. Dalipi qe më i shpejtë. Po edhe xha Sopin nuk e la Malua. I vuri përpara një shpatull.

Darka vazhdoi gjer në mes të natës, megjithëse u shtrua buka, mysafirët, të veleritur nga mezetë, hëngrën maja-maja, sa për të bërë zakonë.

Kur u shtrinë për të fjetur, e ëma e Razimit i tërhoqi Razimit, nga sheshi i kokës, tri qime dhe, si i lidhi tri herë nyja në një ushkur, i hodhi në fund të arkës së saj.

#### 4.

Xha Sopi, në haurin e qeve, po grumbulloste plehun. Përveshur gjer në gjunjë, qe bërë, nga këmbët e gjer në kokë, pleh i gjallë. Si e mblodhi të gjithë plehun në të hyrë të haurit, u ul dhe priste fshatarët të vinin për ta marrë. Ndezi çibukun. Pastaj hoqi nga qafa një qeskë prej mushamaje, zbrazti në pëqi një tok me gurçka dhe, duke i ndarë në dy grupe, i numuroi me radhë një e nga një.

— Domethënë njëzetedy ditë dhe tetë gjysma katër ditë. Domethënë njëzetegjashtë. — E hoqi me dëshirë çibukun dhe lëvizi kryet i gëzuar. — Njëzet e gjashtë ditë pune s'i thonë shaka, se kam qenë edhe i sëmurë, po kam bërë edhe mbledhje jashtë zakonit.

Pasi erdhën fshatarët dhe muarrën plehun, xha Sopi e pastroi edhe një herë haurin.

— Prapë do ta fshish? — Nënë Gjelina, me një dorë bar në sjetull, po vinte që prapa haurit.

— Gjynah është... edhe kafshët e duan rehatin. Pastaj dua ta bëj ditën tamam.

Ajo iu qas më afër dhe po i fliste me të drojtur:

— O Sopi... Sopi...

— E, moj, ç'ke?

— Nuk erdhën akoma qetë?

— Ja, tani vijnë...

— Se i kam prurë kaziut një dorë bar...

— Hidhe, këtu në tog.

— Të marrça të keqen, lemë t'ja jap vetë.

— S'ka këtu punë me dollape. Unë?... E sheh këtë faqe? Nuk e nxij. Apo të thonë që xha Sopi mban me hatër?

— E pa... mbase s'na sheh njeri. Të marrça të keqen. Se më duket sikur e kam jetim. Kaziu i nënës. Ti e di se si e kam rritur unë atë ka. E ke vënë re që është dobësuar një çikë?

— Jo, jo! Këtu qetë janë njësoj. Qysh thua ti? Njeri të hajë më shumë dhe tjetri të ngrerë kokën?

— Na, mo Sopi, se të kam prurë një grusht duhan.

— Moj, unë s'jam kundër që t'i japësh Kaziut një dorë bar, se nuk u bë kjameti... po ç'e dëgjon botën? se je një gojëshpuar ti...

— Unë? Na, u verbofsha, në i kam për t'i thënë gjë njeriut.

— E mirë, lere aty më njanë, pa bjere duhanin.

— Jo, jo, dua t'ja jap vetë.

— E, po mos do të vish në vëndin tim atë-  
here, kur të them unë, flije mëndjen.

Nënë Gjelina e la barin dhe i hodhi xha Sopi në shami një dorë duhan. Kur po largohej i bëri njëqind bera.

— Moj, na, se mos i thuash njeriut?

— Ja, më plaçin këta — dhe vuri dorën në sy.

— Jo, jo, se për sytë ti bën be njëqind herë. Ti ata, ç'të të pëlccasin më, nuk i shikon si të rrjedhin, bën be tjetër.

— Për atë vakëf...

— Moj, lëre vakëfin; tjetër, tjetër...

— Për kokën e Canes, që e kam një fill të vetëm, e për shpirt të atij tjetrit, që ma ka djegur zemrën. — Ç'do më? Sopi, për kokën tënde, jepja Kaziut... —

Kur erdhën qetë, xha Sopi i vendosi të gjithë sipas radhës. Kooperativa e Këmbëzës kishte gjashtë qe. Kaziu i nënë Gjelinës, me një bri të thyer, e kishte mësuar vëndin e tij dhe, duke u shtyrë me një shok, e futi kryet shpejt e shpejt në grazhd.

Xha Sopi grazhdet ua kishte rregulluar mirë.

Nënë Gjelina, nga frika se mos Sopi e gënjente, u kthye nga rruga dhe po vështronte nga dera e haurit Kazinë, i cili po e soste barin dhe bari i saj kishte mbetur në qoshe.

— Sopi... o Sopi, — i foli me zë të ulët.

— E, moj? Ja hodha, ja hodha!

— Jo, more Sopi, ja tek e ke...

— Po ik të thashë de, se mos na shohë njeri...

— Të keqen... hidhi një dorë sa ta shikoj me sy, pastaj po ikij... Apo të vij vetë, në të vjen rëndë... pa të jap edhe një grusht duhan tjetër dhe, anës e anës, u fut brënda në stallë. E rrëmbeu dorën me bar, ja hodhi me të shpejt Kaziut në grazhd dhe i ndënji pranë. E shikonte me ngashërim. Kaziu, ktheu sytë nja dy-tri herë, kur nënë Gjelina po e përkëdhelte në kurriz dhe pastaj vazhdoi të hajë i qetë. Lariku afër tij u mat të rrëmbente ndonjë gojë bar, po nënë Gjelina e shtyu me bërryl.

Xha Sopi e vështronte nënë Gjelinën me vërejtje. Kaziu ishte nga fundi i të ngrënit dhe ajo e kënaqur u nis për të dalë.

— Dale — i tha xha Sopi — dhe nga dera shikoi me vërejtje rreth e qark.

— Ikë tani... .

Një pionier e thirri xha Sopin të vinte nga Kryesia.

— O, të shkretën, ç'më polli. Po kur e muarrën vesh? Dhe zuri të mallkojë nënë Gjelinën.

Këtë punë, që i kishin dhënë e kishte shumë të mirë. Qe mësuar me këta qe, sikur të kishte një jetë të tërë. Emrat ua dinte, atij ja kishin mësuar zërin, e njihnin që për së largu. Tani edhe këtij do t'i vinte keq po ta hiqnin.

— Ku doli kjo shtrigë, sikur e pruri djalli të mallkuarën. Ndaj e ka bërë zoti, për prapësira.

Duhanin e hoqi nga kutia dhe e vuri në strehë të haurit.

— S'kanë përse të më thërresin, për këtë punë më thërresin. Domosdo për këtë, përse tjetër?...

Dinua, sa u kthye Malua nga kasollja e qeve, pa pritur të ulej mirë në shesh, i u drejtua e i tha:

— Kjo s'mban më. Është e tepër kjo rroj-tje kështu.

Malo Bonjaku i hodhi një vështrim të egër.

— Mos më vështro ashtu, po eja në vete.

— Pse? Ç'kam bërë?

— Ç'të bësh më? Me të gjithë po bëhe hasmë.

Çunia, që dridhej përpara të vëllait, e shtyn-te Dinon me dorë, që të pushonte.

— Ikë, more dhe ti. Unë jam i ri, dua të rroj.

— Po rro, kush të mba? Ti u ndave. Merr edhe plaçkat e mbushu.

— Do të marr pjesën, që më bie nga babai.

— Hë! Hë! — qeshi nën buzë Malo Bonjaku. Pastaj, duke u ngritur më gjunjë, i ra gjoksit.

— Këtë mall e ka vënë ky kokall. Kam punuar tërë jetën për të ndrequr shtëpinë e t'ju rrit juve. Dhe ju kam ushqyer si thëllëzën. Hajd, dil jashtë nga ke ardhur.

— Nga më nxjerr jashtë?

E shoqja e Malo Bonjakut, duke mbështetur kokën pas murit, u shkreh në vaj.

— Unë s'u jap mallin atyre, që s'kanë bërë kurrë prokopi. Unë s'jam mësuar të kem njeri mbi kokë — dhe Malo Bonjaku, që ishte bërë baltë në fytyrë nga inati, e vështroi në dritë të syrit. — Jo. . . Në shtëpinë time, s'të bie asnjë qime.

— Ti je mësuar, more vëlla, të sundosh si zot. Ikën ato kohëra, more vesh? Unë s'jam rob,



po jam njeri i lirë dhe ti në do të mbytesth, unë s'kam qejf. Me profkat e Razimit u ngopëm. More vesh? Ti do njerëz si ky guaku këtu — dhe i tregoi të vëllanë, Çunen.

Ishte e para grindje e madhe, që po bëhej në shtëpinë e Malo Bonjakut.

Shkurta e Kame Gjovarfës, disa ditë më parë, pat ardhur nga fusha së bashku me Dinon. Gjatë udhës ajo i kishte folur atij me përzemërsi dhe, me që një herë i tha se kishte të drejtë, ajo i pati thënë:

— Ndahu, more budalla. Nuk dëgjon se ç'thotë bota për të? Raki natë e ditë. Ju punoni e ai bën qejf. Ti je edhe antar partie. Ai donte të bëhej për vehte kryetar i kooperativës.

— Po është edhe i zoti, ama. Dhe më duket se s'është mirë të ndahemi me të keq? Ai mua më ka rritur. Si më la babai mua? Një kërthi. Gruaja e tij më ka larë edhe brekët. Nuk të vjen një çikë si likësht të ndahesh?

Malo Bonjaku kishte mbetur si no njëzet e pesë vjeç, kur i vdiq i ati. Të dy vëllezërit e tjerë ja kishte lënë të vegjël. Pas martesës dhe pas vdekjes të së ëmës, Malo Bonjaku u kthye nga gruaja dhe e mbesa, Larushja. Të dy vëllezërit djem ishin, gjer sa të bëheshin për martesë, kushedi se si do ta kishin të thënë. Duke i pasur akoma të mitur të dy vëllezërit, i hodhi vetë dorë mallit. Të voglin e dërgonte me bagëti. I madhi, si i trashë që ishte, bënte punët më të rënda; për vehte Malo Bonjaku merrej me jashtë, me pazarin, me harxhet dhe rregullin e shtëpisë. Ai që bërë bubë e shtëpisë e s'pyeste për njeri.

Atë natë, deri von, të dy vëllezërit u hëngër shoq me shoq keqas.

— Mendo një çikë, more burrë — i tha e shoqja në mëngjez, kur po pinin të dy bashkë kafënë, në haur.

— Eh, moj grua, s'e di ti ku rreh çekani. Na janë futur bota brenda e po na prishin shtëpinë. Ai do të hyjë dhëndërr te Kame Gjovarfa.

— Po le të hyjë.

— Dhe unë ta ndaj mallin me të e ta gëzojë Kamja. Asnjë gjë s'i jap. I kam vënë vetë. Vetë do t'i ha e do t'i pi. S'më dha zoti një djalë; do t'u vë lulen dhe të shkoj të punoj ku të jetë; në minierë në i lënçin këta të bëjnë si të duan ama, se unë e kam bërë një letër për lart. U mbloodhën gjithë berbeculët dhe tani po na e hypjnë neve, njerëzve të ndershëm në qafë. S'është bërë akoma Bejkushi të më urdhërojë mua.

— O Malo, — i foli Veshua — të duan andej nga këshilli.

Malo Bonjakut iu pre gjaku. Ç'të më duan vallë? — mendoj me frikë.

— Mos ka ardhur gjë përgjigje e asaj letrës — i tha e shoqja.

— Mirë thua — dhe me një herë ndjeu një lehtësim; sa mbushi kutinë me duhan, u nis.

Në zyrën e këshillit, Malo Bonjaku u ul në një fron dhe pa e bërë vehten fare, pyeti:

— Më thirrte?

— Po — iu përgjegj Nuredin Bardhi, që qe zgjedhur kryetar i këshillit, në vënd të Razimit.

— Ne të thirrëm. Dëgjo këtu ti, Malo. Ti s'po rri mirë — i foli Cane Vojka.

— Më thoni ç'kam bërë? Në kam gabime, në dorë më kini, vramëni. — Në fytyrë s'i mbe-  
ti një pikë gjak. Buzët i zunë një makë të bar-  
dhë.

— Ne nuk vrasim njeri!

— Atëhere më dërgoni në gjyq. — Një të  
qeshur me pahir i përshkoi fytyrën.

— S'është puna të të shpiem në gjyq. As të  
kemi thirrur të të pyesim si në gjyq. Ne kemi  
vendosur të të ndihmojmë edhe një herë. Po ta  
them për herë të fundit ama. Qartë?!

Këto fjalë Malo Bonjaku mezi i përtypi, dhe  
një dridhëm frike i përshkoi trupin. Me rrëm-  
bim hapi kutinë dhe bëri një cingare, pa sosur  
akoma tjetrën.

— Ne nuk të shtërngojmë të hysh në koo-  
perativë. Ti shiko dhe bën. Po me Dinon zgji-  
dhi punët vëllezërisht e jepi pjesën që i takon,  
me të mirë; nuk bën të vini gjyqeve.

— Le ta marrë ç'gjëmë nga babai. Mallin  
tjetër e kam vënë unë vetë — dhe i ra gjoksit.

— Pse flet kështu, more Malo Bonjaku?  
Vuri gishtin kokës. Neve të duam, pa të flasim  
— iu drejtua Nuredin Bardhi.

— E shoh. Po nuk ja kam kohën për të  
hyrë tani në kooperativë. Më parë, në kohë të  
luftës, kam qenë i mirë. Më von më muarrtë me  
këmbët e para.

— Dhe kishim të drejtë, se ti mirrje bujq  
me mëditje.

— I mirrja nga halli, se kisha vëllanë e  
vogël ushtar. Me se t'i bëja ballë bujqësisë?

— Po ti merr edhe tani.

— Kush do, vetë, pse të mos e marr?

— Je prishur, Malo.

— Më prishtë ju, sa më thatë: do të të bëjmë edhe kulak... Po ç'i duam fjalët — i nevrkosur, duart i dridheshin — lemëni t'ikij nga fshati.

— Jo. Ne duam të jesh këtu me neve, të punosh me ne bashkë.

— Të më donit, kishit menduar me kohë edhe për mua, jo tani që zutë kryet e punës.

— Ashtu?!

— Të thashë, Cane, lemëni t'ikij. Do të shkoj në një kooperativë tjetër, po jo këtu.

— Të qartë jemi.

Malo Bonjaku, që dridhej si purtekë, vuri kasketën dhe ngriti jakën e palltos majë supit; mezi po i hidhte këmbët.

## 6.

Megjithëse kooperativa e Këmbëzës ishte e re, agronomi i rrethit, në mbledhjen e aktivitetit të partisë pat propozuar që t'i jepen edhe kësaj, katërqind fidane portokalle, mbasi, në të hyrë të fshatit, ka një vënd shumë të përshtatshëm.

— Ohu, tani e gjetën — thanë ca, kur e dëgjuan.

— Ku dimë ne të rritim portokalle në një bllok të tërë? Kush ka këtu portokalle? Tri, katër shtëpi.

— Po kësaj i thonë prit gomar të mbijë bar. E dini sa kohë duan portokallet që të prodhojnë? Ja, unë, që jam në këtë moshë, s'dihet a do t'i arrij dot. — këceu në fjalë Dalip Zeshkani.

— Të na kishin lënë ca kohë, sa të mirrim vehten. Ne kemi nevojë për sot. Tani gropa do të bëjmë, apo do të korrim grurin e të përgatitemi për bostanet — tha Kame Gjovarfa.

— Ç'u ka hypur kështu, more derëzes. Pritni njëherë të vijnë ata që kanë vajtur në rreth, të na thonë edhe ata se si e kanë parë, se s'e kanë prerë kështu qesim, pa u menduar — u foli Bilush Rrumbullaku.

— Shitna mënd dhe ti, o Bilush — ja pritni persëri Dalipi.

— More, këto janë dhe gjëra që ngjasin, po dëgjoni një çudi tjetër. Kanë urdhër të dërgojmë një njeri që të mësojë të mbarsë delet, ja preu fjalën xha Sopi, që sapo vinte nga fusha.

— Je në vete?

— Jam, s'jam në vehte, njerinë e kërkojnë dhe e kërkojnë orxhent. Dhe thonë që të jetë i vendosur.

— Ç'thua, mor teveqel. Atë e bëjnë me gjël-përë.

— Ama e gjete. Ç'na the dhe ti, pse ke dëgjuar ndonjëherë të mbarsen hajvanatë me gjël-përë? Edhe miza, që është mizë, ka marifetin e saj. Këtë e thonë edhe librat e shënjtja.

— Ç'përrallis, more Sop? Ç'përrallis? — ja preu fjalën Bejkushi, që sapo vinte nga rrethi.

— Ja, themi për këto që dëgjojmë, se djali i Bilushit vajtku në kurs, për të mësuar të mbarsë delet.

Bejkushit i hypi një të qeshur, që s'mbahej dot e s'po thoshte asnjë fjalë. Pa ditur, zunë të qeshin të gjithë.

Pastaj Bejkushi u shpjegoi se si delet tona

nuk kanë lesh për të qënë, se ato janë të vogla.

— Për këtë gjë Partia dhe qeveria kanë vendosur që, me një rracë, Cigaja, të kryqëzojmë delen tonë. Do kemi më shumë lesh, se çdo cigajë, që i thonë Merinos, ka tri kilogram lesh e me të bëhen 9 metër stof i klasit të parë. Ky kryqëzim bëhet me «ndërzimin artificial».

— Aaa! Ndërzim qënka. Po sa na kanë caktuar të ndërzejmë ne?

— Ç'flet, mor budalla? Ku kemi fuqi ne? ai që është djalë thuaj.

Nusja e Lames, që po vinte nga çesmja, u ndal që të dëgjonte.

— Ik ti, ik, se këto janë punëra të burrave e s'bën t'i dëgjosh — iu akërua xha Sopi. — Edhe këto të mësoni, pastaj...

— Po dashi duhet të ushqehet mirë — vazhdoi Bejkushi, — e para tri vezë në ditë.

— Ehë!... i varfëri.

— Qumësht...

— Pa shiko, pa shiko... i varfëri.

— Po si do t'ja japim qumështin?

— Si do t'ja japim? ja, me bocë, si ua japim të vegjëlve, mos na pre llafin — ja priti përsëri xha Sopi, që kishte mbështetur mjekrën mbi të dyja duart në shkop dhe dukej si nuse kopshtrave.

— Jonxhë... tagji...

— I varfëri!

— Pse s'thua të na kishte bërë perëndia desh këtë radhë, Veli — iu drejtua xha Sopi.

— Të të kishte bërë ty, që s'ngope kurrë.

— Domethënë — tha përsëri xha Sopi — djali i Bilushit s'ka të bëjë gjë me këtë punë.

— Djali i Bilushit do të mësojë se si bëhet ndërzimi artificjal.

— Nuk thash unë që këtë punë e bëjnë me gjëlpërë?

— Ti tani e dëgjove nga Bejkushi, se mos ● dije edhe më parë.

— Po a kemi ne të tillë desh?

— S'kemi, po do t'i biem. Dhe kanë prurë.

— Ku i vete mëndja njeriut, ë? E ne n'ato kohëra na thoshin gjithënjë një fjalë «në dhash-të perëndia». Kur u martova unë, e dini ç'më thoshin? «Të trashëgohesh e me një djalë». «Në dashtë perëndia» thoshte ndjestë pastë mëma. U prish koha, thoshin, mbase bije ndonjë çikë shi, «në dashtë perëndia»... si ajo pun e Nas-tradinit, që i thosh së shoces një natë: «grua, më duket po na vjedhin gomarin, apo jam në ëndërr? «Ëndërr qoftë, more burrë», në dashtë perëndia». Po në mëngjes mbeti pa gomar.

— Lena, o Sopi dhe ti tani. Këtu po thonë gjera të rëndësishme.

Veli Çuka këto i dëgjoi me pishmanllëk. Më në fund iu kthye Bejkushit.

— More Bejkush, këto që na the të vërteta janë, apo u mbajte ison përrallave të Sopit.

— Të vërteta, të vërteta.

Ai ngriti supet dhe duke mbledhur buzët, tundi kokën me çudi.

— Nejse, po shiko mos të të marrë perëndia mëndjen e pranon në plan të ndërzejmë dhëntë kështu e me kë? me djalin e Bilushit, se na e mori lumi atë kope. aë mezi e vumë. Na caktuan ato katërqind rrënjë portokalle, lena me to.

— Mirë që merrem me qetë — tha xha Sopi. Po me këta deshtë është më mirë, se kanë të ngrënë. —

Kryesia e Kooperativës u mblodh që atë natë dhe bëri planin e gropave. U vendos që Nuredin Bardhi e Cania, të nesërmen të fillonin e të bënin një pikezim, ku do të hapeshin gropat.

Shumë gra kundërshtuan. Burrat, për të mos dalë për vehte si shkaktarë që kundërshtonin, kishin ndezur grat' e tyre.

— More Bejkush, ç'është kjo? Sos që edhe bërëqetet i bashkuam po tani t'i lemë pa korrur. Ku bëhet kjo? Tani në valë të punës?

— Po kohës së duhanit, që po fillon, si do t'ja bëjmë?

— Pa le bostanet. Ne këto kemi qar, të zëmë ndonjë lekë me kohë.

— Dëgjoni, moj motra. Të gjitha i kemi menduar. Dhe ne s'bëjmë kuturum. Po edhe fidanet e portokalleve duhen mbjellë. Ato kanë shumë leverdi.

— Ohu! Kur të bëhen ato, neve na bien dhëmbët. . .

— Po ç'ka në na rënçin, portokallet janë të buta. Hëni tani, hëni, mos humbisni kohë. Gjer tani do t'i kishim hapur kushedi se sa gropa.

— Sot po punojmë një herë. Pa ti ngreu e hajde në rreth e thuaju që ne kemi hallet tonë. Ta dish. Po s'vajte ti, fundja dërgojmë njëri tjetër.

— I shikon këto qelbësira? — i thoshte me avash Cane Vojka. — Ato të dyja ball' i gjallë kanë qënë. Njera nga ato është nga Kokëzinjtë, halla e Razimit: ç'është një ajo!

Nga të gjitha, Esmakua s'po fliste asnjë



fjalë. Herë — herë shikonte Bejkushin dhe, kur ai i hidhte sytë, ajo skuqej dhe ulte kryet. Llërrët e përveshura i shkëlqenin nga rrezet e diellit. Bishtin e shamisë, me theka, e kishte hedhur mënjanë të supit dhe i varej gjer poshtë krahërorit.

Gratë më në fund u bindën. Të katër skuadrat me burra e me gra, u nisën dhe, sa shkuan, zunë nga puna. Nuredin Bardhi e Cane Vojka bënë gjithë punën e piketimit dhe në çdo vënd, ku duheshin çelur gropa, kishin vënë nga një shënjë me gëlqere.

Esmakua i ftoi skuadrat në gara. Në një copë kallam lidhi një shami të kuqe.

Komisioni i garave rrinte nën një gorricë dhe shënonte sa gropa hapte çdo skuadër dhe çdo individ.

— Qënka punë e mirë të të vënë në komision si ky i yni, se hem bëhe i madh, hem ngrohe në diell.

— Hem edhe s'lodhe.

— Ç'thua dhe ti, s'lodhe. Po gjithë këto shënime që mbajnë?

— Mos doni, gjë brisk, se mos u thyhet maja e kalemit?

— Shtrihuni një çikë se u këputët.

— Mos doni të këmbeheni?

Vetëm me këto fjalët e fundit, ata të komisionit nuk qeshën. Duke vështruar njeri tjetrin, kruajtën kokën si me të tallur. Pasdreke, gjithë terezinë e tyre e prishi teto Qerimeja. Ajo tha që ta marrë këtë punë Nuredin Bardhi dhe ata dy të tjerët, më mirë të hapin gropa.

— Edhe unë jam dakord — tha Cania. — Ç'thua ti, Bejkush?

— Ç'të themi? Ka thënë ndonjë fjalë pa mënd teto Qerimeja, gjer më sot?

Këtë vendim që e pëlqyen të gjithë, ata të komisionit e pritën me buzë të varura.

Në mbrëmje, Nuredin Bardhi, si mblodhi të gjitha pikat e i llogariti, mori atë kallam, ku Esmakua pat lidhur shamin e kuqe dhe me gëzim ja dha asaj.

— Merre, moj bijë.

Nuk shquaje dot, kush ish më e kuqe, kaq u skuq ajo. Të gjithë i dhanë dorën. Bejkushi ja shtërngoi më fort se të gjithë. Ai s'deshi t'ja lëshonte, po asaj i ra në mënd shpejt, se kishte shumë njerëz dhe, duke dashur të merrte flamurin, e tërhoqi dorën.

Pas skuadrës së Esmakos vinte ajo e Bilush Rrumbullakut.

Bejkushi, me që ishin atje të gjithë anëtarët, gjeti rastin e u foli edhe një herë për portokallet.

— E po për të mirën tonë është edhe ajo, o Bejkush — i tha Nuredin Bardhi — s'do të mendojmë vetëm për vehte, do të mendojmë edhe për këta të rinjtë.

— Pse? Mos do të vdesim? — u hodh teto Qerimeja. — edhe ne do t'i gëzojmë.

Këmbëza një fshat në brinjë,

Gjithë ja kanë zilinë...

Nëpër fushë jehona e këngës u përhap me shpejtësi.

Malo Bonjaku, pallton në sup, festen kadife në mes të kokës, duke ecur rrugës me shpejtësi, fshinte me një shami pëlhure djersët dhe bisedonte me vete, si i marrë.

Me gropat e portokalleve, kooperativa i preu rrugën e bostanit.

Me të hyrë në zyrën e Kryesisë, ai me akërrim, iu drejtua Bejkushit:

— Pse na pretë rrugën e bostanit. Atje e kam pasur kadimi rrugën, more shoku Bejkush.

— Unë nuk e di.

— Po nuk e di, pyet, se kooperativa s'është që t'u hedhë litarin individëve.

— Pse, kush të tha tyj se duam të të hedhim litarin? Portokallet i mbjellim për kooperativën. Dhe fshati do të bëhet i tëri kooperativë. Edhe ti në paç kokë do të hysh në kooperativë.

— Kur të më mbushet mëndja. Në kooperativë, me belara dhe pa kokë, unë nuk hyj...

— Mirë, prit sa të vëmë një kokë në kooperativë. Apo... — dhe Bejkushi e vështroi drejt në sy.

— Pse më vështron sikur do të më hash?

— I zgjuar je.

— Mos dua për vete? Kush të ka thënë? — Malo Bonjaku zuri me dorë mustaqet fufa, të prera pak anëve.

Bejkushi, gjithënjë duke e vështruar me bisht të syrit, bëri buzën në gaz dhe, me dorë, ngriti flokët.

— Ti vetë e the «unë s'hyj në kooperativë me belara dhe pa kokë».

— Ore. Me ju s'mirret vesh njeriu. Ju e bëni të bardhën të zezë. Pak deklarata kanë shkruar për mua?

— Dhe nuk kanë gënjyer. Shiko, Malo Bonjaku, ti s'po qëndron mirë. Ti në pazart me lloj-lloj njerëzish po pi e këshillon.

— Pse, është e ndaluar?

— Po. Për njerëzit që e duan Partinë dhe pushtetin. Ti të pakën kështu ke thënë.

— Juve s'ju hahet muhabeti me mua...

— Ty të hahet edhe me kulakët.

— Çpifje! — u ngrit e doli me rrëmbim, duke përplasur derën. Bejkushi e ndoqi prapa dhe në krye të shkallës e kapi për krahu.

— S'është dera e shtëpisë sate ajo që përplase, more vesh? — Për të gjitha këto, ai, sado që ecte me shpejtësi dhe i kapardisur, ndjente një shqetësim të madh.

Një copë herë në Rreth erdhi rrotull, pa ditur se ç'të bënte. N'ato pijetore të vogla, sa hynte, kthente nga një raki dhe delte prapë. Nga këmisha e çkopsitur, i dukej një fanellë e trashë. Gjer afër drekës u bë thumb; inati i qe shtuar dhe kur shkoi te prokurori, sa hyri në dhomë e mbushi me një erë të keqe rakie.

Prokurori, një bardhush pak tullac, e shikoi me vërejtje. Nuk i tha fare të ulej.

Megjithëse Malo Bonjaku ishte bërë tapë, çështjen ja tregoi shtruar.

— Është më mirë të jesh esëll për këto punë — i tha prokurori, i cili, me ato duar të vogla si të vajzave, po lidhte një dosje. — Në zyrë,

pastaj, hyjnë me leje, trokitin në derë dhe heqin festen.

— Më fal, se s'jam në rregull — dhe veshi pallton e hoqi festen. — Kjo punë më trubulloi shumë.

— Të ka trubulluar rakia, thuaj më mirë. E ndjeu vehten pak të turpëruar dhe i kërkoi leje të ulej.

— Mua s'më duan fshati.

— Ndoshta s'je i mirë!

— Mundet, se ka thënë i pari: po të thuash të vërtetën, të presin gjuhën. — Nga të pirët shfrynte. — Unë flas për ca padrejtësira që bëhen në fshat, ata më shajnë. Ç'më shajnë? më demaskojnë fare. Unë kam qenë i pari për kooperativën.

— Po ti s'po hyn as i fundit! — ja preu fjalën prokurori.

— Ashtu është puna. Kooperativa do kokë në krye. Dhe jo bam njerit e bam tjetrit. Me zorr është? Edhe unë kam ca të meta. Për këtë jam gati t'i heq vehtes një autokritikë të fortë.

— Po kur të esëllonesh. Tashti ti shko një herë në fshat, shtroje me ata të këshillit dhe përpiqu ta zgjidhni pa vajtur gjyqeve.

Prokurori e pa nga dritarja Malon, i cili, megjithëse përpiquej të ecte në rregull, duke shprehur tërë mërinë e tij për kundër gjith atyre njerëzve, që, siç thoshte ai, e lëftonin për ambicje, lëkundej si barkë.

\* \* \*

Një këndes i ri qafërpur, s'i linte rehat pulat që kullosnin e po ua merrte çdo gjë që gjenin. Pastaj, me guxim, fluturoi sipër murit

dhe po matej të këndonte, po ende s'e kishte të formuar zërin e tij.

— Ta hajë dreqi edhe këtë punë. Mor zot, njëqind herë kemi thënë t'i bëjmë një derman atij qenit të Malo Bonjakut dhe s'çajne kokën — tha xha Sopi, që, duke hyrë brenda në magazinë, pa trokitur fare, tundi të tëra kashturinat dhe plehrat e stallës së lopëve. — Mor po më shqepi një qerrata... dhe e di se si? Unë ecij rrugës për të ardhur këtu ai, zaten, unë e kam thënë, qen kulaku, ka besë? më jep ca të lehura pas krahëve, sa që ç'të të them si shpëtova e s'më ra pika... po ymëri i gjatë... Po, po gjëne mirë na e bën, se kur mora edhe unë një qen, ju ma helmuat.

— Të kafshoi gjë?

— Jo, për të kafshuar s'më kafshoi, po ama ma sosi gjysmën e gjakut. Dhe si do të bëj që ta vë në vend, as unë s'e di. Veç në më dhënçi nja pesëmbëdhjetë ditë pushim e të më dërgoni në ndonjë kamb, se vetë s'i bëj dot ballë. Thuaji edhe Bejkushit një çikë nga ana jote... — Ju ra edhe një herë me duar potureve. Pluhuri mbushi odën. Përplasi edhe opingat, duke i lëshuar në dysheme edhe ato copëra bajga, që i kishin mbetur akoma. — Tani s'ta them prapë këtë çështjen e lejes. Po erdha të flas prapë për atë punën time.

— Mor derëzi — i tha Veshua — po të thamë një herë. Unë e mbajta edhe shënim.

— E di, more vëllako, po s'e shoh ta kesh përpara atë defterin tjetër, ku më shënove emrin dhe ankesën time.

— E po ai u sos.

— Ai u sos, po emri im?...

— Po ja, ta shënoj edhe një herë këtu dhe ik tani, se na fryve zorrët, e na bëre helaq. Duhet të kesh besim në organet udhëheqëse të kooperativës.

— Ashtu është. Po a e di si thonë të Kërshterët, as shën Thomai s'e besoi të birin e Perëndisë, Isanë, që u ngjall, pa i vënë gishtin atje te vendi i gozhdës.

— E pse? ç'na bëre ti neve? gënjeshtarë? fetarë?

— Bababa! Unë të kam mbi krye e sipër... dhe s'ta tha njeri këtë fjalë. Po që njeriu harron... mëndje është — edhe ndonjë herë harron.

Veshua i nxehur, që gjer n'atë çast s'qenqitur fare në këmbë, u ngrit.

— Ky është ofendim i organeve udhëheqëse të kooperativës. Po duke menduar se mos nxirrte gjë se kush e kishte kurdisur xha Sopin për këtë «intrigë» kundër tij, e uli zërin.

— Zotrote je plak, xha Sopi, dhe këto fjalë që thua, sigurisht, duke besuar që ti nuk je koshient, se luftën e klasës...

— Sa për këtë të klasës, mua s'ke ç'më thua... Po të ma kishin lënë qenin e të mos ma helmonin, e dija unë ç'i punoja atij të Malo Bonjakut.

— E, e. Po nuk e bën tamam ashtu siç duhet. Ja, do të të provoj tani.

— Urdhëro e fol.

— Kush të ka mësuar të flasësh ashtu, si fole qëpari?

— Halli, mor vëlla. Mbasi mua s'm'i kini

numëruar mirë, ashtu si duhet, ditët e punës, erdha dhe t'u qava.

— Ti s'je koshient... unë e di.

— Me që e di, atë fjalë merre prapa dhe mos më ngarko me gjëra të pa qëna se duam të rrojmë.

— Hej, pikë e zezë. Ç'të them unë, ç'më thua ti. Unë të them që ti s'je koshient... e di ç'do me thënë.

— E di, e di, s'jam dhe kaq budalla, prandaj ta marrësh prapa atë fjalë, unë jam, jo s'jam.

— Ik, more djall, se u matufepse fare...

— Ashtu është, si thua zotrote, që m'i hëngre...

— Ç'të hëngra?

— Ditët e punës, që s'm'i ke mbledhur tamam. Me statut punon ti, mor zot?

— Po me se punojmë? me gorica?

Bejkushi, sa erdhi nga seminari, duke parë derën e magazinës çelë, hyri brenda dhe duke nxjerrë nga xhepi tri fletore dhe i vendosi një mbi një mbi tryezë.

— I sheh këto? — iu drejtua Veshos. I mbusha plot me shënime. E di? Më përpara, sikur i kisha shumë zët këto mbledhjet, po tani i mësova.

— U mësove, po edhe këtu të kërkon puna.

— E po dhe në mbledhje punë bëjmë, sos rrimë duar lidhur... Tani t'i lemë fjalët, unë them t'i lajmërojmë shokët që të bëjmë një mbledhje, t'u them për ato që dëgjova në seminar. Atje na thanë që këto t'i shtrojmë me një herë.

— Po seminari për çfarë gjërash u bë?



— Për ca gjëra, që u takojnë kryesive të kooperativës.

— Unë them më mirë shtroi në kryesi. C'taksirat të vijnë të gjithë në mbledhje? T'i heqim nga puna.

— Mirë thua, po t'ulem një çikë. Ke gjë ujë?  
— Piu një gotë dhe i u drejtua Sopit. — Ç'kemi, o Sop?

Veshua filloi të flasë se si qëndronte puna.  
— Dale t'ua them unë, se ti kërkon ta mbulosh dobiçin — u hodh xha Sopi dhe u ngrit e erdhi e u fut në mes të tyre — s'i ha unë ato. Ti më bëre edhe raksionar. Thuaje nuk më the ashtu? Thuaja ta marrë vesh edhe ky, që e kemi babanë e vëndit; e merr prapa fjalën?

— Jo, more shoku Bejkush, unë i thashë që ti nuk je koshient.

— Pse nuk jam? Këtë ma çkoqit ashtu si lypset, brram si burrat.

— Po ti a merr vesh se ç'do të thotë ky me këto fjalë? — ia preu Bejkushi.

— Dhe aq budalla s'jam që të mos marr vesh kaq fjalë. Po dollapet e këtij ju nuk i kup-toni. Ç'i duam llafet. Thoni të m'i mbledhë mirë ditët e punës.

— Po mblidhja dhe ti të shkretën. Kushedi? mund të jetë, edhe gabim, — i foli Veshos Bejkushi.

— Hesap është — Hë tashti dhe ti Vesho, se më kërkon puna mua atje poshtë, s'e kam punën si ti, me një copë kalem e një copë kartë. Puna ime do fuqi, po do edhe mëndje. Mos më bjer' e më shpjerë se më dëmtohet puna e jam me përgjegjësira.

Organizata bazë e Partisë në Këmbëz, në rendin e ditës kishte edhe shqyrtimin e dokumentave të Bilush Rrumbullakut për kandidat Partie.

Cane Vojka u tha shokëve se të gjitha dokumentat i kishte në rregull.

Bilush Rrumbullaku, kur hyri në mbledhje, ndjeu një emocion të madh dhe gjunjët i dridheshin.

— Ulu! — i tha Cane Vojka.

Ai u ul në cep të një froni dhe po dëgjonte edhe një herë biografinë e tij, që i ngjante jetës së qindra fshatarëve të tjerë.

— Të gjitha i ke thënë — tha Bejkushi.

Vetëm Razimi i shtrembëroi buzët, kur fliste për të motrën.

— Tani shokë, them ta pranojmë — u tha Bejkushi, — Bilush Rrumbullaku, si fshatar i varfër, është i vendosur për çështjen e Partisë, se ky hyri në jetën e njerëzve, si shumë e shumë nga ne, në pushtetin popullor. Është punëtor, njeri i ndershëm dhe i disiplinuar, vigjilent. Ç'kini për të thënë?

Pas Bejkushit foli Dino Bonjaku e Veshua.

— Ka njeri tjetër që do të flasë?... S'ka... Ahere ne Bilush Rrumbullakun e pranojmë kandidat Partie, — tha Cania dhe u ngrit e e përqafoi Bilushin e e puthi në të dyja faqet, që atë çast atij i digjnin si prush.

Bilushi, si ndenji pak në këmbë pa folur, duke i shikuar shokët e organizatës me një da-

shuri të veçantë — me leje — u tha — desha t'u them ca fjalë: Unë, more shokë, sonte kam një gëzim, aq të madh, sa s'kam patur ndonjëherë në jetën time. Kaq u bëra, dhe nuk di... nuk mbaj mënd një ditë si kjo... Unë tani jam dyzet e pesë vjeç. Flokët kanë zënë të më zbardhen. Shtëpinë time e kishte mbuluar skamja. Kur linda unë, mëmën time, përveç mamisë, nuk e uroi njeri tjetër... Njerëzit e saj s'i prunë të ngrëna, as mua. Dhe gjyshja nuk dërgoi njeri për sihariqe; sipas zakonisht nuk më bënë bukëvale, as grurë nuk zien, kur nxorra dhembët. Flokët s'm'i mori njeri. Kur u rrita, m'i rrëfente vetë e shkreta gjyshe, ndjestë pastë dhe më coptonte zemrën, kur zinte e qante. Po sot? Nuk është e tepërt po të them se, në lindi një Bilush Rrumbullaku në Këmbëzë, lindi sot, që më pranuat në Parti. Kur lind një njeri, siç është zakon, dërgojmë për mushtulluk... Iu afrua derës, e çeli... — I biri e priste jashtë.

— Shko, thuaj mëmës se më pranuan në Parti. — I biri rendi si zog.

— Ky është sihariqi i parë në shtëpinë time. Unë tani jam me njerëz, me miq e me shokë... I falemnderit Partisë, po do të punoj dhe po të jetë nevoja, do të vdes për të.

Ngashërimi i madh që ndjente, ja kishte mbushur sytë me lotë. — Dëgjoni, shokë? Në shtëpinë time kanë zënë këngën...

Shokët e organizatës i vunë veshin këngës, edhe ata, me vështrimin dhe vëmëndjen e tyre, po merrnin pjesë në këtë gëzim. Përpara tyre rrinte një fshatar i varfër, mesoburrë, me një trup të lidhur mirë, me dy duar gjithë kallo, me

shojet e këmbëve të plasaritura nga mundimet, rrinte Bilush Krumbullaku, që u pranua kandidat Partie, i pari i pranuar në organizatën bazë të Partisë së fshatit Këmbëzë. Ai ishte pasqyra e gjallë e njeriut të shtypur, është pasqyra e gjallë e njeriut të gëzuar, të cilin e rilindi Partia, për t'i shërbyer socializmit... dhe komunizmit.

Bilush Krumbullaku banonte në dy të ndara të një shtëpie përdhese me plitharë. Pas vdekjes të së motrës, tani familja e tij përbëhej prej pesë vetesh: ai, e shoqja, djali i madh gjashtëmbëdhjetë vjeç, e bija katërmbëdhjetë dhe djali i vogël nëndë vjeç.

Përpara luftës dhe vitet e para të luftës, e fitonte bukën e gojës, duke punuar me të shoqen dhe të motrën bashkë, si ergat në Këmbëzë e në fshatrat për rreth. Mirëpo qysh atëhere, që e motra u mbyt në lumë nga turpi — dhe kjo ngjau në verën e vitit 1940 — se djali i Xhezair Kokëziut e pat zënë me zorr për ta turpëruar, nga fjalët e botës nuk e ngriti kokën e nuk i qeshi fare buza. Deri në dy vitet e para pas çlirimit, merrej me shtatë krerë dhën dhe një copë bostan të vogël për nën shtëpi. Pas reformës agrare, kur edhe atij i dhanë ara, sikur e harroi atë turp të hidhur, që ia helmonte shpirtin dhe iu përvesh punës me të gjithë njerëzit e shtëpisë.

— Edhe unë dija t'ia mbushij zorrët, veçse këto gojë që po shikoni — dhe u tregoi fëmijët — donin të ushqeheshin. Po unë ua fal, more vëllezër, se të gjithë e dinë që Xhezair Kokëziu që bërë si mbret në fshat, e atëhere ne s'kishim fuqi ta kundërshtonim.

Fshatarët kishin ulur kokën të turpëruar. Sikush kishte lëshuar nga një fjalë për të motrën e tij, të cilën sikur e kishin në sy, e kujtuan prap ashtu të bukur, që djemve të fshatit u mbetej syri mbi të. Disa gra qan dhe Xhikua e Nuredin Bardhit psherëtitu aqë thellë, sa të gjithë kthyen kryet dhe e vështruan.

Pasi mbaroi mbledhja e organizatës bazë, Bilush Rrumbullaku i ftoi shokët ta uronin në shtëpi.

— Hajdeni, shokë, se sot e prisha zinë për time motër.

ETVO R 1 1911

## KREU I PARË

### 1

Bënte një ngricë e madhe që të helmonte. Era frynte me tërbim. Strehët e shtëpive ishin mbushur me kallamë akulli. Përroi nën Beden kishte ngrirë dhe nga rrezet e diellit ndrinte si xham. Oxhaqet e Këmbëzës lëshonin tymin për-pjetë shtëllunga-shtëllunga.

Kjo ngricë mbajti tri ditë rrjesht. Pastaj moti u ndryshua dhe u zbut shumë. Era pushoi dhe, në të gdhirë të ditës së katërtë, pas shiut që ra natën, doli një kohë e bukur.

Ca nga ngrica, ca nga shiu, në shtallë s'kish-te ku të hidhje këmbën.

Hëna, atë ditë, që u hap koha, mblodhi fëmijët e shkollës dhe, si e pat bërë fjalë me xha Sopin, i solli të bënin një vizitë në stallën e kooperativës.

Xha Sopi i priti te dera jashtë.

— Hajde moj Hënë vajza, hajde, se më qënke bërë si ato kokonat e kasabasë... me ngadalë, se lerose... po mos na e vur re neve, se helbete, kooperativë e re jemi, s'jemi si kooperativa e «Çlirimit» dhe se hajvanët se mos kanë mëndje, ku të mundin i lëshojnë bajgat.

Në këtë kohë, mësuesja, e futi këmbën e djathtë në një pellg.

— Ore, të shkretën... Nuk i heq më mirë këpucët dhe çorapet. Se më vjen keq të humbasin këpucët atë «gër-gëre» dhe çorapet ashtu bojë mishi, do të bëhen si surrati i Sopies me pllanga-pllanga... Mos kij turp. Plak njeri jam unë, mos të të vijë turp... pa për këtu opingat janë.

— Ou! Kuqua im...

— Sht! Lanet... S'ka këtu Kuqua im, Kaziu yt. . . Kooperativa jonë ka gjashtë qe dhe dy lopë. Siç e di, unë jam përgjegjësi i tyre. Bejkushi më tha t'u shkruaja edhe emrat këtu mbi grazhd. Po ç'i do... unë ua di të gjithëve... doni t'ua them?... Ja, kjo këtu është lopa më e mirë e kooperativës, Dredhja; ja kemi vënë këtë emër nga brirët e dredhur, i sheh si i ka? Ka ngrënë një damaz të mirë që ta mbajë mënd. Mësuesja u skuq gjer në veshë.

— Është e ngarkuar, si t'i themi, domethënë... e presim të na pjellë. Ai doktori i kafshëve që vien, e ka parë. Na tha se si kjo lopë s'ka gjëkundi... po të na bëjë mashkull, do ta mbaimë për ndërzim... se ç'i shpie lopët gjer në stacion poshtë... Këtu në fshat... dhe me radhë... me plan, moj Hënë... Kjo këtu është «Lara». E, si ju duket shtalla jonë? Jemi ca prapa, po viti që vjen ta shikosh.

— Shumë pis — iu përgjegj mësuesja.

— E po u bëre kasaballeshtë ti, e harrove fshatin. Gjedhet kështu e kanë. Ja, rri të shkoj e t'ja fshij vëndin Kaziut.

— Jo, jo, s'është nevoja...

— Është, është, se ti pastaj, unë e di, se po



hyre në gojë të grave, xha Sopi kështu, xha Sopi ashtu dhe më demaskon e më pret nafakanë.

— Si ju duket shtalla, fëmijë të dashur? —  
i pyeti mësuesja nxënësit.

— Shuumë pis... — iu përgjegjën ata.

— Si e mbanit ju Kuqon, Dritë?

— Shumë mirë, zonjushë, babai e kashaiste çdo mëngjes, unë ja pastroja vëndin ditë për ditë.

— Po unë ç'bëj këtu? ha bar? Ja, tani erdhët ju dhe më latë pa punë... Moj, zonjë e mirë, ti erdhe për vizitë këtu, apo për kontroll?

— Njësoj është.

— Jo, s'është njësoj. Njerëzit kur vijnë për kontroll, lajmërojnë më parë. Ja, ai «zotekniku» i kafshëve, kur niset për të ardhur, unë e marr vesh më përpara, ndaj i kam veshët; pse, kështu na lënë shokët neve, në baltë?... Pastaj, moj vajzë e mirë, sikur shpejt i harrove hajvanëritë... me oturak nga pas do t'u rri unë qeve dhe lopëve. Bëhen dot zap haivanët? Ti i ke njerëz këta dhe s'lënë rrugicë pa fëlliqur.

— Ç'do të bëimë ne, pionierë të dashur? Kështu do ta lemë shtallën?

— Të rrimë e ta pastrojmë, bashkë me xha Sopin, zonjushë.

Xha Sopi hapi sytë. Frika se mos Hëna, që iu duk shumë e egër, i bënte ndonjë «llaport», i iku ashtu, papandehur dhe mendoi se ishte më mirë të mos e zgjaste me të.

Hëna, xha Sopi dhe pionierët iu përveshën dhe filluan nga krei e gjer në fund të shtallës me fshesa, me xanë e i hoqën të gjitha plehërat. Pastaj me copëra thesesh, i pastruan mirë e mirë qetë dhe lopët. Xha Sopi as njëherë s'e kishte parë shtallën aq të pastër. Një gëzim i papër-

shkruar ja pushtoi zemrën, kur shikonte se ajo, Hëna e veshur me këpucë të mira e me çorape bojë mishi, u zbath e iu përvesh si qëmoti e se si këta pionierë qenë bërë aq punëtorë e të bindur, që më përpara shëndet t'u thoshje, plaç u dukej e të shanin me ç'u vinte nga goja.

Kur erdhi Bejkushi, puna ishte mbaruar. Zonjusha dhe pionierët ishin larë, kishin ulur këmbëzat e pantallonave dhe po vazhdonin të shikonin qetë dhe lopët.

— Oj, e paske bërë shtallën bukuri, xha Sopi!

— E po këtë detyrë kam — e duke u krekosur shikoi në sy mësuesen, e cila bëri buzën në gaz. — Them, more Bejkush djali, se edhe kjo shtalla duhet lyer edhe një herë me gëlqere. Edhe Hëna t'u flasë për të na ndihmuar gratë ta lyejmë, gjysëm ditë pune. Ama i kënaqa fëmijët. E panë edhe këta si punoj unë. Po edhe më ndihmuan. Domosdo bashkë i kemi të gjitha tani.

Bejkushi, me një fshesë, tërhoqi mënjanë një bajgë...

— E, po laneti... kështu janë hajvanatë... unë i thashë edhe mësueses, se e gjeti një çikë të lerosur shtallën e m'u hodh në grykë. Ja me fshesë në dorë u rri, e me benevrekë përveshur.

## 2.

Bilush Rrumbullaku, gjatë dimrit, kishte ngrënë nga bereqeti për farë dhe tani, që po afroinin të mbjellat, po shqetësohej. Kryesia e kooperativës i kishte dhënë urdhër magazinierit, Veshos, që ta mblidhte farën.

— Ti, Bilush, nuk e ke sjellë akoma.

Bilushi iu përgjegj me gjysëm zëri, i turpëruar:

— S'kam ç'të sjell unë, po thua j se e kam ngrënë.

— Si e paske ngrënë? As sa teto Qerimeja s'u bëre?

— E di. — Për herë të parë Bilush Rrumbullaku mbushi sytë me lot dhe me kokë të ulur, duke i zvarrisur me vështirësi këmbët erdhi në shtëpi.

— E shoqja atë kohë po shpëlante, jashtë derës, enët.

— Pse mezi vjen? — e pyeti ajo dhe u ngrit, duke fshirë duart me një përparëse të vjetër, nderur mbi një tel të hollë, përpara dritares.

Bilushi nuk hyri brënda, po, si i lodhur, u lëshua më njësh dhe u ul në prak të derës. Për atë që kishte menduar ishte i sigurt se ajo do t'ja prishte. Le të gjitha, po ç'i dëgjonte fjalët dhe të lebetiturat e saj.

— Moj grua, si do të bëjmë për të plotësuar farën? Të mbjellat afruan dhe tani na duhet farë.

— E ku të gjej unë? — ja preu ajo.

— Po unë ku të gjej? Tani nuk të jep dhe njeri borxh.

Vajza e Bilushit, që kishte qenë poshtë për të rregulluar një kanal të vogël kullues, sapo u kthye. Ishte bërë tërë baltë. Ajo e vuri re t'anë që po rrinte i mërzhitur dhe, për të mos e bezdisur, nuk e pyeti fare, po e përshëndeti dhe shkoi për të larë duar e faqe te një muslluk llamarinë, varur në mur. Nga e ëma mori vesh punën e farës, ajo u mërzhit shumë dhe qëndroi si e mjerë, në krye të odës, te praku i dritareve, me atë kuti vasiliko, që lëshonte aq erë të këndëshme.

— E, moj grua? Kam menduar të shesim dhëntë — i tha Bilushi prerë dhe u ngrit në këmbë.

— Dhëntë? Po pse s'thua varna një gur në qafë e na hidh në lumë. Si ta thotë goja? Ne tri dhën e dy shqerra kemi. Këto t'u rëndën.

— Të shesim dhëntë... S'ka tjetër...

— More dhëntë mos i ze në gojë, more vesh?

— Dhe të turpërohem?

— Po ç't'i bësh?

— Mëmë, le t'i shesë babai. Në të korrat, ne do të marrim plot bereqet, jemi katër krahë pune.

— More, s't'i lë unë që çika-çika të ma bësh mishtë — dhe zuri shtegun, duke hapur të dy krahët sikur donte të pushtonte çdo gjë. Ajo dri-dhej e tëra. Baltë në fytyrë, pa e shikuar fare në sy të shoqin, i lutej:

— Thuaji kryetarit. Thuaji të të japë ai bereqet. Jo, po s'të dha, kërko dhe ti të dalësh nga kooperativa, si ka kërkuar edhe Dalipi.

— Hiqiu kënde, për perendi, se unë nuk jam Dalipi.

— Jo, mor jo. Unë s't'i lë që të madhen të më bësh.

— Babi, po neve nuk do të na lësh ndonjë? — iu drejtua djali i vogël.

Me mërzitje këputi një qëngj laragan. Delja gjithë rrugës blegërinte që të këpuste shpirtin.

Kame Gjovarfa, sa dëgjoi gjithë këtë shamatë dhe e pa që ai u nis me dhën, i doli përpara:

— Ku vete?

— Në pazar!

— Për t'i shitur?

— Kam nevojë.

— Kthei dhëntë!

— Po dua bereqet për farë!

Kame Gjovarfa nuk i foli më. Si u fut brënda në shtëpi, me shkurtën dhe me të shoqen, hodhi në dy thashë një misër të qëruar e të verdhë dyllë.

Përpara magazinës fshatarët po sillnin farën.

— Këtë shënoje për Bilushin — i tha Veshos Kame Gjovarfa, dhe, me të bijën, i ulën të dy thasët përpara derës, ku dy fshatarë, me një kandar të vjetër, po peshonin.

Bilush Rrumbullaku, që kishte ardhur pas tij, e shikoi në sy Kamen, që po fshinte me një shamë të madhe djersën.

— Të falem nderit!

Djalin e vogël të Bilushit, që po mbante t'anë nga cepi i palltos, e gëzoi në gushë, dhe, pastaj, me atë dorë të madhe, ja shkoi nëpër ata flokë të paqethur, që kishin filluar t'i zinin veshët.

Dhëntë po blegërinin dhe gëzoheshin pas shqerrave të tyre, që s'i kishte prerë akoma. Ai qengji laragan, sa dëgjoji zërin e s'ëmës u sul pas saj dhe zu të pijë, duke tundur bishtin e vogël, të butë, si pambuk.

\* \* \*

Hëna, si lidhi flokët, me atë fjongo të kuqe, në gropën e zverkut, u pregatit për të shkuar me leje në shtëpi, në Vilëzë. Ajo ndodhi në Këmbëzë, kur u ngrit kooperativa dhe i kishte parë me sytë e saj përpjekiet, që bënë ata më të vendosurit, giersa e ngritën dhe i kuptonte fare mirë vështirësitë dhe nevojat e para, që kishte Këmbëza.

Prandaj ajo, sa erdhi në fshat, i propozoi kryesisë së kooperativës ta ndihmonin kooperativën e re të Këmbëzës. Ato dy ditë që ndej s'pu-

shoi, duke folur me të gjithë, gjersa ata vendosën t'u japin shokëve të tyre, në Këmbëzë, dhjetë kuintalë misër. E gëzuar pa masë, pa e bërë fare lejen, u kthye për Këmbëzë.

Nga dëshira që t'i sillte kryesisë së kooperativës këtë lajm të gëzuar, kishte ecur pa qëndruar gjëkund rrugës. Me ato faqe të nderura prush, ashtu siç ishte nga rruga, pluhur e gjallë, sa kapërceu pragun e derës të zyrës së kryesisë, pa prituri të përshëndetej me Bejkushin, duke shkundur fustanin vishnjë, i dha lajmin e vendimit të asamblesë së kooperativës «Çlirimi».

— Shoku Bejkush, mbrëmë asambleja e kooperativës «Çlirimi» vendosi t'i falë kooperativës së Këmbëzës dhjetë kuintalë misër. Kafshët që po vijnë me bereqet, i lashë prapa.

Ajo u ul e gëzuar. Bejkushit i humbën fjalët nga goja dhe s'u bë fare i zoti për ta falenderuar,

### 3

Larushja, sa e pa t'anë, iu hodh në qafë e e puthi në të dyja faqet. Lotët e saj që i vinin çurg ja njomën fytyrën e rruar t'et dhe ai ndjeu, pas disa vjetesh, një gëzim prej prindi.

— E tani, e! pa këtu do ta kemi tani babanë — i tha e ëma, po hajde të rregullojmë odën, se do të na vijnë miq.

Lajmi që erdhi Xhezair Kokëziu, nuk i çuditi shumë fshatarët, se për të rrojtur, e dinin që rron-te, po kështu, si kishte ardhur pa pandehur, u qe dukur punë e çuditëshme. Disa flisnin, se këtë punë do ta ketë rregulluar Razimi, se Larushen, sado që e kishte bërë bijë në shpirt Malo

Bonjaku, prapë se prapë vajzën e tij e kishte, mishi nga thoi nuk ndahet.

Razimin, edhe pse nuk e zgjodhën kryetar të këshillit, në kryesi të kooperativës e kishin lënë; veç kësaj, duke qenë në Parti, ai e kishte akoma fuqinë në fshat.

Më i fundit, që e mori vesh, se Xhezair Kokeziu qe kthyer në fshat, qe xha Sopi.

— Duket se do ta ketë ndrequr punën; se edhe ashtu kuturum, si dashi te kasapi, nuk do të vinte. S'është edhe ndonië budalla Xhezairi... Po, o burra, grua të shkojmë ta urojmë, ta mirseardhim.

— Qvsh ore, mos të lanë mëndtë?... Mos ja hoqën kulakllëkun?

— Pse, tyj do të të pvesin?... Mund t'ia kenë hequr, atje ku ka qenë me punë. Një kulak ishte, se mos, fundi, do të mblidhej Unoja. Pastaj, moj grua, edhe këto punët e lufrave nuk i marrim vesh dot ne... Edhe unë për këtë arsye s'jam marrë ndoniëherë me polatikë, na ta dish, unë nuk kam qenë ndonië i humbur. Diia ta losja polatikën në maië të gishtërinive unë. Pse? e na ketë qe aio që më ngjau ahëre, kur erdhën ballistët e më muarrën t'u rrëfeia rrugën e Vilëzës?

— Ec, më tha një miekërosh...

— Posi, more, i thashë...

— Ashtu de, bravo!...

— Pa më thuaj, kush e bënte tjetër atë që bëra unë, që, sa zbrita në fushë, bëra sikur më ra të fikët e u lukurisa në përrua, sa që u deshën pesë burra të më nxirrnin, dhe i lashë në lucë? Një nga ballistët tha: Ama gjetëm kallauz... hëngra një shqelm, që edhe tani kur e kujtoj, them se si shpëtova i gjallë... po komisari i partiza-

nëve, kur ja tregova, më tha bravo... Rri, moj grua, kur është puna për të demaskuar maskën e Xezairit, me fshat bashkë, di unë ta loz politikën... po hë, e mos na vono, .. se edhe ai do të thotë: më i fundit xha Sopi erdhi...

Këtë qejf të madh që kishte ia prishi Bejkushi, i cili erdhi ta marrë të shkonin një herë në shtallën e gjedheve...

Xha Sopi, duke u munduar ta fshehë mërzi-tjen që ndjeu, hapi gojën për të qeshur e për t'i thënë siurdhëron, po në vënd që të qeshte e të fliste, gogësi dhe mërmëlisi nëpër dhëmbë.

— Ç'ke pësuar, xha Sopi?

— Ku di unë? Hiç gjë... Pse? si të dukem?

— Sikur ta ka ngrënë gomari bukën... .

— Me gratë! Ke parë e ke dëgjuar ndonjë herë që gratë me burrat të mos prishin fjalë? Më hëngri veshët: erdhi Xhezairi, erdhi Xhezairi... e po mirë në erdhi, moj grua... fshati s'është pa të mëdhenj, si të bëjnë ata, do të bëjmë edhe ne... dhe me që dëgjova që — dhe iu qas afër në vesh — kishte shkuar për ta mirëseardhur edhe Razimi, thashë të veja edhe unë... More Bejkush, po ç'do jetë kjo punë?... Atij kaq kohë s'i dukej as nami as nishani në fshat... se sikur thanë që tani pas këtyre viteve që ka vdekur Stalini, ca punëra do t'i shikojnë, se mos janë bërë gabime. Po thonë sikur do t'i a heqin kulakllëkun, se qënka bërë gabim.

— Gabim?

— Gabim... Mos e di unë? po si thonë...

— Po ç'thonë?

— Thonë... — dhe xha Sopi me që e humbi, se s'dinte ç'të thoshte, kroi kokën e duke zvogëluar sytë, bëri sikur po mundohej të kujtonte gjëkaf-



shë. . — Ah, ç'u plakëm, o Bejkush. . . E di sa harraq jam bërë? . . . Tani të më thuash një gjë, me një herë e harroj. . . Dje. . . po, dje, shapkën në kokë. rraha shtëpinë e kërkoja shapkën . . . Mirë që u ndodha në shtëpi, se, të më ngjante një gjë e tillë në mbledhje të fshatit, do të bëhesha gazi i botës. . . Më ka lënë këtë të metë ai aerata shqelm, që hangra atëhere, që i gënjeva ballistët e u rrëzova në hendek. . . S'i rashë prapa me doktorë dhe e pësova.

— Edhe kjo që na the, Sop, qenka e rreme, si ajo punë e gabimit që qënka bërë për Xhezairin.

— Ç'gabime janë bërë? Kush e tha këtë?

— Po ti e the, që thonë e të qenkan shouar veshët së dëgjuari. . . Dëgjo këtu: kush të të thotë, i thuaj se asnjë gabim s'është bërë. . . Ata, që flasin posht e përpjetë kështu, janë armiq të kooperativës. . .

— Domosdo, bile shkuar armiqtë. . .

— Edhe ti llap nga pak. . .

— Unë? — Xha Sopi shqeu sytë dhe hapi duart për të treguar çudinë e tij të madhe. — Unë jam me vullnet në kooperativë. . . dhe ç'pandeh ti? se i ha ashtu llokume fjalët e kulakërisë? Çuditëm kush i hap këto parulla. . .

— Kush i hap?

— E. . .

— Ti. . .

— Unë? . . . Dale, more Bejkush, djali, se ne ty të kemi babanë tonë. Cili të ka mbushur që m'u derdhe kështu, mua të mjerit, sonte? Nga këto fjalë, xha Sopi i ngashëryer, e dridhte zërin sikur po qante. . . — Kë kam unë i varfëri? Tyj dhe perëndinë.

— Partinë! Jo mua dhe perëndinë. Dhe po nuk dëgjuam Partinë, na merr lumi të gjithëve.

Pastaj Bejkushi ja nguli sytë xha Sopit, e vështroi e e vështroi një copëherë të gjatë, sikur ta hante të gjallë. Sopi, priste tani ndonjë surup tjetër, më të ashpër dhe gjunjët i dridheshin si rodhan dhe mezi mbahej në këmbë. Po kur Bejkushi i vuri dorën mbi sup dhe bëri buzën në gaz, për të shprehur se të gjitha këto që fliteshin andej-këndej ishin dëngla, që Partia as që donte t'ja dinte, edhe Sopi qeshi e në fytyrë i shkoi një afsh i ngrohtë.

— Mirë ahere — vazhdoi Bejkushi — gjedhet ai rregullove?...

— I rregullova?... Po ato janë djemt e vajzat e mia... more Bejkush. Do të vemi t'i shikojmë?

— Jo, jo... Nesër në mëngjes... se ti ke punë... Nuk do të vesh për vizitë te?...

— Ababa!... Tutje të mallkuarin! Mirë kanë thënë: një dru i shtrembër prish gjithë radhën...

Bejkushi, duke i thënë xha Sopit natën e mirë, u largua dhe nxitoi hapin. Vajtja e Razimit te Xhezair Kokëziu nuk i pëlqeu dhe shkoi ta bisedojë me Cane Voikën.

— Ç'ta bëri mirë — i tha e shoqja Sopit, kur hyri brenda surrat...

Si pulë e lagët ai zuri vend mbi minder. Duart i dridheshin dhe mezi po e ndezte eshkën. Forca për të bërbelisur, si zakonisht, me të shoqen, i kishte humbur fare dhe rrinte sus përpara saj, si foshnje.

Duro Çalamanit i ngriu gjaku, kur mori vesh se Xhezair Kokëziu, qënkësh kthyer përsëri në fshat.

Zelka, e shoqja, i tregoi se kishte marrë vesh, nga e shoqja e Xhezairit, se ai, andej nga kishte qenë, kishte prurë plot lajme të mira.

— Ç'më thua, lajme të mira, lajme të mira? Nuk thua ç'e solli kokën!

— Dale të të them një herë çfarë dëgjova. Aty, thonë se Malua, nga ana e Razimit, i kishte shkruar të vinte, se do të përpiqet ti heqë kulakllëkun, se është bërë gabim.

Duro Çalamani nisi t'i dëgjojë këto fjalë me vëmëndje, dhe megjithëse s'donte t'ja prishte fjalën, se ajo, po t'ja prisje fjalën kishte zakon të keq, se e fillonte prapë nga e para, i tha:

— Po tjetër?

— Tjetër, s'di gjë.

Si më tha edhe e shoqja, edhe Razimi vajti në shtëpi e i kishte thënë plot fjalë të mira.

— Po që kur erdhi?

— Kishte ardhur prëmë natën. I thashë së shoqes, e i dhashë një surup, që s'na dërgoi hiç fjalë. Po më tha se ai i paskesh thënë: të dal një herë në fshat për inat të atyre, që më kanë sharë, pa Duron vëlla e kisha dhe vëlla e kam.

— Duro Çalamani si u siguria se në rrugicë s'dëgjoheshin këmbë, pa rënë fare te porta e Kokëzinie, vajti mu në odë të zjarrit:

Xhezair Kokëziu i dha dorën, si i ftohët.

— E. mo Duro, burbakull qënke.

— S'kam gojë të flas për Duron, more burrë — iu hodh e shoqja, Xhiko Zelka e Durua plot ma binte pëqinë, mbi mur e nënë mur.

— Po hele-hele ç'na thua?

— Ja, si në Këmbëzë!

— Më e mira do të bëhet. Bejkushi është za-bit e i do njerëzit t'i ketë si ushtarë. Po ka kokë mbi kokë, e që nuk do t'i lenë punët të shkojnë si kanë shkuar.

— Tani do të na rrish në fshat?

— Të shohim. Më shumë erdha të shes shtëpinë e të shkoj andej nga Fieri. Këtu, në më thirrçin, mirë, në mos më thirrçin, mirë.

— Si të mos të të thërrasin. Ti dhëndërin e ke brënda në punët e shtetit.

Po Duro Çalamanit i vinte më mirë sikur të ikte. Atë e hante frika. Xhezair Kokëziu do ta ngatërronte gjëkund.

— Mirë do të bësh sikur të mblidhesh andej nga Fieri.

— E po edhe fshati shpëton nga unë. Bejkushin e kini, talim do të mësoni. Po Nuredin Bardhi ç'bëhet?

Kjo pyetje Duro Çalamanit i ra si plumb dhe u bë lejmon në fytyrë. Na tani, pas kaq kohësh që e kishte larguar atë ngjarje, ky shpirtkatran ja kujtoi përsëri. Iu përgjegj me gjysëm zëri — ç'të bëjë... e kanë zgjedhur kryetar të këshillit.

— Esmakua është rritur, ë?

— Është bërë një berdu Esmakua — u hodh e shoqja, që s'të ka shoqen. Thonë që ja kanë shpurë me krushqi Bejkushit.

Ia kanë shpurë — tha me qesëndi ajo. Kjo gjë është punë e mbaruar.

— Po nga vëllai ke marrë ndonjë haber?

Kjo pyetje Duron e cimbisi thellë.

— Jo, — iu përgjegj me gjysëm zë.

Atë natë Duro Çalamani s'mbylli sy fare.

## KREU I DYTË

### 1

Këmbëza është mbuluar me diell. Bejkushi nga dritarja e vogël, pa hekura, me një kanatë të varur e të bërë tërë gëlqere, po shikonte i menduar. Ai kishte vënë këmbën e djathtë mbi një fron. Çismet s'i kishte më të lustruara si përpara dhe në pantallona kishte plot leçe.

Bejkushi nuk u dëshpërua edhe aq shumë që kooperativa e Këmbëzës u ngrit, së pari, me pak familje, se disa qenë dhe të zot e punës. Teto Qerimeja punonte sa për dy. Esmakua e Shkurta e Kame Gjovarfës u bënë shpejt të dalluara. Dinos i binte bretku te dhentë, Bilush Rrumbullaku ishte sa për katër. Edhe xha Sopi, në atë punë që e kishin caktuar, çoç bënte, Bejkushi të shumën e kohës punonte dhe e kishte marrë aq me qejf, sa kur dëgjonte se e thërrisnin në mbledhje s'i vinte mirë të këputej nga puna. Më shumë naze në punë bënte Razimi dhe që të çante kokën me llafe, ishte tetua e tij, Hania, ajo që qe futur menjëherë sapo i kishin hequr cilësimin e kulakut. Kjo grua, një trup dëndur dhe biçimsëze, rronte në një shtëpi me Razimin, mbasi i kishte vdekur burri, nga një plagë e vjetër, marrë në kohën e luftës, si ballist.

Më pak ditë pune i binin Nuredin Bardhit, se ja hanin kohën mbledhjet e seminarit.

Organizimit të punës, Bejkushi ja mori shpejt anën. Çdo mëngjes i kontrollonte forcat dhe, po t'i mungonte një, as pyeste se ç'kishte, po me të shpejtë i dërgonte urdhër. Le se ç'bëhej kur dëgjonte për ndonjerin, që kishte ikur në qytet. E bënte qepaze jo vetëm në zyrë, po edhe në shtëpi të shokëve. Xha Sopi kur niste e përrallisesh, sa e shikonte Bejkushin, bëhej flutur. — «Ta mbledh ky» — u thoshte.

— E po ushtarë na ka! — hidhte nga një thumb Razimi.

Kopsiti xhaketen dhe po përgatitej të dilte.

Sa hapi derën te kreu i shkallës, Dalip Zeshkani, me një thes pas krahu, iu lut që t'i jepte ca bërëqet.

— Tani na fute në kooperativë. Na jep edhe të hamë.

— Po kjo? — tha me vete Bejkushi. Si ndënji pak i menduar, e mori nga krahu Dalipin dhe u kthye përsëri në zyrë. E uli afër tryezës. Dalipi me atë qylaf dibrance, në kokë, tërë zhul nga djersa, duke zgjatur trupin mbi tryezë, iu qas mu në hundë Bejkushit:

— Dua bukë, prandaj kam ardhur. Të më bësh derman. Në mos po lëshomë nga kooperativa. Me vullnet që që hymë. S'kam më vullnet që të jem në kooperativë.

— Ku do të shkosh?

— Do të vete të punoj ku të gjëj, në udhëra, me kazma, hap gropa për pemë. Sa të vijë koha e të korr grurin.

— Po grurin e ke kolektivizuar.

— Mirë që e kam...

— Po ai është pasuri e kooperativës.

— Unë pjesën time kërkoj.

— Kur ta korrin, sa ditë pune ke bërë, do të të japim pjesën tënde, e gjer në të korra të gjejmë edhe ndonjë kuintal hua.

— Pse? me hua do të rroj unë? Unë jam një krah pune, nuk i bëj dot ballë kooperativës.

— Ti ke edhe gruan!

— Atë kurriz-dalën? Ç'e zë fill atë!

— Të vaditë duhanet!

— E kam edhe me romatizmë. I ka mbërthyer mesin. S'ulet e s'ngrihet dot. Ti e di, apo kërkon të tallesh me mua? Edhe unë s'i përgjigjem dot punës. Ti më pe vetë, s'hapa dot as njëzet gropa. Ç't'i bëhem barrë shoqërisë?

— Domethënë kërkon të dalësh nga kooperativa?

— Unë s'dua, po më shtërngon halli.

— Mirë, t'ja shtrojmë asamblesë — dhe u ngrit. Duke dalë, Bejkushi i hodhi përsëri krahun dhe e pyeti me përzemërsi.

— Po ku do të punosh, o Dalip? Ke gjetur punë?

— Kam mbetur në llaf me njërin. Po në vjeshtë prapë brënda më ke.

— Po këto ditë si ke bërë për bereqet?

— Ja, nëpër fqinj. Ca te njeri, ca tek tjetri.

— Dhe në të korra do t'ua kthesh?

— Domosdo, borxhin kush ta fal?

— Po na, të të japim ne edhe një kuintal, në të korra ja kthen kooperativës?

— Po litarin e borxhit, që kam ngrënë kaq ditë, kush ma heq?

— Po litarin prapë e ke nga ata që je huar.

— E. po fundja ua jap me punë.

— Ashtu thuaj, more Dalip vëllai — dhe i ra supit. — Më qafsh, o Dalip, kush të ka mësuar kaq mirë?

Dalipi, duke zbardhur dhëmbët, ca dhëmbë të bardhë e të shëndoshë, mbeti si i ngrirë.

— S'të ka kurdisur mirë ama, paska qenë sanatçi i keq.

— Më vdekshin fëmijët në kam biseduar me njeri!

— Mor lei ato, se të njoh unë. Ti çirreshe për kooperativë.

— Çirresha, po s'u bë kur thoshij unë. Të qe bërë nja dy-tre vjetë më parë, do të isha ekonomisur. Në qafë na pastë Razimi që e pruri rrotull. Po si do të bësh me mua? Nëm një letër e të dal, se jam njeri familjar, dhe shuajma nga defteri grurin.

— Të shohim. Asambleja ç'të vendosë.

— Po me vullnet qe kjo punë? Ahere kisha vullnet, tani për ca halle s'kam vullnet.

— Me vullnet hyre, po për të dalë s'është me vullnet.

— Ou?

— Posi! E ke punuar statutin?

— S'e mbaj mënd. Unë harroj shpejt!

Të gjithë këtë bisedim e bënë më këmbë, atje, në krye të shkallës. Dalipi, që kishte qëndruar pa lëvizur kthente vetëm kokën nga Bejkushi, që shkante e vinte dhe bisedonte me të pa e shikuar fare në sy, si përpara.

— Do ta kërkoj më lart! — dhe zuri të zbresë shkallët.

Atë kohë, Cane Vojka, duke ardhur, e takoi Dalipin në fund të shkallëve.

— E, mo Dalip?



— Ja, bisedoni dhe më jepni udhë. Ç'më doni mua? Mua më shumë për havale më kini.

— Oj! Ç'paske kështu?

— E di? Ai zabiti, që unë i flisja e i qaja hallin e ai as që ma vinte veshin fare. Unë flisja, po kush më dëgjonte? — dhe u largua me kokë ulur.

Cania, i verdhë në fytyrë, mezi i ngjiti shka-llët. Buza e pjekur tregonte se akoma s'e kishte marrë vehten. Sa u ul në një fron atje afër dritares, ndezi cigaren.

Bejkushi rrinte i mërzitur, po në sytë e tij dukej një gëzim.

— Kështu pra, na polli me Dalipin. — More, e di se si përgjigjej, e se si i gjente shkaqet, tek e tek, sikur i kishte shkruar të gjitha në letër. Po më duket se e gjeta fillin. Më tha se me hua kishte rrojtur këto ditët e fundit. Dhe kur e pyeta se si do t'i shlyesh këto borxhe, e po fundja, më tha, e laj me punë.

— Është e qartë? Malo Bonjaku.

— Po na vënë shkopinj në rrota.

— Të bëjmë një mbledhje të hapët të organizatës bazë dhe t'i goditim këto çfaqje; pastaj, atje, të shohim se ç'mund të na dalin edhe të tjera.

— Ta bënim të mbyllur them. Kështu duke e mbajtur konspirative çështjen ne bëjmë sikur s'dimë nga këto që fliten dhe, në fund, i zëmë të gjallë.

— Pse, ti pandeh se Dalipi s'do t'ia thotë njeriut, që erdhi tek ti e foli kështu e ashtu, që tyj ta mblodhi, që ti s'i dhe dot përgjigje? Dalipi është si ata sahatët rroskop, që kur punojnë bien si çekanë, kur mbeten mbeten. Pastaj ti diskuton,

Razimi t'i nxjerr në mejdan. Ky njeri me nervozizëm u ngrit më këmbë. Fytyra nga inati iu mbush me gjak. Asnjëherë Bejkushi nuk e kishte vënë re se Çane Vojka, ishte një djalë aq i pashëm.

— Kot e pranuan Dalipin. I varfër, i varfër po Dalipi është një sokaqar i keq që të bëhet baltë, nganjëherë, për të të prekur, zë e qan si gratë, po s'iu bë e tij të diskrediton e të shan me fjalë që të vjen turp t'i dëgjosh, jo t'i nxjerrësh nga goja. Të vjen edhe për të qeshur kur thotë proletar njeri jam unë. Ç'kam? këto që më shikoni veshur.

— Po kur thua t'i shtrohet punës ky «proletar i varfër», në vend që t'i shtrohet punës, të vjen me thes pas krahu.

— Është Bilush Rrumbullaku ngushtë, një stan me fëmijë, por ama, të ka ndërgjegjen e fshatarit të varfër.

E lanë ta bënë mbledhjen e organizatës bazë, ashtu si tha Cania dhe, si bënë listën se kë do të thërrisnin, thanë të venë njëherë nga biloku i portokalleve.

Sustra e Kame Gjovarfës, që tani ishte e kooperativës, kishte mbetur aty jashtë, me këmbë përpjetë. Vetëm të vegjlit çoku e vinin në përdorim për të lojtur.

— Ne mund ta përdorim këtë, Bejkush. Të paktën në këto shtëpitë rreth e rrotull të mbledhim plehërat e katonjve.

— Kjo do kalë, Ne s'kemi.

— Ne kemi vendosur në organizatën bazë ta përdorim. Ti e di.

Për një çast Bejkushit këto fjalë s'i erdhën mirë. Atij iu duk sikur Cania, duke ja thënë prerazi, e kritikoi kot, po s'i bëri zë. Ai e dinte mirë

se s'kishin ku ta gjenin kalin. Dhe po të rrastiste, me se do ta blenin?

Anës vijës së mullirit kapërxyen urën e vjetër dhe zbritën poshtë.

Dalipi u doli përsëri përpara.

— E ktheva mëndjen, o kryetar. Tani do të ma mbushësh thesin? Se ke bereqet nga ai i Vilëzës.

Cania, duke shikuar Bejkushin, që, nga inati, u vrënjt, me bisht të syrit i hodhi një vështrim shpejt e shpejt edhe Dalipit, që, duke zbardhur dhëmbët, me këto fjalë deshi të tallej.

— Qënke bërë shumë qesëndjar!

— Po na thatë që me të bërë kooperativën do të shpëtojmë nga hallet.

Nuk ja zgjatën Dalipit po vazhduan udhën. Ai shiu, që kishte rënë aty nga mezi i prillit, e kishte përtëritur natyrën. Grunjërat gjelbëronin dhe tani kishin filluar të rriteshin.

## 2.

Malo Bonjaku, duke dalë nga shtëpia, ballë për ballë takoi Razimin. I dha dorën dhe krof zërin me qesëndi e mburrje

— S'u kthye Bejkushi?

— Jo!

— Si shumë u zgjat kjo mbledhje! Ç'të jetë vallë?

— Po ç'të dëgjojmë?

— Të të them unë: dru, vënçe, Razim vëllai, kij mëndjen, se një herë të vjen zogu në dorë... Ju do t'i shkoqitni vetë në mbledhje, po ato që thonë, ato janë kult, shkelje e ligjeve, shumë gjë-

ra të padrejta . . . Tri deklaratatë të rreme kishte bërë njëri për mua . . . Nuk ta them se kush të ngacmonte, po edhe ti nuk i ke patur mirë punët.

Razimi, që fryhej pak-nga-pak, mori në fytyrë një çere të verdhë dhe shtërngonte nofullat, për të shprehur mërinë e kaq kohëve.

— Ç'të keqe do t'i bënim ne fshatit, si u mendua atëhere, që unë të isha kryetar i kooperativës dhe ti sekretar i organizatës bazë të Partisë? Të na thonë ç'gabime kemi bërë . . . Mbeta unë qejfprishur? Mbeta . . . Unë që e fillova i pari këtë punë . . . mua më lanë të fundit. Me zorr të hyj unë tashti? Ti je në Parti, u fute brënda; të lanë si gunën e vjetër.

Tri ditë që kishte munguar Bejkushi e Cane Vojka, Malo Bonjaku hynte e dilte te Xhezair Kokëziu, si në kohë të parë dhe ja kishte mbushur mëndjen të bënte lutjen që t'i hiqej cilësimi si kulak.

— Do t'i shikojmë tani, këto punë. Që janë bërë gabime, domosdo janë bërë. Pse? me Cane Vojkën e me Bejkushin do të ndreqej fshati ynë?

Këtë bisedim që kishte bërë me Xhezair Kokëziun ja tha edhe Razimit.

— Ti je dhëndërr i Kokëzinjve. S'ndahet mi shi nga thoi. T'i japësh edhe ti një deklaratë e të përpiqesh atje në komitet për të. Ç'ka bërë Xhezairi? Ashtu u nakatosën punët ahëre.

Razimi e vështroi drejt në sy Malo Bonjakun.

— Mos më vështro. Kryetarët venë e vinë, ne mbetemi këtu. Pastaj s'është ndonjë gjë e padrejtë. Ai ka bërë edhe të mira, në s'i di fshati, i dimë ne.

Në luadhin e vogël Çune Bonjaku po lar-

gonte me nxitim tufën e dhenve. Që larg dëgjohej zëri i Veli Çukës:

— Nxirri, more, dhëntë andej, se është livadh i kooperativës.

— E more Veli se s'u bë kjameti.

— U bë s'u bë kjameti, o Malo, na ke bërë disa herë dëm. Mor zot, juve individëve ua kemi caktuar kullotën. Ja tek është edhe Razimi, ky është i kryesisë së kooperativës, këta i kanë dhënë këto urdhëra.

— Rri tani të bëjmë nga një cingar. O Çune, vrai lart dhëntë — iu drejtua Malua të vëllait.

— Cingar s'dua unë. Unë dua të më çmohet dëmi.

— Mirë, mirë — i tha Razimi. — Kur të vijë edhe Bejkushi.

— Po ti e pe vetë. — Veli Çuka u fut në livadh dhe po shikonte dëmin.

— Na shtërnguat shumë, Razim. Me shtërngime nuk hyn populli në kooperativë. Të fola e të fola një copë herë. Tani ti e ke kuptuar vetë. Bën si të të duket m'e mira. Ika unë, se më vajti von për në pazar.

Malo Bonjaku, si hodhi pallton në sup, u largua.

Atë ditë Razimi nuk shkoi nga brigada. Me të jëmën bashkë, pranë kopshtit të vet, preu ca tulla.

### 3

Duro Çalamanin atje, në bisht të arës, tek shkon vija e ujit, ku fshatarët, mbi një degë të trashë rrapi, kanë hedhur një urë të drunjtë për të kaluar në fushën e përtejme, po pinte një du-

han. Dielli i ngrohët i kishte rënë në kokë dhe sikur e kishte lodhur shpejt. Ujët gurgullonte dhe rrjedha atje te ura, bëhej më e shpejtë. Anës së vijës, lulet e murrizave, veshur pas degëve si shtëllungë, të vrisnin sytë nga rrezet e diellit.

Takimi që pati me Xhezair Kokëzinë e kishte turbulluar shumë. Ajo qetësi, që kishte filluar në shtëpinë e tij, po i prishej, se çdo ditë s'kishte më qejf si përpara. Xhezair Kokëziu, me ato fjalë që i kishte hedhur, i krijoi një dhëmbje të madhe në shpirt, sikur e kishte kafshuar ndonjë gjarpër. Këto gjëra ja kishin prerë fuqinë dhe lodhej shpejt në punë.

Qetë, pa mundur t'ulnin kokën, nga zgjedha, tundnin bishtin si varëse sahati, herë nga një anë, herë nga ana tjetër e vitheve. Duke u përtypur po e shikonin të zotin e tyre, sikur dinin gjë, me vrejte të madhe.

Shpesh herë Duro Çalamani ngashërehej pa masë, shpesh herë merrte vendime me rëndësi, po prapë tërhiqej me frikë të madhe.

Bukën e drekës nuk e hëngri me uri. Urla që pat marrë me vete i qe dukur farmak, edhe ato kafshata që hëngri, mezi i shkoi tatëpjetë e s'kuptoi fare ç'hëngri. Ai mendonte se mirë e kishte marrë rrugën, po tani ky Xhezair Kokëziu po i rrinte çekan mbi kokë. I shqetësuar për së tepërmi, tani kishte filluar të bëhej gërnjar. Edhe atë ditë, që e shoqja e tij bëri atë marrëzi e ja dha Xhezairit qetë për të lëruar, ai u grind me të, sa mënt e rrahu, po u përmbajt, se, në sytë e saj, pa veten të poshtëruar.

Matanë arave të tij, pendët e kooperativës po punonin bashkë dhe kishin lëruar mjaft. Atij i

erdhi zili, kur ata fshatarë hëngrën bashkë me buzë në gaz e me të qeshura.

Duro Çalamani kurrë nuk e pat besuar vехten të vetmuar e të ndarë nga njerëzia, se sa ato ditë. Bejkushi me Canen kishin folur mirë. Po që atë ditë që e shoqja e tij i dha Xhezairit qetë, i vinte turp t'u dilte përpara. Me këto mendime i ra një herë ballit me dorë dhe u ngrit e nisi përsëri punën. Qetë, edhe ata sikur e ndjenin mërzinë e të zotit, tërhiqeshin mërzitshëm. Disa re të holla vërtiteshin andej këndeј; herë duke u grumbulluar, herë duke u përhapur; ato formonin figura të ndryshme nga rrezatimet e diellit.

Këtë qëndrim Bejkushi e pat vënë re.

— Puna mbarë, Duro.

Duro Çalamani ngriti kryet, po duke e njohur nga zëri Bejkushin, iu duk sikur një komb i shkoi tatëpjetë, goјën e ndjeu të pikët dhe zemra i rrahu me shpejtësi.

— Mbarë paç!

— Prapa je, më duket — kaloi vijën me një të hedhur e iu qas më pranë.

Pas kaq ditësh që ai, sa herë e shikonte Bejkushin, shtëmëngte rrugën — i erdhi çudi se qysh vetë kryetari i kooperativës iu qas të bisedonte me të. E la pendën dhe për të mos i munduar qetë, u hoqi kularin e i la të kullosnin anës së vijës, ku tani bari kishte zënë të rriteј, duke marrë një ngjyrë të gjelbër të thellë. Qetë filluan të hanë me kaq shpejtësi, sa bari dëgjoheј, kur e këpusnin.

Bejkushi, si u ul këmbëkryq, i dha Duro Çalamanit kutinë e duhanit.

— Jo, do të bësh një nga kutia ime. Ti më ke ardhur mik, kështu është zakoni — dhe bëri buzën në gaz.

Bejkushi vuri re, se ajo e qeshur ishte një e qeshur pa qejf, si e një njeriu, që ka ndonjë mër-zitje të madhe. Po, duke vënë re fytyrën e tij të hequr, rrudhat e dëndura rreth tyre, pandehu se e kish nga lodhja.

Dielli po ulej nga perëndimi. Retë e holla an-dej kishin marrë një ngjyrë trandafili, e i jepnin qiellit një bukuri të madhe.

Sa bënë cingaret, nuk këmbyen ndonjë fjalë.

— Pambuk do të mbjellësh? . . . — e pyeti Bejkushi.

— Pambuk, pambuk. Pambuku është një bimë me leverdi të madhe. Dhe vjet ma çmuan të gradës së parë. Po e kam këtë tokë një çikë si ters. Ja, u ndodha këtu në mes tuaj, e mbase ju pengoj.

— Edhe ti nuk do të qëndrosh shumë kohë jashtë.

Ai priste se mos Bejkushi i thoshte gjë për punën e gruas. Po kur dëgjoi këto fjalë u shkrifë-rua me të shpejt dhe sikur i iku ajo dhëmbje që ndjente në fillim.

— Keq është njeriu, kur mbetet kështu ve-tëm, ë? — e pyeti Bejkushi.

— Sikur u përça ky fshati ynë!

— Fshati s'është hiç i përçarë. Ne e ngritëm kooperativën dhe ti po e shikon si punojmë.

— E shikoj!

— Dhe delen e vetme e ha ujku.

— Pse ma thua këtë fjalë?

— Je i mënçur vetë!

Era e mbrëmjes fërfërinte nëpër gjethet e atij rrapi të madh, ku kishin bërë atë urë të drunjtë. Retë po merrnin përsëri ngjyrën e tyre të murme dhe errësosheshin.

Duro Çalamani u ngrit. Si hodhi në sup par-



mëndën dhe vuri përpara qetë, pa bërë zë, u nis bashkë me Bejkushin për në fshat. Gjithë rrugën ecte i menduar, kokëulur, vetëm herë-herë, në ndonjë vend të ngushtë, shtynte qetë, që, duke u përtypur, ecnin të mërzitur.

Afër fshatit tek, ndahet rruga e lagjes së sipërme, Bejkushi, duke i hedhur dorën në sup, i tha:

— Hiq nga Xhezair Kokëziu.

Këto fjalë Bejkushi i shqiptoi një nga një, që Duro Çalamanit iu duk si një mendim i prerë.

Në qiell zunë të vezullonin yjtë. Sipër Këmbëzës, atë natë dukej se kishte shumë yj. Bejkushi gëzohej me atë bukuri të rrallë. Bukurezat e para sapo kishin dalë dhe shkëlqenin duke rendur në ajër, jo shumë lart gjelbërimeve. Duke vënë re këto, atij iu kujtua si i ndiqte kur që i vogël. Edhe sonte gëzohej si fëmijë. Kaq kohë që ishte në fshat, u mësua përsëri me jetën dhe zakonet e fshatit. Dritat e zbeta të shtëpive s'u përngjanin aspak dritave të qytetit. Në mes të këtyre mendimeve iu ndez një mall shumë i madh për jetën e repartit, për qytetin me atë lëvizje të madhe, që gumëzhin nga të gjitha anët. Po jeta e fshatit, me këto përpjekje plot zikzake, atij ja shtonte dëshirën e luftës për jetën e re në fshat, ja kishin rrëmbyer zemrën; prandaj, me forcë të madhe, mendohej ta thyente e ta bënte copë çdo kleçkë, që e pengonte.

Xhezair Kokëziu, ajo dhëlpër e vjetër, Malo Bonjaku një arrivist i ndyrë, armik, Razimi, një njeri i krymbur gjer në vetulla me oportunitizëm, losnin shpesh herë me disa njerëz të ndershëm, duke bërë një politikë të madhe. Edhe pas asaj vërejtjes, Razimi nuk vuri hiç mënd. Bile

kaq hapët vepëronte nga një herë, sa, si pa gjë të keq, e pat gjetur me vënd që Duro Çalamani i dha Xhezair Kokëziut qetë për të lëruar e i kishte thënë:

— Pse? ka ndonjë ligj që njeriu duhet të marrë leje për gjëra të tilla? Duro Çalamani qetë i ka të tijt, mund t'i hedhë edhe në lumë. Mund t'ja ketë dhënë edhe me hakë; është e ndaluar tregëtia? Ti, po deshe, propozo t'i hedhësh tatim fitimi.

Këto fjalë të Razimit ja patën prurë në majë të hundës dhe tani kur po i rikujtonte ja turbullonin atë kënaqësi, që ndjente duke soditur natyrën e qetë e të vakët, që në qiell xixëllonin yjtë, në tokë bukuretë dhe fshatarët ishin kthyer të gëzuar nga puna.

Duro Çalamani, sa u kthye në shtëpi, si i rregulloi qetë, mbylli portën dhe, atë natë, nuk u dëgjua fare.

Te porta trokiti Razimi.

— Kush është?

— Ratë?

— Po, po, kemi rënë!

Ishte e para herë, që Duro Çalamani nuk ja çeli portën Razimit.

4

Në errësirën e natës, porta e shtëpisë së Xhezair Kokëziut, u hap me ngadalë.

Që pas kthimit të tij, përveç ditëve të para, që hynë e dolën disa fshatarë, Xhezairi punonte në kopështin e tij, përpara shtëpisë. Me qetë e Duro Çalamanit lëroi arat e i mbolli misër. Di-

tën e pazarit dilte me zarzavate edhe pasdite kthehej herët në shtëpi. Rrugës tek-tuk xha Sopi e përshëndetëte, duke kthyer disa herë kryet andej-këndej, për t'u siguruar se mos e kishte parë njeri. Razimi, megjithëse shokëve, sidomos Bejkushit e Cane Vojkës, u kishte kundërshtuar, kur e kritikuan, si për fejesën, ashtu edhe për hyrjet e daljet te Xhezairi, kohët e fundit ai prapë i kishte rralluar vizitat. Malo Bonjaku kishte thënë se Xhezairi, me që nga vjeshta donte të shpërngulej fare nga fshati, kishte vendosur ta shiste shtëpinë, po gjer von dy myshterinj, që i kishte sjellë ky, nuk kishin rënë akoma në fjalë. Sadoqë shtëpia ishte vjetëruar e vënde-vënde i qe shkallmuar suvaja, ajo mbahej mirë. Me disa meremetime të paka bëhej sikundër qe. Sidomos një odë me qoshk, mbi derën e madhe, fshati nuk e nxirrnin nga goja. Të rrije në verë, afër dritareve, sikur të mbante njeri në duar, kaq mirë ishte qoshku. Nëndivani shtruar me çimento, s'qe prishur dhe aq. Vetëm praku i derës, qe gërmuar e thyer në shumë vende. Xhezairi me të shoqen mblidhej në një pat. Në qoshk e shoqja nderte këmishët dhe në kohë të misrave hidhte kallzin. Dy dhi malteze, që ja kishte dhënë keçëre Malo Bonjaku, tani i qenë rritur, bërë me keçëre, i jeonin mirë qumësht. Një pjesë të qumështit e bënin djathë, një pjesë e rrihnin gjalpë, të cilin e shisnin në pazar, dhe dhallën e bënin gjizë. E shoqja, një grua shaloshe, atë pasdreke kishte bërë një qumështor e kishte therur një pulë. Ajo s'kishte marrë akoma vesh sepse i shoqja kishte kërkuar këtë darkë të burbuletur. Po, kur e pa që ai në maië të gishtrinjve doli e hapi derën e madhe, me frikë në zemër e pyeti se kush do të vinte që po hapte derën.

— S'të hyn në punë, moj grua! Ti shiko dar-  
kën dhe mbylle gojën.

Pas pak hynë brënda dy vetë. Nga errësira  
ajo nuk i njohu. Po, sa hynë në pat, u çudit e  
erdhi e mbeti, sepse Malua e Razimi erdhën kështu,  
fshehura. Bëri ta pyeste, por u përmbajt, se  
mos i shoqi i jepte ndonjë dhëmb.

Xhezairi u ul me Malon në njerën anë të  
oxhakut dhe zunë të bëjnë nga një duhan.

— Hajde dhe ti, shoku Razim, rri — i tha  
Xhezairi. Fjalën «shoku» e shqiptoi me qesëndi. Po  
Razimi e hëngri dhe bëri buzën në gaz. — Apo  
ta vunë gishtin? Se këta kështu e kanë, po s'të  
vunë dot poshtë, të nxjerrin jashtë... Na, moj,  
— iu kthye e i foli së shoqes — na sill atë rakinë.

— Razimi mërzhitet nganjëherë, po unë i  
them ç'bëhe budalla dhe ti... Ata që e ngritën  
kooperativën, ata le të përgjigjen. Pa kokallat  
**tona s'mbahet kooperativa** — ja priti Malua, duke  
mbledhur këmbët, për të vënë e motra kanistrën  
dhe tepsinë për rakinë e mezetë.

Razimi akoma s'e kishte kuptuar se ç'qe kjo  
darkë, që i erdhi kështu e papritur dhe s'fliste  
fare.

— Unë ta thashë ty, Malo, sepse desha t'u  
mbledh sonte. Razimit s'ja kam thënë, se s'kisha  
ku ta gjeja. T'i dërgoja vjehrrën nuk m'u duk me  
vend se «komprometohet». — Mbylli njerin sy  
dhe kafshoi mustaqet. — Dëgjo, Razim. Unë të  
kam dhëndërr e djalë. Ti, këto kohët e fundit, në  
vënd që të dalç në krye, e ke humbur fare pusul-  
llën nga këto që ngjajnë në kooperativën tuaj. Unë  
dje, tek vija nga pazari, udhës gjeta një letër për  
Bejkushin. E hapa. Qe pa firmë. Po e di ç'tho-  
shin në atë letër? Elmasë gurët ja hidhje ti. —

Xhezairi e vështroi në sy Malon, atë çast që Razimi u zbe si dyllë dhe uli kokën.

— Çpifje! — Razimi më shumë murmuriti, se sa foli.

— Ti je trembur që kur erdhi Bejkushi. More inat që s'të vunë kryetar, dhe ti s'di ta lozësh asnjë çikë politikën, në vënd që të të hedhë Bejkushi e Cania t'i hedhësh t'i. Në vënd që të lëftosh Bejkushin, ai po të vë nën vete. Kërkon të më lësh edhe vazjën që të shpëtosh lëkurën!..

— Po më kanë shtërnguar, ndryshe do të më përjashtojnë nga Partia e pastaj ku të mbytem?

— Po gjene ty do të të përjashtojnë, sidoqë të bësh. Në mos i ra në dorë kjo letër Bejkushit, do t'i bjerë një tjetër si kjo.

Razimit i qe tharë goja dhe pështymën helm mezi e shkonte tatëpjetë. Balli i dërsitur i fekstinte në rrezet e dritës së llambës.

— Unë, — vazhdoi Xhezair Kokëziu — mund të kisha ardhur në mes të ditës në shtëpi, a në kryesi për punën e vazjës. Po nuk e bëra. . .

— Domosdo — ja preu fjalën Malo Bonjaku — sa e do ti Razimin, kush do ta dojë tjetër? Bejkushi? Apo Cania?

Letra për Elmanë Razimin e tronditi tepër, sado që ai në këtë punë nuk kishte gisht fare. Fjalët e Xhezairit i futën datën. Duke pirë cingar, i dridhej dora kaq shumë, sa disa herë, i ra cingari në tokë. Ai e ndjente vehten të shtërnguar në një darë, që s'po e linte të merrte më frymë.

— Unë e di që me ju nuk e ha dot — vazhdoi Xhezairi. — Nuk jam fare i trashë. . . që të mos e kuptoj forcën e këtij pushteti. . . po shpresën nuk e kam humbur. . . Ktheje, Malo — përpoqi gotën pas gotës së Malos dhe shqepi me ze-

mërim një kofshë të pulës. Nga këmisha e zbërthyer i dukej gjoksi leshtor, gjer afër gushës. Në këtë kohë hyri Larushja, me byrekun në duar.

— Vure aty, në vatër! — i tha Malua.

Razimi e vështroi Larushen me bisht të syrit. Ajo u skuq dhe uli sytë, si e turpëruar, po buzëqeshi me gëzim. Një dhëmb i florinjte i vetëtiumidis të tjerëve, që i zbardhnin si rruaza midis buzëve prush të kuqe. Duke u larguar u dëgjua fëshfërimi i dimitëve xhamfes .

Ky çast e turbulloi Razimin dhe gotën e rakisë, që nuk e kishte pirë ende, e ktheu më njësh.

U bë pak qetësi dhe të tre sikur ranë në mendime.

— Unë u përpoqa për të mirën e tyre. Vdekjen e besoja... Edhe burgun që mund të më fusë Bejkushi e Cania e besoj... po një turp të tillë kurrë s'e pritja. Se edhe zëre se si vajzë e kam Larushen — tha Malo Bonjaku. — Në Delvinë ma kërkuan njerëz të mirë e të dëgjuar. Këtij ca brashnjarë për ambicje personale, i thonë ndaje, se është vajzë kulaku.

— Po ku qe kur e dhe fjalën dhe bërë edhe gosti? Le të kishte marrë Elmanë! — qeshi Xhezairi.

— Në të ri bëjnë axhamillëqe dielmuria, Xhezo, sikur edhe ne kemi m'etu esëll... Po kur i hedhin rrypat kokës mbledhim mëndjen dhe nuk lozin me fatin e vajzave... S'na fole një fjalë, Razim...

— Hamë një mëllë bukë? — i pyeti Xhezairi. Pa Razimi ka mëndje vetë. Unë, këto që m'i kish barku e zemra, ja thashë.

Razimi mezi u tha natën e mirë. Me çap të nxituar u zhduk, sikur nata e përpiu pa nam e pa

nishan, sapo kaptoi stomin e kopshtit të Xhezairit.

I zoti i shtëpisë e Malo Bonjaku diç pëshpëritën, po në errësirën e nën divanit nuk shquheshin nga fytyra, nëse u gëzuan apo u penduan për ato që i *bumbullitën* Razimit.

Kanatën e derës Xhezairi e mbylli me shumë kujdes.

Mbi Këmbëzë. qielli i shkruar me yje dukej i lehtë. Kashta e Kumtrit, si një mjergull e imët, humbiste në horizont, matanë Bedenit.

\* \* \*

Xha Sopit i qenë veshur gratë e po shanin e mallkonin, që e kishte lënë Larikën, në jonxhë e qe gdhirë dubicë.

— Ç'është? — i pyeti Razimi.

— C'të jetë?.. Ma ngordhi Larikën.

— E po... në ngordhi, ngordhi... Ikni në punë, do ta shikojë kryesia dhe do të marrë masa.

— Ne s'duam masa, more Razim! — iu hodh e shoqja e Kame Gjovarfës. — Duam Larikën.

Xha Sopi te dera e haurit, mbledhur kruspull, shikonte me bisht të syrit shatin e Kames, se mos ia vërvit në kokë.

Razimi i qetësoi gratë e i nisi në punë.

Vetëm Kamja s'po i ndahej Larikës, së cilës i qe fryrë barku, sa më një i çahet lëkura. Lëkura e barkut i shkëlqente si tullumbace.

— Na dërgon edhe në punë — iu drejtua përsëri Razimit — nuk na thua t'i hidhemi Sopit e ta shqyejmë të gjallë.

Në këto fjalë e sipër, xha Sopi hyri me shpejtësi në haur e i hodhi derës kataranë.

— Ç'ke, moj nuse e Kames? — e pyeti Malo

Bonjaku, i cili u takua ballë për ballë me të, duke ardhur nga fusha.

— Na ngordhi Larikën, more Malo, ai matufi. . .

— E ç'faj ka Sopi, ai gjysëm njeri është. Fajin e kanë ata që e kanë vënë. Do zot malli, këto ka kooperativa.

Malua kaloi shtegun e baçes dhe zbriti poshtë nga bostani.

5

Një çiban, që i kishte dalë ato ditë në të ndënjur, Xha Sopit i kishte marrë zemrën e barkun. Nga çdo anë që kthehej, sikur e shponte njeri me gjëlpërë, ashtu si i nevikosur, s'pushonte fare së zëni me të shoqen.

— Kurrë s'ma hodhe mirë llapanë, moj e uruar.

— E po ç'të të bëj unë, more burrë. Kushedi mund të mos jetë çiban, mund të jetë gjëkafshë tjetër, nga gjëlpërat.

— Kujtona të ndonjë gjë tjetër, se ti s'ke punë, jo çiban, jo lungë, jo stërkungull.

Xha Sopit i dukej sikur iu bë shkak ajo punë e Larës, që i prishi gjakun e e katandisi në këtë hall. Po më në fund, si kaloi disa netë të vështira, çibani i mblodhi e iu shpua dhe zuri të dilte nga një çikë, në diell. Po nuk largohej shumë nga shtëpia, se ai çibani i kishte prerë fare fuqinë.

Si lidhi poturet dolli e u shtri mbi lizmën përpara portës.

Nja dy të vegjël, sa e panë, filluan ta ngacmojnë.



*Xha Sopi,  
Këmbë topi  
Sopi, Sopëla përpara,  
E pësoi se ngordhi Lara.*

— Hë, gremisuni që këtej, surretër!

Këtë këngë të mallkuar ja kishte ngritur Dalip Zeshkani, që s'linte njeri në fshat, pa i ngritur këngë. Po me që ata s'po pushonin, ai rrëmbeu shkopin.

— I kni, majmunë, se po ju zura dot të gjallë, e dini vetë se...

Ata thyen me sa vrap që kishin. Xha Sopi, duke u shtritur disa herë, e ndjente vehten mirë. Ai dielli i Majit ato ditë ishte bërë shumë i këndshëm; që të mos i digjte fytyrën, hodhi në kokë një copë pëlhurë, që e mbante për të fshirë hundët. Kështu e zuri gjumi. Ca pula, duke kullotur aty afër, iu qasën Xha Sopit dhe po çukisnin n'atë pëlhurë, gjithë ato thërrime buke, që ishin tharë andej e këndeje. Një gjel çapkën, me një bisht plot pendë të gjelbëra, s'i linte hiç rehat pulat. Sa linte njerën, zinte tjetrën. Aty rrotull po vinte edhe kllaçka e xha Sopit. Ajo, pas pulave të mëhallës, tërhiqte zoqt e vet dhe, sikur ta dinte që ai njeri i shtrirë ishte i zoti i saj, u hëngër me një pulë dhe me krahë e vrau, gjersa e largoi fare. Zogjtë, me atë sqep akoma të verdhë e të butë, si palcë, me ato pendë, që sapo kishin filluar t'u shquheshin, hidheshin andej-këndeje, mbi trupin e xha Sopit. Njëri, atje në bisht të gojës, i shpërndante mustaqet e xha Sopit me nervozizitet, se, sa largonte këmbën, s'e linin të tjerët për të marrë një copë bukë misëri, që, si për çudi, i kishte qëndruar ke bishti i buzës, sikur i qe ngjitur me tutkall.

Xha Sopi, si kishte shpëtuar ato ditë nga dhëmbjet e çibanit, atje në diell gjeti rehat, dhe nuk po dëgjonte se ç'po bëhej. Po një rreze dielli ja çpoi hundën dhe teshtiti aq fortë, sa edhe kllçoçka s'çau kokën se ç'do bëhej me zogjtë, që u përshkënditën, po duke rendur e fluturuar, u gjend në fund të gardhit. Ca nga teshtimat, ca nga të kakarisurat e kllçoçës xha Sopi u zgjua dhe, si hoqi pëlhurën nga koka, u ngrit paidash.

Që kur mësuesja i bëri atë vizitë në shtallë, xha Sopit sikur s'i vajti mbarë. E kritikuan në mbledhje ata të kryesisë, sa ja bënë samarë copërra. Gratë, duke e sharë, i hoqën gur' e fundit. Ai i shkretë qe përpjekur t'i sqaronte.

— Daleni, moj motra, daleni, more vëllezër, se ju më bëtë për një para.

— S'i duam llafet, jo!

— Po fol edhe ti, moj grua!

— Të thashë unë, mos e merr këtë punë, se s'e bën dot.

— Po pse? gjithnjë poshtë se poshtë do të mbeteshim?

— Ti s'ke patur ndonjëherë lopë.

— E ç'do të thuash? se s'di unë nga punët e lopëve? Kur e harrove? a s'ta nxorra urë shtratin e lopës? Aman, more Sopi, të marsha të keqen, t'u bëfsha kurban... E tani më hidhe si grifshë. Pse? S'e bëra shtallën dritë? Pastaj mua m'i mblodhët këto gjëra vandak e m'i zbrastë sonte. Më ndihmuat gjë? Më hoqët ndonië vërejtje që ta kisha shënim? Ahere po. Po edhe në ngordhi Larika, c'ti bëja unë? Këtu vdesin nierëz, jo hajvanatë. Pastaj, se mos qe edhe ndonië gjë, kush e di, edhe Larika. Një kërmë, s'të kishte as vithe, as gjoks, s'kishje ku të vije dorën.

— Na marrç të ligat. . . Larika ka qenë balli i lopëve të fshatit. . . kur e harrove, që ta prura sa një shtëpi?

— E, moj, e. . . Ajo që nesëret u shfry. Ato shiti gjetkë. Vajte e i dhe ti krypë, piu ajo ujë e u fry, e u fry si kacek e ua hodhe këtyre axhamive që s'të dinë ç'është lopë. Pse ta ktheu vjet ai i grumbullimit? . . U thash unë, more shokë, fshatarët do të japin ato gjedhe kallpe. T'ua zgjedhim ne, ose t'i mbajmë një natë me provë. Kur u thash unë ahëre, që qe dobësuar, se si u katandis Larika, më thatë s'i ke dhënë për të ngrënë. Dhe na, tani e paguaj unë, edhe një natë që hëngri, e hëngri me tamaqarllëk.

Kjo ngjarje e asaj nate i kishte ardhur e papritur xha Sopit. Ajo mësuesja s'i qe dukur dhe kështu vajzë, që ta merrte këtë plak njeri nëpër këmbë, t'i donte të keqen, e t'i priste bukën e gojës. Kur ngordhi Larika, të gjithë u çuditën. Ajo pat ardhur mirë e bukur në mbrëmje. Kishte ngrënë, ujë kishte pirë. Xha Sopit i kishin thënë se s'kishte çarë kokën, me një gjylypëryer ta kishte shpuar, Larika do të shpëtonte.

— Pse? jatro jam unë?

— Ahëre, me që s'di nga këto punë. . . ta heqim e ta vëmë në ndonjë punë tjetër.

Dhe kështu qe vendosur. Ai, pasi të shërohej, do të merrej me Bobolin, dashin e rracës. Nga rojtar Veli Çuka u caktua stalljer.

## KREU I TRETË

### 1

Që prej asaj nate që u takua me Bejkushin, Duro Çalamani ndjente shqetësim. Dita i dukej sikur i kalonte shpejt, orët e natës sikur s'po mbaronin kurrë. Gabimin e së shoqes e kishte përpara syve orë e pa kohë. Kokëziu i rrinte si çekan mbi kokë. Po meqë nuk e pranoi Razimin, si përherë në shtëpi, mendonte se kishte ardhur koha që po ndaheshin lakrat. Fundi-fundit mua — thoshte me vete — s'më ka rënë njeri në qafë. Me punën time rroj edhe unë. Nga pushteti të mira kam parë. — Ai sillte në mënd fshatin në kohë të parë. Kushdo vinte për ta rjepur, shumë braktisnin arat dhe endeshin si zogjt e korbit për të fituar bukën e gojës. Kurse sot të gjithë punojnë tokën e tyre me vegla të reja, me traktor, që më përpara as nuk i dinin emrin. Nga pambuku të mira kishin parë. Dhe Duro Çalamani e kishte rregulluar punën e tij dhe të gjithë familjes i kishte rritur dashurinë për punën. — Punovë — gëzove — i thoshte gjithmonë gruas dhe kunatës. Duart s'i rrinin çikë. Edhe atë kohë që i mbetej, herë rregullonte kotecin e pulave, herë ndonjë mur të kopshtit. Në pranverë shartonte pemë

të ndryshme, rregullonte shtratin e një razakie, që ja mbante në gojë gjithë fshati, Hendeqet e arave i bënte me kujdes e sa herë që gjente ndonjë gur në arë e hidhte mënjanë. Vështirë i kish-te në shtëpi fjalët grarishte, u fliste gjithmonë të vështronin punën. Me ekonominë e tij kishte rregulluar rrojtjen për bukuri e në dollapet s'i mungonte asgjë. Por atij ja coptonin zemrën dy gjëra. Të vëllait, fill, në pragun e çlirimit, si i mori koka erë pat ikur për hiç punë, pas berihajt, me ata të ballit. E kunata, që rrinte me kokëvjerrë, ja coptonte shpirtin. Edhe ai gëzimi i pafundshëm që ja mbushi shtëpinë, kur u shpall amnistia i qëndronte i vagulluar. Kushedi vallë ku do të ishte, me çfarë shoqërie trazohej e më shumë e hante frika se mos kushedi e kishin gënjer, si disa të tjerë, e e kishin futur në punë të prapa. Veç në do ta kenë lënë fare mëntë që të mos vijë. Këto mendime e tronditnin. Edhe pas kësaj ai duhej të mbante një qëndrim. Një drithërimë i shkonte nëpër shtat e mishtë i bëhej kokërza-kokërza. Pse të mos ishte i kënaqur, po të kthehej? Nusen e gjente shëndoshë si molla. Asaj nuk i qe prishur hiç fare bukuria, me gjithë ato fijet e para të bardha, që kishin filluar t'i shkëlqenin si ergjënd, sipër veshëve të vegjël. Shtëpinë do ta gjente plot.

Vetëm ai Kokëziu ja turbullonte çdo gjë. Sa herë që e gjente përpara mallkonte qumështin e nënës e i pritej fuqia. Buzët i piqeshin. Ata sytë e shpëlarë e tmerronin, i dukesh sikur ata po e shtynin në greminë. Prandaj aio që bëri gruaja, ato ditë e kishte xhindosur e s'bënte rehat hiç fare. Në këtë e sipër te porta u duk Razimi.

— O Duro!

— Prapë e solli kokën.

Razimi, hedhur pallton pas krahëve, me atë këmishë të zbërthyer gjer në gjysëm të krahërorit, nga ku i dukej një nishan i djegur, që në vogëli, hyri në oborr.

— Punë e mbarë.

— Mbarë paç! — iu përgjegj Duro Çalamani, pa e shikuar fare në sy.

— Mbase të preva nga puna?

— Ç'të bëj? na duhej një govatë e vogël dhe po merrem me të.

— Qe gjë Malua këndeje?

— E ç'donte Malua, a derëzi, tek unë?

— Jo, po them. Se ishte bërë si i marrë fare. Dhe kjo pikë e zezë. Të ndash vëllanë nga vëllai?

— Po Dinua është ndarë, t'i japë ç'i takon. Kështu është gjëndur, more Razim. Vëllezëria edhe ndahen.

— Ndahen, ndahen, po me të mirë.

— Ashtu duhet. Edhe Malua të mos bëjë naze, t'i japë pjesën që i takon.

— Dhe t'ja bëjë peshqesh Kames. Pika që i bie edhe Dinos, e u katandis të futet kokomblaq të Kamja.

— Kamja është burrë i mirë, s'është ashtu si thua ti. Edhe vajzën e ka të mirë. Pastaj, more djalë, mos i merr njerëzit nëpër gojë. . ., s'duhet hedhur krypë në gjellë të botës. Ata janë vëllezër dhe në kërkoftshin mëndje, jepu, si të jetë m'e mira. Po Dinua në e dashtë Shkurtën, s'është ndonjë turp në hyftë dhëndër. Kanë bërë vaki edhe gjëra të tilla.

Lëshoi sqeparin në shesh dhe me njerën dorë, mbasi mblodhi në dorë të gjitha ashklat grumbull në një qoshe, e ngriti govatën dhe e mbështeti

përmbys pas muri. — Kështu, more djalë, kështu them unë.

— I mbaroi Xhezairi punimet. . . — dhe duke mbërthyer rrypin e opingës e vështroi me bisht të syrit.

— Dëgjo, more Razim. Ti mund ta thuash edhe në Parti, se je i brëndëshëm. Dhe Partia e ka marrë vesh. Po tani s'bën para, atë punën e e qeve e dinë e e kanë marrë vesh i gjithë rrethi më përpara nga ti. Mos më bjerë në qafë. Unë. . . — dhe e preu fjalën, pastaj, duke i shqiptuar një nga një fjalët, vazhdoi — dua të rroj me nder me shoqërinë. E di që më ka kushtuar rëndë ajo marrëzi, që bëri gruaja ime. Po ama, ka njerëz që s'mendojnë si ti, dhe unë nuk dua ta prish shtëpinë time.

— Mbase ke në mend të futesh në kooperativë? — e pyeti, si me qesëndi.

— Po në më pranofshin, edhe mund të futem. Njeriu pa njeri as këtu, as në atë botë, si thotë fjala, mos qoftë. Mua me këtë Parti dhe këtë qeveri veç të mirës s'më ka gjetur ndonjë e keqe.

— Edhe unë e kam thënë. . . Po ti i ke ca kleçka.

— Edhe ai vëllai, që më pikon në zemër, se e kam vëlla e shpirt e nuk e bëj hasha, në ardh të, mirë do të bëjë, në mos ardh të — dhe psherëtimi — në qafë pastë veten. Do të kem nusen në këmbë të tij. — U ngrit për t'u larguar nga biseda. Vështroi njëherë qiellin. — Duket do të bjerë shi.

— Ashtu duket! — iu përgjegi Razimi, që, pa kuptuar, e ngritur edhe ai në këmbë.

— Daleni — u foli Elmaja — se kam vënë kafënë.

— Nuk e dua, moj nuse, s'e pi dot para buke se më pret oreksin — iu përgjegj Razimi, që duke i shkuar mëngët palltos u largua i menduar.

— Bëne, moj nuse, bëne ta pimë bashkë — i tha i kunati.

Kaq herë ai e pati ftuar të pinin bashkë nga një kafe, po ajo s'kishte dashur, jo se nuk i pëlqente, po më shumë nga turpi. Ajo, si dëgjoi gjithë ato fjalë me Razimin, ndjeu një çlirim të madh të ndërgjegjes së saj dhe faqet i qenë skuqur, sytë me një varg lot rrëzë qepallave i shkëlqenin dhe kuptohej lehtë se një ndjenjë hidhërimi e gëzimi bashkë ja pat pushtuar atë çast zemrën.

Elmaja, kur u ulën, si hodhi kafënë në filxhanë, e shikoi të kunatin në sy, me mallëngjim.

— Baba, — ashtu kishte zakon dhe e thërriste të kunatin — po sikur të vijë a i bëjnë gjë?

— Qeverria e ka falur, moj vajzë, dhe po të vijë e t'ulë kokën, t'i shtrohet punës, s'i thotë njeri as mashalla... Kjo qeverri s'di prapa kraheve. Është për popull gjithë, lëri ç'thoshin se muarr botën në kafë. Razimi, për të mbuluar të palarat e tij, s'deshi të na jipte triskën e frontit... e kërkova më lart, dolli e drejta në shesh... — Po dhe në mos ardh të, moj nuse, — fjalët mezi i shqiptonte, balli filloi t'i dërsijë, svtë iu mbushën me lot — nuk e kam për vëlla dhe unë do të të kem ty në vend të tij. Nuk e hedh dot shtëpinë në lumë... Jo po në deshe prit edhe ca, pastaj ti je akoma e re... martoju... Do të të përcjell edhe si nuse... unë do të vij të shikoj... do të të kem njësoj si vajzë.

Ajo mezi e shkante kafënë. Buzët i dridheshin dhe zemra i kërcente si pulë. Për atë e di-



në të gjithë se s'ka bërë gjë... — Hajde ta pimë kafënë, se u ftoh fare.

Aty, duke pirë kafënë, ajo i tregoi atij të gjithë historinë e gurëve dhe të Malo Bonjakut.

— Ashtu?! — tha Duro Çalamani dhe u pre në fytyrë.

E shoqja e Dalip Zeshkanit me hallën e Razimit, kur po ktheheshin nga puna shkuan drejt e në kryesi të kooperativës për të kërkuar Bejkushin. Halla e Razimit qe bërë bishë, se çobani u qe qarë për punën e dhenve, që s'kishte ku t'i kulloste.

— Vdiqëm, more Vesho, për një pikë qumësht. Më mirë ishim kur s'kishim ngritur kooperativën. Duam kryetarin. O të na bëjë derman për Bedenet, si e kishim fjalën, e të kullosim edhe dhëntë tona, o të na japë mallin, do të dalim nga kooperativa.

— Kush të dalim? Për kë flet? Për fshatin, apo për vehte?

— Makar për vete!

Veshua kishte zakon që mbushej e mbushej; pastaj shkruhej. Rrëmbeu drunë e zigjit.

— Ikë këtej, se të blova brinjët, balliste e qelbur. Atë e dinë ata të kullotave, more vesh?

— Po, po. Ata të kullotave. Se ua dërguan nga ndërmarrja një teneqe me djathë. S'ka vdekur hatëri — ulërinte halla e Razimit.

— Moj, e di që po shan pushtetin? Ikni ju them, të dyjave, se e di vetë ç'u kam për të punuar.

— Kjo e Dalipit le t'ikij, unë ikij sa të vijë Bejkushi. Për Bedenet na e kthyet fjalën. Kur qënkeshtu, pse na thatë të hyjmë në kooperativë?

Veshos nuk i durua. Ai tani s'mbante më. Si i dha një surrup së shoqes së Dalipit, tek matej të nxirrte jashtë hallën e Razimit, kjo ja priti fytyrës me një copë litar si kamxhik. Ai nga dhëmbja vuri duart në fytyrë dhe s'pa ç'po bëhej. Ajo, me të shpejtë, doli përjashta dhe zu e po bërtiste si e çmëndur.

Pas kësaj, Veshua, si e mblodhi veten, mbylli magazinën dhe u nis me nxit poshtë për të arritur në Rreth. Bejkushi e Cane Vojka kishin dy ditë në rreth, për një mbledhje me rëndësi, për kooperativën. Prandaj ai do t'i arrinte atje dhe të pyesnin në Rreth, si do t'i bëhej halli për të gjetur se kush ua trazonte punët. Si i hypi korrierës, gjatë gjithë rrugës mendonte «duhen qëruar ca, duhen futur brënda, që të vënë mënd të tjerët».

Sa zbriti shkoi drejt e në mbledhje dhe priste te dera, sa të bënin pushim. Për të kuptuar se ç'ishte puna e mbledhjes, nëpër një të çarë të derës e zgjati ca veshin dhe po dëgjonte. «Bedeni...»

— Edhe këtu qënka ngritur puna e Bedenit. Veshua, sa dëgjoi se u bë pushim, s'priti, po u fut brënda në sallë:

— Bejkush, o Bejkush!

Bejkushi e preu fjalën me disa shokë dhe duke rendur iu drejtua Veshos:

— Ç'është?

— Ç'të jetë? Keq... Janë hapur fjalë se kooperativa do të priset, se ti me Canen kini ardhur

në Rreth, që të merrni leje për të prishur kooperativën. Gratë ulurijnë si çakenj: «Bedenin, o po s'kemi gjë... Na lini të dalim nga kooperativa». Pa shiko? Më ngordhën me litarë turinjve. Dhe kush? Halla e Razimit, që ka qënë një balliste e fëlliqur, ajo kunata e Xhezair Kokëziut, ajo këmbë shtrëmbëra, ajo shpirt katrania, që e futën në kooperativë, që të mos e bënë edhe atë kulake.

Bejkushi u prish në fytyrë dhe thirri Canen.

— Pa hajde, o Cane!

Kështu e kështu — e tregoi ngjarjen edhe njëherë Veshua. Jini të dy këtu, ndryshe s'kemi gjë në vijë. Po zgjidhtë punën e Bedenit, pastaj e dimë vetë. Cave u japin duart, ca i rrasin brëndë, ta bëjmë Këmbëzën që të mos ketë shoqe; s'duhet të rrimë me duar të lidhura. Ato që më rrahën mua, zëre se u ngritën kundra pushtetit, po edhe unë ja theva brinjët asaj hallës së Razimit, i dhashë një të shtyrë që s'di se ku e përpoqi kokën.

Pas pushimit mbledhja vazhdoi. Veshua shkoi për t'i pritur në klub.

Bejkushi e Cania, pas mbledhjes, si biseduan me sekretarin e Komitetit të Partisë, erdhën në klub, muarrën Veshon dhe u nisën me «gaz» të komitetit.

— Më mirë të më kishin vrarë, se sa të rri e të dëgjoj: si puna e atij magazinierit, që e rrahën gratë — u qa Veshua.

Bejkushi përpiqej të ruante gjakftohtësinë. Atë nuk e nevrkosnin këto budallallëqe që thoshte Veshura, po puna që çështja e kooperativës ishte në rrezik. Ato të dy gratë, ishin masha, po tani po dilte edhe dora.

Si ndenjën pak të tre të menduar rreth tryezës,

në zyrën e Kryesisë, Cane Vojka vendosi të mbledhin organizatën. Ashtu e vendosën.

— Sa të lajmëroni ju, unë po dal nga vija e mullirit. Kam një kokë dunup — u tha Bejkushi.  
— Ai andej shpesh bënte shetitje.

Hëna, që kishte filluar të rritej, shkëlqente mbi degët e arrës, përpara zyrës së kryesisë, si ndonjë kurorë e artë. Qielli mbushur me yje, dallëngadalë, po humbiste në horizont ngjyrën e tij mavi të mbrëmjes. Anës së vijës, prej kohësh, një fshatar zemërmirë e mësuesia me nxënësit e shkollës, kishin mbjellë një varg kavakësh. Ato tani ishin rritur dhe në mbrëmje era fërfërinte.

Për nën vijë shtrihej fusha. Ujët e vijës ecte me aq qetësi, sa s'dëgjohej fare. Bejkushi e kaloi tërë atë rrugë plot me mendime. Atij, që i pëlqente aq shumë natyra, i vinte maraz që s'po e shijonte dot e, duke shëtitur, ta sillte mëndjen te Esmakua e tij, të cilën tani në kooperativë, e takonte më dëndur e që qe përgatitur ta kërkonte, megjithëse, sipas zakonit, duhej t'ja sillnin me krushqi.

Ngandonjëherë, atë qetësi të atij bunari e prishte ndonjë bretkosë, që trembej nga të ecurit e Bejkushit, e kërcente plluc në ujë. Faqja e çveshur e malit, që fillonte sipër fshatit, kishte marrë një ngjyrë të murme. Në krah të majtë dukeshin të errëta buzët e Bedenit, për fund të të cilave fillonte një përrua i thellë, ku derdhej ujët e kanalit, që patën hapur një vit më parë, mes për mes fushës, pothuaj paralel me vijën e mullirit, ku kalonte ujët e lumit të Bardhë.

Pa vajtur te mulliri, në një monopati, që kalon për në avllinë e Duro Çalamanit, nëpër errësirë Bejkushi dalloj një njeri trupmadh, që u

ngjit shpejt e shpejt e bëri sikur s'vuri re njeri. Mbajti këmbët dhe bëri të shtëmënej pas ovoroit. Atë çast një plumb ja përcëlloi bracën e krahut të djathtë. Sa nxorri koburen, nëpër një zallish-te, pas mullirit, u dëgjuan gurë, që u rrokullisën dhe një vërshëllimë.

Pas pak ra përsëri një qetësi e madhe dhe filluan të dëgjohen bulqit kër-kër...

— Ç'që kjo pushkë, more? — u dëgjua zëri i Cane Vojkës.

Në shkallët e kooperativës erdhi Bilushi, Nuredin Bardhi.

Bejkushi, duke mbajtur plagën me dorën e majtë, i qetë u tha:

— S'ka gjë... Një plagë e vogël...

U ngjitën në kryesi. Ai po u tregonte si kish-te ngjarë. Cane Vojka me Dinon ja lidhën plagën.

Në këtë e sipër xha Sopi, me një frymë hyri në dhomën e kryesisë, pa trokitur fare:

— Halla e Razimit i preu xha Veliut rrugën dhe po i merrte kanë. Të dëgjoje si çirrej, si çakall...

— Po xha Veilu?

— Xha Veliu? Prandaj erdha, më dërgoi Veliu. Pastaj, more derëzes, na latë edhe pa një alet të shkretën, me çfarë t'i trëmbësh njerëzinë?

— Ti, shoku Razim, ti thuash hallës, që që sonte ta çojë Murrin në shtallë. — iu drejtua Bejkushi Razimit.

— Tani më thoni, — vazhdoi xha Sopi, si të bëjmë për nesër? Të vete edhe unë ta ndihmoj Veliu? Se mos na dali dhe ndonjë tjetër... Pa unë them, më e mira do të jetë t'i mbajmë këtu afër Kryesisë, jo se trëmbem për vehten time, po se janë malli i qeverrisë... domethënë i yni.

— Mos ki frikë, xha Sopi.

— Ai dreqo Beden na i bëri të gjitha këto... Po, mos do të prishet gjë kooperativa?..

— Kush tha? — iu akërrua Cane Vojka.

— Jo, po kështu dëgjova... e kështu flitet.

— S'flitet kështu jo... Kooperativën tonë s'e prish dot njeri... — Bejkushi shtrembëroi pak buzët se jodjua po i digjte plagën.

— Ashtu them edhe unë. I kam dhënë një surrup asaj së Dalipit që ta mbajë mend tërë jetën. S'të del mirë — i thashë — këto fjalë janë raksonare. Hë... bishtin në shalë... duhet edhe një çikë me frikë... — Me që Bejkushi s'po ja vinte veshin, xha Sopi u ngrit për të shkuar. Po, duke mbajtur këmbët, u kthye edhe njëherë nga Bejkushi. E vështroi në sy, pastaj iu qas afër e i zuri dorën e plagosur: — Mos e harro këtë gjak! Dëgjomë edhe mua, pa le të thonë që xha Sopi di vetëm të përrallisë.

— S'kemi edhe atë të grumbullimit që të bënte ca punë sqaronjëse — tha Bejkushi, ja dha të qeshurit, dhe vazhdoi:

— Ah, i varfëri unë, ta kisha këtu tani po s'ja kafshoja edhe veshin tjetër që të mos e thoshin edhe atë Vesho si tonin, po Shyto. Pastaj vuri re xha Sopin, që po dilte dhe vështroi plagën.

— Nuk e do me të urtë fshatari. Të kam thënë unë, hiq dorë nga këto metoda ndihmëse. Ku ka me të bindur? Unë e kisha llogaritur edhe këtë punë se kështu do të na dilte. Ka kohë që ca kanë filluar të dredhin bishtin. Xhezairi s'erdhi për të mirë, Malua... Ti ke qënë edhe në ushtri, edhe në Komitet të Partisë. Jep një herë urdhër dhe, kush të mos e zbatojë, e di vetë ti. — Apo s'them mirë? — Veshua vësh-

troi në sy edhe Cane Vojkën. Po me që Bejkushi s'po fliste, atij i vinte plasja.

Kooperativa ishte në pragan e të korrave. Ato dhjetë shtëpi që e formuan, të parat e dhjetë të tjera, që hynë më pas, akoma nuk ishin forcuar si duhet.

Prandaj, sa u mblodhën shokët e organizatës Bazë, Bejkushi e nisi paraqitjen e çështjes me një ton të rreptë.

— Kjo gjëndje është e palejuar. Të marrësh kaun nga shtalla e kooperativës, do të thotë të ngrihesh kundër ligjeve — dhe i ra tavolinës me grusht.

— Unë të urdhëroj që ti, shoku Razim, t'i thuash asaj hallës sate, që qysh sonte ta çojë Murron në shtallë.

— Dhe veshon ta procedosh, që ngriti dorë kundër një gruaja plakë — iu hodh Razimi... Kemi vendim kolegial këtu, apo kult? Ç'na bëre? Ushtarë? Harroi urdhërat, ato, kur i kishe në dorë, mund t'i jipje. Ta pleqërojnë një herë, ta shoshitim mirë, të gjejmë shkaqet... mos u nxito, se pengohe.

Çështja u ashpërsua shpejt.

Ç'flet kështu ti? Mos u marrose? I ke menduar mirë këto fjalë që thua? — iu drejtua Cane Vojka.

— I kam menduar, posi, se Bejkushi kërcet e ikën në mbledhje. Ditët e punës i ecin dhe vjen pastaj e na jep urdhëra.

— More, mos ke pirë gjë sonte? Ne u mblodhëm të marrim masa e të forcojmë kooperativën, ti po e shpie më punën — ju drejtua përsëri Cane Vojka.

— Unë, të them ty; të ngrihesh që tani e t'i

thuash hallës, që shpëtoi pa u bërë kulake, që qysh sonte ta çojë Murrin në shtallë. Po ta përsërisë edhe një herë, që sonte, more vesh — i tha Bejkushi — dhe u pre në fytyrë nga zemërimi.

— Pse t'ja them unë? Thuaja ti. Ti je kryetar. Unë s'mund të marr përsipër një përgjegjësi për gabimet tuaja. Unë, po nuk na jepet Bendeni, po s'u zgjidh puna e të lashtave të sivjeme, s'jam për kooperativë dhe shumë të tjerë do të kërkojnë të dalin.

— Për ty tani e morën vesh, po pa na thuaj, cilët janë edhe këta «shumë të tjerë», që s'na i ke thënë më përpara?... — e pyeti Cane Vojka.

Pse? në gjyq jemi këtu, që po më pyet kësh-tu? Ata flasin nëpër fshat. Pyet t'ët ëmë, të t'i thotë një e nga një. Unë nuk di t'i them. Veshët i ke, ti je sekretar i organizatës bazë, hapi dhe dëgjo!

— Po edhe ti je anëtar i Kryesisë së kooperativës... pastaj, mos harro: je anëtar Partie.

— Unë jam anëtar i Kryesisë për të bërë planin, për të ndarë punën, për të caktuar kulturat. Tjetër ç'të bëj? Nuk jam agjent i sigurimit...

— Si the? — iu akërua Cane Vojka.

— Unë s'mund të mendoj për kooperativën ashtu në hava, pa dëgjuar edhe zërin e masës.

— Të Malo Bonjakut dhe të Xhezair Kokëziut?

Ai të kuq që i kishte rënë në fytyrë, iu zhduk përnjëherësh.

Bejkushi vuri dorën mbi vetullat dhe shtrëngoi sytë, sikur donte të kujtonte ndonjë send. Pastaj, duke vështruar Canen, tundi kryet. — Është e qartë, Por po ta them edhe njëherë, o



Razim, ti që sonte ta biesh Murron në shtallë, ti, e mos bën naze. More vesh? Pastaj edhe punën tënde do ta shikojmë. . .

— Unë nuk i them. Unë s'prish dot punën time. Shtëpisë s'i vë dot kasmën. Pse? Me bereqetin tim do të ushqej Bilushin, teto Qerimenë dhe gjithë ata që mblodhët juve? Apo do të na mbajë «Çlirimi»?

Bejkushi s'po e ndjente dhëmbjen e plagës. Po Cania, duke i shikuar dorën e lidhur Bejkushit, duke kujtuar edhe ato që tha xha Sopi, iu drejtua Razimit me zë të lartë, që dëgjohej gjer jashtë:

— Oportunist! Sabotator. . . Shikoje dorën e Bejkushit! : E dëgjove ç'deshi të bënte armiku? . . . Këtu ka punë armiqtësore të hapët. Që sonte Murron ta sjellësh ti vetë për dore, more vesh? Tani shkoni. Kini mëndjen. Nuredini ka shkuar vijës së mullirit. Edhe ti Vesho shko në shtallë dhe gjumi të mos të të zërë sonte. Bëni zë edhe Dinos t'i sjellë dhëntë aty afër. Unë po shkoj me Bejkushin nga shtëpia t'i pastroj edhe një herë plagën. — Cane Vojka, që pas melitencës që kaloi, mbante në shtëpi një farmacizë.

### 3.

Duro Çalamani, për herë të parë, shkoi në kryesi të kooperativës.

Bejkushi kishte hequr xhaketën dhe po fshinte me një mandile të kuqe, kokën e tij rumbullake, të qethur kare. Me që kishte përveshur mëngët e kondosë, në bracën e dorës së djathtë i dukej shënja e plagës, që akoma nuk i ishte

mbyllur. Duro Çalamani e gjeti duke lexuar gazetën.

— Vetëm je?

— Urdhëro! Vetëm jam, si më sheh.

— Shpejt filloi vapa, po dua ta mbylлим derën. Dua të jemi të dy kokë-kokë.

Bejkushit nuk i shkoi mëndja për ndonjë gjë të keqe dhe i tha ta mbyllte. Ai, si mbylli derën, pa u ulur i vuri mbi tryezë një zarf me letër brënda.

— Këndoje! Nuk kam ndonjë të fshehtë nga ti.

Bejkushi e këndoi letrën shpejt e shpejt, pastaj e vështroi drejt në sy Duro Çalamanin, pa i thënë asnjë fjalë.

— Kështu pra, more Bejkush, ai do të kthehet. Ty mbase ta kanë bërë fjalë punën e tij. Po njerëzia thonë sekush pas midesë së tyre. Ç'është e drejta, ai iku me ata të mallkuarit e ballit. Në qafë ma pastë ai dervishi i teqesë që ma gënjeu, ma bëri myhib e ma futi në këllëf të lig e m'i vuri shtëpisë lerë. — Balli me dy rrudha të thella tejpertej iu njom nga djersa dhe sytë e zes, pak të buavitur iu mbushën me lot. — Më vinte keq për vajzën e botës, që e lëshoi në dorë të zotit. pa ç'ka që s'mendoj për mua vëllanë. Po mos dëgjo fjalët e disave, që më mbyllën në celfë të arrës për të më bërë për vehte. — Ti e merr vesh për kë e kam fjalën?... Ai erdhi përsëri në fshat dhe i turbulloi njerëzinë. Sa kohë që qe larguar e shtëmënga nga vetja dhe sikur gjeta karar. Po tani ma përtëriti dhe nuk mund ta mbaj më fshehur, se më rëndon në zemër si një gur i rëndë. Ti e di që Esmakon e Bardhajve e kishte zënë për

djalin e tij. Po që kur i biri i Nuredin Bardhit u bë partizan dhe kur Nuredinin dervishi i teqesë e nxorri nga myhibllëku, filloi midis Kokëzinjve dhe Bardhajve një luftë e madhe. Atëhere u prishën për jetë. Në dimrin e madh, kur erdhën gjermanët, djali i Nuredin Bardhit që këputur nga shokët në pyll, lart përmbi Beden. Atje e zuri i biri i Xhezairit dhe vetë. . . vetë Xhezair Kokëziu e vrau dhe e zhduku pa nishan. Një herë thanë se e çanë ujqërit, një herë thanë se kishte rënë poshtë në përrua të Bedenit. Po as u muarr vesh e as u gjet ndonjë shënjë. Të shkretin Nuredin, ai djalë e theu në mes. Këtë ngjarje e kam dëgjuar me këta veshë, nga gojët e atyre, që e vranë.

N'ato kohëra, çoku bëja nga një barrë dru për pazar. Isha ngjitur në pyll në drekëherë. Dëborë kishte mjaft, si gjer në gju. Pashë se kishte gjurmë, po nuk ua vura veshin. Ndajnatëherë dëgjova ca pushkë. Ç'të jetë vallë? them. Mbaj vesh, mbaj vesh, s'dëgjoj më të tjera. Kushedi — thashë. Me që filloi një llohë u nxitova të zbres në fshat. Për nën vete dëgjova — nuk më gënjyen veshët — zërin e Xhezairit, që se kujt i thosh: Tani le të ruajë Esmakon. Bobo, thashë, ç'paske bërë, more katil. Se qysh e pikasi atë djalë atje në mal një çudi është, shpirti. i atij e di. Ndoshta ai i shkreti kishte në mëndje të futej në fshat dhe priste natën. Mezi kam zbritur. Dëborë binte sa një krah zogu.

Durua nuk di të gënjejë, po asikohe Xhezair Kokëziut i shkonte fjala. Ja, që erdhi koha të ta them këtë të fshehtë ty. Razimit nuk ma mbante, është dhëndërr te Kokëzinjtë.

Si mbaroi, Duro Çalamanai nxorri një ofshe. Buza filloi t'i dridhej gati për t'ja shkrepur të qa-

rit, dhe u lëshua si njeri i lodhur e i dërrmuar për vdekje.

— Nuredin Bardhi s'di gjë për këtë. Ai e di djalë të humbur në atë dëborë të madhe, që ra në fund të Shënëndreut, kur po kapërxente me batalionin Ledhin e Keq, si i themi ne asaj koj-dheles në krye të Bedenit, është hon që s'del dot njeriu.

Pas këtyre fjalëve pushoi dhe humbi në mendime për ta prurë edhe një herë në sy atë ngjarje, që e ruajti kaq vjet me ankth dhe shqetësim të madh.

— E drejta dërrmon hekurin — kanë thënë një fjalë pleqtë qëmoti; kaq vjet edhe mua më bloi bark e mushkëri... Sa për punën e Elmasë, që një turp për sojnë tonë, që na bëri Malo Bonjaku... Këtë ma tha vetë Elmaja.

Nga dritarja e vogël, në anën e Bedenit, die-lli dukej si një lëmsh i zjarrtë midis horizontit.

— Të mbajta shumë... po ikij — dhe i dha dorën Bejkushit.

Si uli mëngët e këmishës dhe vuri në kokë kasketën, pas tij doli edhe Bejkushi.

Qielli rëndonte mbi fshat. Nga fusha asnjë gikë erë nuk po frynte.

#### 4

Në sallën e shkollës që mbledhur, pothuaj, i gjithë fshati dhe dëgjonin me vëmendje të dërguarin e Komitetit të Partisë, që po bënte konkluzionet e ngjarjeve të fundit në Këmbëzë.

Atë natë fshatarët mësuan të gjithë punën

armiqësore të Malo Bonjakut dhe të Xhezair Kokëziut.

— Po Razimi? — u hodh e pyeti Bilush Rrumbullaku. — Se edhe ai s'më duket të jetë esëll.

— Edhe Razimi ra brënda me ta. Ai ishte njeri, që i pëlqente të ishte i madh. Partia i kishte folur, po Xheair Kokëziu e Malo Bonjaku e bënë atë zëdhënësin e tyre në punët e kooperativës, e gjer në mbledhjet e organizatës së Partisë. Ai e humbi ndenjën e luftës së klasës e u bë një oportunist i fëlliqur. S'deshi të përfitonte nga dora që i dha Partia dhe organizata bazë e Këmbëzës. Partia na mëson të jemi vigjilentë shokë! Dhe shokët e Partisë këtu në Këmbëzë e nuhatën se cili qe Razimi.

Tani kooperativa juaj të nxjerrë mësim nga këto ngjarje. Organizata e Partisë të bëjë më shumë punë politike për të njohur armikun e klasës, se, si ka thënë Stalini, «për ta mundur armikun, duhet ta njohim». Prandaj duhet të jemi kurdoherë vigjilentë.

Ai po e mbaronte fjalën:

«Askush nuk mund të na pengojë në rrugën e ndërtimit socialist edhe në fshat. Shoku Enver ka thënë: «Edhe në bujqësi po sigurohet triumfi i plotë i pronës socialiste mbi atë private».

Pasi e muarrën fjalën Nuredin Bardhi, Bilush Rrumbullaku e të tjerë, në këtë mbledhje hynë në kooperaivë nja dhjetë familje.

Në këto çaste, kur fshatarët po duartrokisnin me gëzim të madh, Elmaja, kunata e Duro Çalamanit, nëpër shkallët e shkollës, hyri brënda në mbledhje. E prerë në fytyrë, pa vënë re se ku e hidhte këmbën, iu qas Bejkushit në presidium,

dhe iu lut në mund t'i jepte i deleguari maqinën se kishte t'anë keq.

— Posi — i tha i deleguari, sa mori vesh dhe i dha një letër për shoferin.

Ato ditë, pas takimit me Bejkushin, Duro Çalamani papandehur u sëmur shumë rëndë. Ca të prera në gjoks e mundonin dhe i zinin frymën, sa mënd gajasej.

E shoqja me lotë në sy po e vështronte si e ngrirë dhe pikëllohej për të që po vuante aq shumë. Ajo kishte një jetë me të dhe sonte, që ishte më rëndë, mund ta humbiste nga çasti në çast. E kunata, me t'u kthyer në shtëpi, nxitoi ta përgatiste për ta shpurë në qytet. Në fund të minderit e shikonte, tek po vishej, sa shumë qe prishur. Po më tepër i vinte keq për të, që u sëmur tani që po priste të vëllanë t'i kthehej pas kaq vjetësh, e mbase nuk do ta shikonte dot.

Kur e hypën në maqinë, Duro Çalamani iu lut Elmasë ta kalonin përpara derës së shkollës, ku bëhej mbledhja dhe ta ndalonin pak.

Në fund të shkallëve, shoferi e ndali maqinën.

— Thuaji të dalë një çikë Bejkushi këtu te krei i shkollës — i tha shoferit, — se kam një fjalë.

Me Bejkushin dolën edhe plot fshatarë.

— Dëgjoni, more shokë. Unë s'dihet kthehem a s'kthehem më i gjallë. Regjistromëni edhe mua me gjithë familjen në kooperativë. — Pastaj, nga xhepi i brëndshëm i peshllit të leshtë, nxorri një librezë kursimi. Këtu kam njëqindmijë lekë — dhe duke ja dhënë së shoqes i tha — Jepja Bejkushit për kooperativën.

— Ju falemnderit. Tani, edhe në vdeksha, e di që nuk kam qenë i veçuar nga shokët.

Fshatarët atje te krei i shkallës, kishin qëndruar si qirinj më këmbë. Asnjëri s'ishte më i zoti të thoshte një fjalë.

Kur vazhdoi mbledhja, u bë një copë herë heshtje. Të gjithë mendonin të ngashëryer. Bejkushi, duke lexuar listën e atyre, që atë natë hynë në kooperativë, emërin e Duro Çalamanit e zuri në gojë të parin.

5

Gjysma e dytë e Qershorit në fushën e Këmbëzës bën një zagushi e rëndë. Qielli i murmë i verës të bie mbi krye si një saç i përvëluar.

Zogjt e fushës të tulatur, kanë humbur nëpër ferra. Vetëm lejlekët, mbi një këmbë, përhapur, si në pritë, rrotullojnë kryet rëndë-rëndë. Ngandonjëherë, sikur i trëmb dikush, shtrijnë këmbët e tyre të gjata, ngrihen me shpejtësi dhe humbasin në horizont. Bregut të lumit, dy larashë, duke zgjeruar rrethin e fluturimit, ngrihen e ngrihen lart, pastaj lëshohen tatëpjetë, si plumb mbi gjahun e tyre. Qershitë e shumta të Këmbëzës, që kanë filluar të piquen, skuqin nëpër ato gjethe të gjelbëra, të cilat nga pesha e vapës varen poshtë fare të palëvizura. Nga toka del një avull i nxehët dhe mbi baltë shojet e këmbëve të digjen si në prush. Disa të vegjël lahen në mëngën e lumit dhe nga gëzimi që ndjejnë qeshin e kukurisen shoq me shoq. Xha Sopi po merrej me Bobolin, dashin e rracës.

Boboli, me ata brirë sa krahu, i këlliste datën xha Sopit.

— A, ç'm'u bë peshqesh mua... dhe kjo më

duhej tani, të ha ndonjë bri barkut që të mbetem pa të... Pa dale, more Bobol... Mos u bën si budalla... S'ta kam fuqinë. — Po kur ai përvishte buzën e sipërme e shtërngonte dhëmbët si rruaza të bardha dhe perëndonte sytë, xha Sopit s'i mpreheshin këmbët. — Tani vajta. Kaq e pata. Tani po ja jap shpirtin shejtanit. Domosdo, more Bobol, me ato vezë që ha ti, gjysmat t'i haja për vete, jo me litar, po me hekura të më lidhnin, po s'të bëja fërtele të mos më thoshin Sopi.

Boboli, kur erdhi në fillim, rrinte urtë. Po, sa u mësua në fshat me ato shëtitje që bënte, me ato vezë që hante dhe atë qumësht që pinte, zuri të bënte shakara me njerëzinë.

Xha Sopi, si e qetësoi Bobolin, që nisi të kullosë nën qershitë, u shtri në hien e një fiku dhe ja përmbloodhi gjumit.

Zabulzagushia u zhduk afër orës dhjetë, nga era që shpërtheu grykës së lumit dhe u përhap me fëshfërimë nëpër gjethet e qershive e nëpër tërë fushën. Dhe atë kohë, si për çudi, nisën prapë, si në agim, zogjtë dhe trumba-trumba, me ta bashkë, dolën nga hiet skuadrat e brigadës me kosa e derpënj në duar dhe vazhduan të korrat. Nëpër ara shamat e grave zbardhojnë si boça pambuku.

Duajt, kulupi, njeri mbi tjetrin ua gëzojnë zemrën. Dy qerre i çojnë afër lëmenjve, ku dëgjohet zëri i Nuredin Bardhit e i Bilush Rrumbullakut, të cilët u flasin kuajve: «hopa! hopa!...» dhe në ajër fishkëllojnë kamxhikët.

Në Këmbëzë tani punët po shkonin mbarë.

Xhezair Kokëziu e Malo Bonjaku e gjetën vëndin.

— I qëruan gjembat — thoshte edhe xha Sopi. Edhe Dalip Zeshkani, i cili qau në një mble-



dhje të fshatit dhe i ra me grushte kokës, se dëgjoj Malo Bonjakun, dhe e ndjente vehten akoma të turpëuar, sot ishte i gëzuar. Duke korrur, me zërin e tij si kambanë, u këndonte fshatarëve një këngë të re:

*Fush' e Këmbëzës me grurë.  
Rreth' e rrotull me qershi,  
Të bashkuar gra e burra  
Punojmë si një shtëpi.  
Moj Parti u rriç nga ditë,  
Që na dhe neve fuqi:  
Na hape udhën e drejtë  
Për të rrojtur si njeri.  
Dy kulakë, që kishte fshati,  
I futëm brenda si mi?  
Korrim, shokë, korrim shoqe,  
Me shëndet grurin e ri!*

Në drekë brigada u mbledh në hien e fikut për të ngrënë bukë, ku qe shtrirë xha Sopi, i cili gërhiste akoma.

— Ç'të bëjë i varfëri... Hieja e fikut ka gjumë të rëndë — zëri i Dalipit dhe të qeshurat e të tjerëve e zgjuan.

— Pse? U bë dreka?

— U bë, u bë — iu përgjegj e shoqja — po ngreu, sado fjete.

Xha Sopi u çua dhe duke u shtritur tha nëpër buzë: sa shpejt ikën dita, kur je me punë. Ma morri shpirtin Boboli... Bukën — iu drejtua së shoqes, — së më griu.

Rrezet e diellit në fushën e Këmbëzës, përsëri, në mesditë, djegin fort. Era pakësohet dhe njeriu shkumbëzon për një pikë ujë. Bucelat me ujë. që i ruante xha Sopi, i thakën me një herë.

Sekush, me nga një boçe, shtruar në shesh, vuri ushqimin e vet. Në këtë çast teto Qerimeja u lutet:

— Daleni, — u thotë — dhe me të dyja duart e saj mori një bukë të madhe: — Vëllezër, — vazhdoi ajo — kjo bukë është me grur të ri nga të fushës sonë. Ne s'kemi qënë ndonjëherë kështu të bashkuar i gjithë fshati, siç jemi sivjet. Hithrat dhe gjëmbat i shkulëm. Me shumë mundime e ngritëm kooperativën tonë. Ne i duruam të gjitha dhe fituam, se bëmë ashtu si na tha Partia. Canen e Bejkushin deshën të na i vrasin armiqtë e, me ta bashkë, donin të na vrisnin edhe neve. Po na e muarrën të keqen, se Partia na ka dhënë fuqinë. Ata donin të na kthenin si në kohën e parë. Ç'do të bëhesha unë, një grua e ve, me tre fëmijë, pa përkrahje? ç'do të bëheshit ju të gjithë, po të mos qe Partia, që na hoqi thilenë nga gryka, e na tha: bashkohuni?. Bashkohuni se kështu është e mira juaj... Dhe ja, se si dualën fjalët e Partisë. Unë kisha dëshëruar të mbrunja bukë të grynjtë në magje dhe të ndizja furrë në shtëpi. Dhe e arrita këtë ditë. Këtë bukë e kam gatuar me këto duart e mia, nga ky gruri i ynë, që e mbollëm me duart tona dhe që po e korrim këto dit.

Pastaj ajo e preu bukën në thela-thela dhe u ndau nga pak të gjithëve.

Teto Qerimeja i foli këto fjalë pa u ngashëryer fare. Fshatarët e vështruan në sy dhe e dëgjuan me vërejtje. Një forcë e padukur i rrëmbeu me vete. Me atë copë bukë në dorë, ata e vështruan në sy, si nënë e tyre, atë nënë të vuajtur, që tani ishte e fuqishme, si mal.

— Hani, u tha të tre djemve të saj, se nuk ju kam më jetimë, shikoni sa njerëz jemi?

PTT DE

Shqipëri

Popull

W

Redaktor: Razi Brahimi  
Korektor letrar: Ferik Linaj  
Kopertina: Llazar Taçi  
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi 3000 kopje    Format 70x100/32    Stash: 2204-55  
Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» Tiranë 1965